



**KONTROLLI I LARTË I SHTETIT**

**RAPORT PËRFUNDIMTAR PËR AUDITIMIN E TEKNOLOGJISË SË  
INFORMACIONIT NË AUTORITETIN KOMBËTAR TË USHQIMIT,  
INSPEKTORATIN QENDROR DHE AGJENCINË KOMBËTARE TË SHOQËRISË  
SË INFORMACIONIT**

**RAPORT PËRFUNDIMTAR I AUDITIMIT**

**PËR “AUDITIMIN E SISTEMEVE TË TEKNOLOGJISË SË INFORMACIONIT NË  
AUTORITETIN KOMBËTAR TË USHQIMIT, INSPEKTORATIN QENDROR DHE  
AGJENCINË KOMBËTARE TË SHOQËRISË SË INFORMACIONIT”**

**Tiranë, më 29.03.2022**

## PËRMBAJTJA

Nr.	EMËRTIMI	Faqe
<b>I.</b>	<b>PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE</b>	
1	Përshkrim i shkurtër i Projektit të Auditimit	4
2	Përshkrim i gjetjeve kryesore dhe rekomandimeve	4-7
3	Konkluzioni i përgjithshëm dhe Opinioni i Auditimit	8
<b>II.</b>	<b>HYRJE</b>	
1	Objekti i auditimit	8
2	Qëllimi i auditimit	8
3	Identifikimi i çështjes	9
4	Përgjegjësitë e strukturave drejtuese	9
5	Përgjegjësitë e audituesve	10
6	Kriteret e vlerësimit	10
7	Standardet e auditimit	11
8	Metodat e auditimit	11
9	Dokumentimi i auditimit	11
<b>III.</b>	<b>PËRSHKRIMI I AUDITIMIT</b>	
1	<b>Informacion i Përgjithshëm mbi subjektin</b>	12
2	<b>Përshkrimi i auditimit, sipas drejtimeve të auditimit</b>	
	<b>2.1 Auditimi i funksionimit të Qeverisjes TIK</b>	12-18
a.	<i>Strategjia, procedurat dhe rregulloret në TIK</i>	
	<b>2.2 Auditimi i zhvillimit dhe blerjes në teknologjinë e informacionit.</b>	18-24
a.	<i>Marrëveshjet e nivelit të shërbimit (Service Level Agreement)</i>	
	<b>2.3 Auditimi i sigorisë së informacionit</b>	24-34
a.	<i>Identifikimi dhe adresimi i risqeve në TIK.</i>	
b.	<i>Siguria e të dhënave dhe përdoruesit e sistemit</i>	
	<b>2.4 Auditimi i sistemeve</b>	34-60
a.	<i>Auditimi mbi kontrollet e aplikacioneve dhe të dhënat Input/Output</i>	
<b>IV.</b>	<b>GJETJET DHE REKOMANDIMET</b>	61-71

## Lista e Shkurtimeve

Shkurtimi	Emërtimi i Plotë
AKU	Autoriteti Kombëtar i Ushqimit
AKSHI	Agjencia Kombëtare e Shoqërisë së Informacionit
IQ	Inspektorati Qendror
MBZHR	Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural
ISUV	Instituti Sigurisë Ushqimore dhe Veterinare
ARK	Autoriteti Rregullator Koordinues
QKB	Qendra Kombëtare e Biznesit
QKL	Qendra Kombëtare e Liçencimit
ALCIRT	Agjencia Kombëtare për Sigurinë Kibernetike
AKCESK	Autoriteti Kombëtar për Certifikimin Elektronik dhe Sigurinë Kibernetike.
MNSH	Marrëveshje të Nivelit të Shërbimit
TI (IT)	Teknologjia e Informacionit
BNJ	Burimet Njerëzore
TIK	Teknologjia e Informacionit dhe Komunikimit
OBU	Operatori Biznesit Ushqimor
CAMS	Sistemi Administrimit të Inspektimeve (Case Administration Management System)
DMS	Sistemi Administrimit të Dokumenteve (Documents Management System)
DRAKU	Drejtoria Rajonale e Autoritetit Kombëtar të Ushqimit
KM	Këshilli i Ministrave
RMS	Sistemi Arkivimit të Dokumenteve (Records Management System)
AD	Active Directory
BE	Bashkimi Evropian
NATO	Organizata e Traktatit të Atlantikut të Veriut(North Atlantic Treaty Organization)
e-GOV	Electronic Government
PIK	Pika e Inspektimit Kufitar
GPS	Sistemi Pozicionimit Global (Global Positioning System)
COBIT	Objektivat e Kontrollit për Informacionin dhe Teknologjinë përkatëse
ISSAI	Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit
NJTIK	Njësitë e Teknologjisë së Informacionit e të Komunikimit
HTTP	Transfer Hyper Text Protocol
HTTPS	Transfer Hyper Text Protocol Secure

## I. PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE

Kontrolli i Lartë i Shtetit (KLSH) mbështetur në nenet 3 dhe 14 të ligjit 154 “Për Organizimin dhe Funkionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, datë 27.11.2014, zhvilloi një Auditim të Teknologjisë së Informacionit në Autoritetin Kombëtarë të Ushqimit (AKU), Inspektorati Qendror (IQ) dhe Agjencinë Kombëtare të Shoqërisë së Informacionit, nga data 22.10.2021 deri më datë 28.12.2021.

Grupi i auditimit mblodhi informacione, zhvilloi pyetësorë e intervista për caktimin e zonave me risk të lartë dhe mbështetur në to hartoi matricat e auditimit.

Kërkesat për informacion për fushat përkatëse u hartuan në përputhje me manualin e Auditimit të Teknologjisë së Informacionit.

### I.1.Përshkrimi i shkurtër i Projektit të Auditimit:

Projekti i auditimit, për auditimin e Sistemeve të Teknologjisë së Informacionit, në Autoritetin Kombëtarë të Ushqimit, është pjesë e Planit Vjetor 2021 të auditimit të KLSH-së, miratuar nga Kryetari i KLSH. Projektimi i këtij auditimi, është bërë bazuar në një analizë risku, si gjatë hartimit të planit vjetor, po ashtu edhe gjatë hartimit të Programit të Projektit të Auditimit, ku KLSH, ka vlerësuar si të rëndësishëm auditimin e sistemeve të teknologjisë së informacionit, për të garantuar disponibilitet dhe integritet të të dhënave me të cilat bazon vendimmarrjen. Siguria e Informacionit është bërë gjithnjë e më shumë e rëndësishme për institucionet, kjo si pasojë e rritjes së kompleksitetit të kontrollit të aksesit dhe ruajtjes së konfidencialitetit, integritetit dhe gatishmërisë së të dhënave nga marrëdhëniet e rrjeteve publike me ato private dhe nga bashkë përdorimi i burimeve të informacionit. Siguria e Informacionit mund të përcaktohet si mundësia e një sistemi për të mbrojtur informacionin dhe burimet e sistemeve në përputhje me termat e konfidencialitetit, integritetit dhe gatishmërisë. Sistemet e informacionit janë bashkime komplekse të teknologjisë, proceseve dhe njerëzve që funksionojnë së bashku për të rregulluar përpunimin, ruajtjen, dhe transferimin e informacionit për të mbështetur misionin e institucionit dhe funksionet e tij. Lidhur nga sa më sipër, çdo institucion shtetëror që ofron shërbime ndaj qytetarëve e ka si detyrim ndërtimin e programit të sigurisë së informacionit me elementët kyç të cilët janë: “*Mjedisi i sigurisë së informacionit, Vlerësimi i riskut, Politikat e sigurisë, Organizimi i sigurisë së TIK, Menaxhimi i komunikimeve dhe operacioneve, Menaxhimi i asetëve, Siguria e burimeve njerëzore, Siguria fizike dhe mjedisore, Kontrolli i aksesit, Menaxhimi i incidenteve të sigurisë së TIK, Menaxhimi i vazhdueshmërisë së biznesit, Përputhshmëria*”.

### I.2.Përshkrim i gjetjeve kryesore dhe rekomandimeve:

Gjetje e nr.	Përmbledhje e Gjetjes	Referenca me Raportin Përfundimtar	Rëndësia	Rekomandimi
1.	Nga auditimi mbi aktet rregullative të brendshme që disponon AKU u konstatua se, Rregullorja e Brendshme nuk është e përditësuar në funksion të strukturës	faqe 12 - 18	e Lartë	<b>Rekomandimi 1:</b> Titullari i AKU, të marrë masa për përditësimin e rregullores së brendshme institucionale në të cilën krahas ndryshimeve të

	<p>organizative pasi në të nuk janë paraqitur detyrat funksionale për Sektorin e Planifikimit Strategjik dhe Raportimit.</p>			<p>detyrave operacionale që mund të kenë ndryshuar të pasqyrohen dhe detyrat e sektorit të ri të Planifikimit Strategjik dhe Raportimit.</p>
2.	<p>Nga auditimi mbi historikun dhe aksesin në të dhëna u konstatua se, në sistemin e-inspektimi, AKU përballet me një papërshtatshmëri funksionale dhe operacionale, për arsye se:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- Mungojnë të dhënat me rekordet historike të AKU për periudhën 2012-2018;</li> <li>- Të dhënat e inspektiveve të ruajtura në bazën e të dhënave të IQ-së për periudhën 2018 e në vazhdim nuk janë të disponueshme për gjithë punonjësit që zhvillojnë analiza apo monitorime të inspektiveve të AKU-së;</li> <li>- Inspektori nuk ka të drejtë të shohë rezultatin e inspektimit të mëparshëm të zhvilluar në subjektin ku ai ndodhet.</li> </ul>	faqe 34-60	e Lartë	<p><b>Rekomandimi 1:</b> IQ dhe AKSHI si institucione administrues të sistemit e-inspektimi ku AKSHI njëkohësisht dhe ndjekës i kontratës së mirëmbajtjes të marrë masat për përmbushje nga ana e OE detyrimit për importimin e të dhënave historike të AKU në sistemin e-inspektimi për të siguruar në këtë mënyrë vazhdimësinë historike dhe të gjurmueshme të të dhënave inspektuese që janë kryer ndër vite.</p> <p><b>Rekomandimi 2:</b> IQ dhe AKSHI si institucione administrues të sistemit e-inspektimi ku AKSHI njëkohësisht dhe ndjekës i kontratës së mirëmbajtjes të kërkojnë përmbushjen nga OE, të drejtën për të parë në sistem rezultatin e inspektimit të mëparshëm të zhvilluar në subjektin nga çdo inspektor që është aktualisht për inspektim.</p>
3.	<p>Nga auditimi dhe monitorimi në terren mbi përdorimin e sistemit informatik e-inspektimi nga inspektorët e AKU u konstatuan disa mangësi të cilat renditen si më poshtë:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- Punonjësit logohen në sistem me pajisjet tabletë duke u lidhur me internetin e celularit personal.</li> </ul>	faqe 34-60	e Lartë	<p><b>Rekomandimi 1:</b> AKU në bashkëpunim me IQ të marrin masat, për sigurimin e internetit dhe riparimin apo zëvendësimin e pajisjeve tablet të inspektorëve të AKU në mënyrë që inspektorët të kryejnë në mënyrë të sigurtë dhe pa ndërprerje detyrat inspektuese në terren.</p> <p><b>Rekomandimi 2:</b></p>

	<ul style="list-style-type: none"> <li>- Sistemi nuk të jep mundësinë e plotësimit të urdhrit apo vendimit mbi të cilin po bëhet plani i monitorimit, monitorime këto të cilat mund të zhvillohen në kohë të ndryshme, nga arsye të ndryshme dhe me kërkesa të pakufizuara;</li> <li>- Opsioni “Nuk aplikohet” mungon në pothuajse të gjitha listë kontrollet.</li> </ul>			<p>IQ në bashkëpunim me AKSHI-n si institucione administrues të sistemit e-inspektimi, ku AKSHI është njëkohësisht dhe ndjekës i kontratës së mirëmbajtjes të marrin masat për evidentimin e të gjithë fushave në listat e kontrollit që nuk është vendosur opsioni “Nuk aplikohet”. Nëse kjo është kërkuar, por nuk është realizuar nga OE, atëherë të përlogariten penalitete mbi vlerën e mirëmbajtjes, në përputhje me kohën që kur kjo kërkesë apo dakordësim është marrë nga OE.</p>
<p><b>4.</b></p>	<p>Nga auditimi mbi përdorimin e sistemit informatik e-inspektimi dhe hyrjen e të dhënave gjatë inspektimeve nëpërmjet sistemit e-inspektimi u konstatuan disa mangësi:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- AKU nuk informohet në mënyrë periodike në asnjë formë nga QKB për subjektet e hapura kohët e fundit të cilët kanë veprimtari me objekt inspektimi nga AKU. E njëjta situatë është edhe për subjektet që kanë mbyllur veprimtarinë, të cilët AKU i ka planifikuar për inspektim si rezultat i mungesës së informacionit.</li> <li>- Me zgjedhjen e llojit të inspektimit nuk është bërë e mundur nëpërmjet sistemit inspektorët të zgjidhen nga lista e sektorit që do të kryejë atë lloj inspektimi, duke marrë në konsideratë kualifikimin e tyre dhe sektorin në të cilin ndodhen,</li> </ul>	<p>faqe 34-60</p>	<p>e Lartë</p>	<p><b>Rekomandimi 1:</b>  IQ me bashkëpunimin e AKU-s, pas përfundimit të regjistrimit të dhënave shtetërore, të hartojë dhe delegojë tek AKSHI kërkesën për ndërveprim me të dhënat e regjistrimit të biznesit në QKB, për shkëmbimin e informacionit mbi subjektet e hapura dhe të mbyllura në mënyrë periodike, me qëllim lehtësimin e planifikimit inspektues. Ky ndërveprim do të shërbejë jo vetëm AKU por gjithë inspektoriateve</p> <p><b>Rekomandimi 2:</b>  IQ në bashkëpunim me AKU-n të identifikojnë nevojat për përmirësim të sistemit e-inspektimi që kanë të bëjnë me procese të inspektimit, mbetur jashtë sistemit si procedura e asgjësimit</p>

<p>çfarë do të garantonte që për çdo inspektim janë zgjedhur inspektorët e lejuar për ta kryer.</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- Në listat e kontrollit ka kërkesa të cilat kontrollohen dhe nga institucione të tjera inspektuese si p.sh: largimi i mbetjeve, ujërave të ndotura etj., të cilat vetë subjektet u shprehën se kontrollohen dhe nga inspektorati i mjedisit.</li> <li>- Në sistemin e-inspektimi nuk rezulton të jetë implementuar procedura e asgjësimit së bashku me procesverbalin përkatës, por ky proces ndiqet jashtë sistemit edhe pse ai është i rëndësishëm po aq sa inspektimi.</li> <li>- Në listat e kontrollit ka përsëritje të fushave që do të thotë se do të ketë plotësime me informacion përsëritës, duke rritur në këtë mënyrë fiktivisht kohën e plotësimit si p.r.sh. drejtuesi teknik është një nga fushat të cilat plotësohet dy herë nga inspektori, por kjo nuk është e vetmja.</li> <li>- Në krijimin e çështjeve gjatë përzgjedhjes së aktivitetit nuk janë të gjitha kategoritë e aktiviteteve, por nga AKU nuk janë kërkuar shtime të aktiviteteve të tjera të nevojshme.</li> <li>- Lista e Qendrës së Depurimit të Midhjes nuk të lejon aksesimin e gjenerimit në sistem me firmën Digjitale, por punohet nëpërmjet versionit web të aplikacionit.</li> </ul>		<p>prej fillimit deri në procesverbalin përkatës.</p> <p><b>Rekomandimi 3:</b> IQ të identifikojë të dhënat inspektuese që përsëriten nga inspektorate të tjerë dhe që janë njëkohësisht në listë kontrollet e AKU, me qëllim eliminimin e kontrollove të dyfishta në subjektet që inspektohen.</p> <p><b>Rekomandimi 4:</b> AKSHI si institucion administrues i sistemit e-inspektimi dhe njëkohësisht ndjekës i kontratës së mirëmbajtjes, por dhe administrues i sistemit të QKB, me përfundimin e regjistrimit të bazave të të dhënave shtetërore, të marrë masa për realizimin e ndërveprimit ndërmjet sistemit e-inspektimi dhe sistemit të QKB, për shkëmbimin e informacionit mbi subjektet e hapura dhe të mbyllura në mënyrë periodike çfarë do të ndihmonte AKU-n në hartimin e planeve të inspektimit. Gjithashtu, të vlerësojë dhe gjejë zgjidhjet teknike për kërkesat që vijnë prej IQ dhe AKU të cilat i shërbejnë punës së tyre inspektuese.</p>
--	--	---

### **I.3. Konkluzioni i përgjithshëm i Auditimit**

Grupi i auditimit mbështetur në Standardet Ndërkombëtare të Auditimit përkatësisht në ISSAI 100, ISSAI 5300, ISSAI 5310 si dhe nenet 3 dhe 14 të ligjit 154 “Për Organizimin dhe Funkcionimin e KLSH” datë 27.11.2014 konstaton se, procesi i inspektimit nuk është informatizuar plotësisht. Problematikat e këtij informatizimi janë të shumta, duke u bërë pengesë për aktivitetin e Autoritetit Kombëtar të Ushqimit. Mungesa e strategjisë, akteve rregullative, e të dhënave historike për AKU, pajisjeve dhe internetit për inspektim, problematikat në funksionalitete e sistemit “e-inspektimi”, si dhe adresimi i tyre tek Inspektorati Qendror, kur administrator dhe ndjekës i kontratës së mirëmbajtjes është AKSHI, janë disa nga faktorët kryesorë që kanë ndikuar në cilësinë dhe saktësinë e të dhënave që gjeneron Autoriteti Kombëtar i Ushqimit.

## **II. HYRJE**

Mbështetur në Ligjin 154/2014, datë 27.11.2014 “Për Organizimin dhe Funkcionimin e KLSH”, në zbatim të Programit të Auditimit nr. 978/1, datë 22.10.2021 të miratuar nga Kryetari i KLSH, me afat auditimi 22.10.2021 deri në 28.12.2021, në Autoritetin Kombëtar të Ushqimit, Agjencinë Kombëtare të Shoqërisë së Informacionit dhe Inspektoratin Qendror, ku periudha e audituar është 01.01.2020 deri në 30.06.2021, u krye auditimi me objekt “*Auditimi i Sistemeve të Teknologjisë së Informacionit*”, nga audituesit:

1. Elira Cukalla, përgjegjëse grupi
2. Erieta Këlliçi, Anëtare
3. Anxhela Kostaj, Anëtare

### **II.1. Objekti i auditimit**

*Objekti i Auditimit TIK* është përcaktimi nëse objektivat e subjektit arrihen në mënyrën e duhur duke përdorur burimet IT, duke përfshirë pajtueshmërinë me kërkesat ligjore dhe rregullative, konfidencialitetin, integritetin si dhe disponueshmërinë e sistemeve të informacionit dhe të dhënave që gjenden në të.

### **II.2. Qëllimi i auditimit**

Kontrolli i Lartë i Shtetit (KLSH) mbështetur në nenet 3 dhe 14 të ligjit 154 “Për Organizimin dhe Funkcionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, datë 27.11.2014, zhvilloi auditimin e teknologjisë së informacionit në AKU, IQ dhe AKSHI, nga data 17.09.2021 deri më datë 28.12.2021. Kërkesat për informacion sipas drejtimeve të programit të auditimit, u hartuan në përputhje me Manualin e Auditimit të Teknologjisë së Informacionit.

*Qëllimi i Auditimit TIK* ushtruar në AKU, IQ dhe AKSHI, është dhënia e opinionit apo vlerësimi nëse ekzistojnë kontrollet dhe mekanizmat e duhur me qëllim krijimin/ mirëmbajtjen/ zhvillimin e burimeve TI dhe funksioneve për të cilat këto burime shërbejnë.

### **II.3. Identifikimi i çështjes**

Drejtimet e këtij auditimi janë bazuar në programin e protokolluar në KLSH me nr.978/1, datë 22.10.2021:

#### **1. Auditimi i funksionimit të Qeverisjes TIK**

*Strategjia, procedurat dhe rregulloret në TIK*

#### **2. Auditimi i zhvillimit dhe blerjes në teknologjinë e informacionit**

*Marrëveshjet e nivelit të shërbimit (Service Level Agreement)*

#### **3. Siguria e Informacionit**

*a. Identifikimi dhe adresimi i risqeve në TIK*

*b. Siguria e të dhënave dhe përdoruesit e sistemit*

#### **4. Auditimi i sistemeve**

*Auditimi mbi kontrollat e aplikacioneve dhe të dhënat Input/Output*

### **II.4. Përgjegjësitë e strukturave drejtuese**

Autoriteti Kombëtar i Ushqimit është institucioni përgjegjës për mbikëqyrjen e sigurisë ushqimore në Shqipëri, me funksione inspektuese në nivel kombëtar të fushës së sigurisë dhe mbrojtjes së konsumatorit, mbrojtjes së bimëve dhe shëndetit të kafshëve.

Objektivat institucional të Autoritetit Kombëtar të Ushqimit janë:

- Drejton procesin e vlerësimit të riskut në fushën e ushqimeve dhe ushqimeve për kafshë dhe mbrojtjes së bimëve;
- Planifikon, bashkërendon dhe realizon kontrollin zyrtar të ushqimeve dhe ushqimeve për kafshë dhe të mbrojtjes së bimëve;
- Siguron unifikimin e praktikave të kontrollit të sigurisë së ushqimeve dhe ushqimeve për kafshë dhe të mbrojtjes së bimëve në shkallë vendi;
- Bashkërendon veprimtarinë e laboratorëve të autorizuar të sistemit të kontrollit zyrtar të ushqimeve dhe ushqimeve për kafshë dhe të mbrojtjes së bimëve;
- Kryen kontrole paraprake për të vërtetuar nëse janë plotësuar kërkesat tekniko-teknologjike, higjieno-sanitare, fitosanitare dhe veterinare, verifikimin e dokumentacionit të nevojshëm për regjistrimin dhe licencimin e operatorëve të biznesit ushqimor dhe mbrojtjes së bimëve;
- Ndalon në mënyrë të përkohshme ose të përhershme, veprimtarinë e operatorëve të biznesit të ushqimit dhe të atij të ushqimit për kafshë në fazat e prodhimit, përpunimit, shpërndarjes dhe tregtimit të ushqimit apo ushqimit për kafshë, kur vërtetohet se ushqimi ose ushqimi për kafshë dhe operatorët përkatës të biznesit nuk plotësojnë standardet e sigurisë ushqimore, të përcaktuara në legjislacionin në fuqi;
- Kryen studime shkencore të nevojshme për vlerësimin e riskut në fushën e sigurisë së ushqimit dhe ushqimit për kafshë dhe të mbrojtjes së bimëve;
- Jep mbështetje teknike, administrative dhe shkencore, për të siguruar veprimtarinë e komitetit shkencor dhe të paneleve shkencore;
- Informon publikun për fushën e sigurisë së ushqimeve dhe ushqimeve për kafshë dhe të mbrojtjes së bimëve.

Misioni i AKU-së është garantimi i shëndetit të qytetarëve dhe mbrojtja e konsumatorit duke vendosur dhe konsoliduar në vijimësi bazat për sigurimin e një niveli të lartë të mbrojtjes së shëndetit të njeriut dhe interesat e konsumatorit, në të gjitha fazat e prodhimit primar dhe të gjitha fazat e trajtimit, përpunimit dhe shpërndarjes së ushqimeve dhe ushqimeve për kafshë.

## ***II.5. Përgjegjësitë e audituesve***

Kontrolli i Lartë i Shtetit auditoi Autoritetin Kombëtar të Ushqimit, Inspektoratin Qendror dhe Agjencinë Kombëtare të Shoqërisë së Informacionit, mbi periudhën e veprimtarisë nga 01.01.2020 deri në 30.06.2021, duke i kushtuar vëmendje çështjeve që lidhen me zbatimin e ligjshmërisë dhe rregullshmërisë si dhe standardeve ndërkombëtare të teknologjisë dhe auditimit TI.

Nga grupi i auditimit, me përgjegjësi të plotë, janë analizuar të gjitha çështjet që përmban Programi i Auditimit nr. 978/1, datë 22.10.2021 miratuar nga Kryetari i KLSH. Në realizimin e këtij Projekt Auditimi, grupi i auditimit është mbështetur në bazën ligjore mbi të cilën funksionon KLSH, standardet e auditimit, legjislacionin e fushës në të cilën operon AKU, IQ dhe AKSHI. Gjithashtu, gjatë veprimtarisë audituese, është siguruar një evidencë e përshtatshme, e mjaftueshme dhe e besueshme auditimi, në të cilën jemi mbështetur në dhënien e konkluzioneve dhe rekomandimeve.

## ***II.6. Kriteret e vlerësimit***

Kriteret e vlerësimit janë bazuar në ligjet, rregulloret në fuqi, standardet ndërkombëtare COBIT dhe ISSAI 5300 për auditimin e Teknologjisë së Informacionit si dhe Manualin e Teknologjisë së Informacionit. Opinioni i auditimit mbështetet në praktikën më të mira, Standardet Kombëtare dhe Ndërkombëtare të Auditimit. Në këtë projekt raport krahas gjetjeve që janë konstatuar, grupi i auditimit ka rekomanduar disa masa organizative, për përmirësimin e situatës.

*Aktet ligjore dhe rregullative mbi të cilat është mbështetur vlerësimi janë si mëposhtë:*

- Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë (nenet 162-165);
- Ligji nr. 154/2014 “*Për Organizimin dhe Funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit*”;
- Ligji nr. 10296, datë 08.07.2010 “*Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin*”, i ndryshuar dhe aktet ligjore në zbatim të tij;
- Ligji Nr. 9918, datë 19.05.2008, “*Për Komunikimet Elektronike në Republikën e Shqipërisë*”;
- Ligji Nr. 10325, datë 23.09.2010, “*Për Bazat e të Dhënave Shtetërore*”;
- Ligji Nr. 2/2017, “*Për Sigurinë Kibernetike*”;
- VKM 673, datë 22.11.2017 “*Për riorganizimin e Agjencisë Kombëtare të Shoqërisë së Informacionit*”, i ndryshuar;
- VKM nr. 710, datë 21.08.2013 “*Për krijimin dhe funksionimin e sistemeve të ruajtjes së informacionit, vazhdueshmërisë së punës dhe marrëveshjeve të nivelit të shërbimit*”, i ndryshuar;
- VKM nr. 945, datë 02.11.2012 “*Për miratimin e rregullores administrimi i sistemit të bazave të të dhënave shtetërore*”;
- Standardet TIK;
- Udhëzimi nr. 1159, datë 17.03.2014 “*Për hartimin e Marrëveshjes të Nivelit të Shërbimit*”, i ndryshuar;
- Rregulloret përkatëse të Agjencisë Kombëtare të Shoqërisë së Informacionit;
- Kontratat e lidhura midis institucioneve në auditim;
- Inventarin e aktiveve të AKU-së dhe IQ për rrjetet/sistemet;
- Aktet ligjore/nënligjore/rregullative që përcaktojnë regjistrimin dhe ruajtjen e të dhënave;
- Standardet e miratuara nga CESK, etj.

## ***II.7. Standardet e auditimit***

Auditimi është kryer, në përputhje me Kodin Etik, Standardet, dhe teknikat e auditimit të teknologjisë së informacionit, duke përfshirë pyetësorë, intervista, testim dhe procedura, të cilat u gjykuan se ishin të nevojshme, për të dhënë një vlerësim sa më objektiv, profesional e të pavarur, të saktë, të plotë e të qartë, duke u fokusuar veçanërisht në standardet e fushës së auditimit të TIK, si: COBIT 4.1, Manuali i Auditimit IT, ISSAI 5310, etj.

## ***II.8. Metodatat e auditimit***

Metodat mbi auditimin e sistemeve të Teknologjisë së Informacionit që grupi i auditimit ka ndjekur, janë si mëposhtë:

- Intervista zhvilluar në subjekt me personat përgjegjës;
- Verifikime të sistemit si përdorues;
- Shqyrtimi i dokumentacionit rregullativ të institucionit;
- Analizimi i të dhënave të eksportuara nga sistemi, etj.

## ***II.9. Dokumentimi i auditimit***

Dokumentimi i auditimit është bazuar në rregulloren e brendshme të KLSH si dhe në manualin aktiv të auditimit të Teknologjisë së Informacionit në të cilin janë përfshirë:

- Planifikimi, qëllimi dhe objektivat e auditimit;
- Programi i auditimit;
- Evidencat e grumbulluara në lidhje me të dhënat e sistemit, raporte të ndryshme me të dhëna nxjerrë nga sistemi;
- Letrat e punës mbajtur nga audituesit sipas detyrave të përcaktuara gjatë fazës së auditimit në terren;

### **III. PËRSHKRIMI I AUDITIMIT:**

#### ***III.1. Informacioni i përgjithshëm mbi subjektin nën auditim***

Autoriteti Kombëtar i Ushqimit është institucioni përgjegjës për mbikëqyrjen e sigurisë ushqimore në Shqipëri, me funksione inspektuese në nivel kombëtar të fushës së sigurisë dhe mbrojtjes së konsumatorit, mbrojtjes së bimëve dhe shëndetit të kafshëve.

Teknologjia e informacionit është e rëndësishme në AKU pasi nëpërmjet saj institucioni kryen inspektimet dhe monitorimet online. Aktualisht, ofruesi dhe mirëmbajtësi i teknologjisë së informacionit është Agjencia Kombëtare e Shërbimit të Informacionit – AKSHI. AKU nuk disponon sistem të vetin elektronik, për kryerjen e inspektimit online, por sistemi në të cilin regjistrohen, ndiqen dhe administrohen këto të dhëna për të gjithë inspektoratet në vend është sistemi “e-inspektimi”. Ky sistem është administruar deri në vitin 2017 nga Inspektorati Qendror – IQ, ndërsa që prej vitit 2018 administrohet nga AKSHI. Problematikat e këtij sistemi AKU i ka adresuar tek Inspektorati Qendror, si institucioni përgjegjës për përmirësimin e veprimtarive së inspektimit në Republikën e Shqipërisë.

#### ***III.2. Përshkrimi i rezultateve sipas drejtimeve të auditimit:***

##### **III.2.1. Auditimi i funksionimit të Qeverisjes TIK.**

###### ***a. Strategjia, procedurat dhe rregulloret në TIK***

Mbi auditimin e ushtruar në Autoritetin Kombëtar të Ushqimit (AKU), Njësia e Teknologjisë të Informacionit e AKSHI-t atashuar për AKU si dhe Inspektorati Qendror në bazë të programit të auditimit nr. 978/1, datë 22.10.2021 mbajtur në datë 28.12.2021.

Në zbatim të pikës 1 (një) të programit të auditimit, u shqyrtuan ekzistenca e strategjisë dhe rregulloret në TIK si mëposhtë:

##### **1. Strategjia në TIK**

Mbështetur në bazën ligjore, VKM nr. 673, datë 22.11.2017 “Për riorganizimin e Agjencisë Kombëtare të Shoqërisë së Informacionit, i ndryshuar me Vendim nr. 36, datë 24.1.2018, me vendim nr. 448, datë 26.7.2018, me Vendim nr.872, datë 24.12.2019”

Sipas pikës 6, Agjencia Kombëtare e Shoqërisë së Informacionit, në ushtrim të veprimtarisë së saj, kryen edhe këto detyra e përgjegjësi të veçanta, si mëposhtë:

- a) Merr pjesë në hartimin e strategjive të agjendës digjitale;
- b) Bashkërendon planin e veprimit të strategjisë së agjendës digjitale për ofrimin e shërbimeve elektronike në organet dhe institucionet e administratës publike, për qytetarët, si dhe subjektet private;
- c) Përcakton standardet Shqiptare të TIK-ut, në përputhje me standardet ndërkombëtare dhe evropiane, të adoptuara, të cilat do të ndiqen nga administrata shtetërore. Këto standarde botohen në Buletinin e Njoftimeve Publike;
- ll) Merr pjesë në hartimin e strategjisë ndër-sektoriale të agjendës digjitale dhe bashkërendon punën për zbatimin e saj;
- m) Merr pjesë në hartimin e dokumentit të politikës së zhvillimit në fushën e komunikimeve elektronike e-GOV, si një nga komponentët e rëndësishëm të infrastrukturës TIK.

Në kapitullin III, funksionimi dhe organizimi i AKSHI-t:

9. AKSHI është administrator i çdo sistemi TIK që ka si përdorues institucionet apo organet e administratës shtetërore nën përgjegjësinë e Këshillit të Ministrave.

10. Në përbërje të AKSHI-t, pranë çdo institucioni dhe organi të administratës shtetërore nën përgjegjësinë e Këshillit të Ministrave, krijohen dhe funksionojnë njësitë e teknologjisë së informacionit e të komunikimit (NJTIK), si strukturë organizativo-teknike për projektimin, zbatimin dhe administrimin e qeverisjes elektronike, në institucion, nëpërmjet teknologjisë së informacionit e të komunikimit (TIK).

11. Njësia e teknologjisë së informacionit e të komunikimit është përgjegjëse për:

- a) administrimin e infrastrukturës, sistemeve dhe shërbimeve TIK në ministrinë e linjës dhe në institucionet e varësisë, në rast se nuk detajohet ndryshe. Për pajisjet, sistemet në të cilat përpunohet informacioni i klasifikuar “sekret shtetëror”, NATO, BE, shteteve dhe organizatave të tjera ndërkombëtare, administrimi i kësaj infrastrukture kryhet sipas legjislacionit në fuqi për informacionin e klasifikuar;
- b) ofrimin e shërbimit të asistencës të nivelit 1, për infrastrukturën fizike, pajisjet TIK dhe funksionimin e sistemit për institucionin ku funksionon njësia.

Nga shqyrtimi i dokumentacionit të vënë në dispozicion:

Autoriteti Kombëtar i Ushqimit sipas rregullores së brendshme miratuar me Urdhër nr. 377, datë 05.09.2017 “Për organizimin dhe funksionimin e Autoritetit Kombëtar të Ushqimit”, ka si mision kryesor garantimin e shëndetit të qytetarëve dhe mbrojtjen e konsumatorit. Të vendosë dhe konsolidojë në vijimësi bazat për sigurimin e një niveli të lartë të mbrojtjes së shëndetit të njeriut dhe interesat e konsumatorit, në të gjitha fazat e prodhimit primar dhe në të gjitha fazat e trajtimit, përpunimit dhe shpërndarjes së ushqimeve dhe ushqimeve për kafshët. Sipas nenit 4, “Objektivat e Autoritetit Kombëtar të Ushqimit”, synon arritjen e këtyre objektivave:

- Hartimi dhe zbatimi i një plani strategjik dhe të detajuar mbi ndërgjegjësimin e konsumatorit;
- Përafrimi i strukturës dhe veprimtarisë së AKU-së sipas modeleve të institucioneve analoge të vendeve të BE-së;
- Përmirësimi i mëtejshëm i kuadrit ligjor dhe plotësimi i tij me akte nënligjore, në përputhje me direktivat e BE-së;
- Rritja e nivelit profesional të punonjësve me qëllim rritjen e cilësisë së veprimtarisë së AKU-së;
- Trajnimi i vazhdueshëm i punonjësve të Autoritetit Kombëtar të Ushqimit nëpërmjet pjesëmarrjes aktive në seminare dhe trajnime;
- Rritja e efektivitetit të punës së laboratorëve të AKU-së në fushën e sigurisë ushqimore;
- Furnizimi i infrastrukturës, kapaciteteve të burimeve njerëzore dhe burimeve financiare të AKU-së;
- Përgatit materiale informuese për praktikën e mira të prodhimit bujqësor, praktikën e mira të përpunimit, praktikën e mira të higjienës, për aplikimin e sistemit HACCP dhe për praktikën e mira laboratorike;
- Ofron mendim shkencor për ushqimin, vlerat ushqimore të ushqimit dhe tema të tjera që lidhen me sigurinë ushqimore si dhe mbrojtjen e bimëve;
- Bashkëpunon me institucione dhe organizma ndërkombëtarë, që trajtohen çështjet e sigurisë ushqimore dhe mbrojtjes së bimëve.

Neni 9, germa 1, një ndër funksionet e Drejtorisë së Përgjithshme të AKU-së është edhe, menaxhimi i burimeve njerëzore, çështjet ligjore, teknologjia e informacionit, mirëmbajtja dhe shërbimet e tjera mbështetëse.

Neni 10, Drejtori i Përgjithshëm i AKU-së përfaqëson institucionin dhe është përgjegjës për ushtrimin e veprimtarisë së AKU-së, në përputhje me legjislacionin në fuqi. Ai përgatit propozime për dokumentacionin që i dërgohet bordit, për miratimin e tyre.

Neni 11, Kompetencat e Drejtorit të Përgjithshëm të AKU-së:

b. I propozon bordit objektivat strategjike, planin e punës dhe buxhetin afatshkurtër dhe afatmesëm të AKU-së;

d. Përcakton objektivat e përgjithshme të AKU-së, në përputhje me objektivat strategjike, të miratuara nga bordi, dhe harton planin vjetor të punës së këtij të fundit;

e. i propozon bordit rregulloren e brendshme të AKU-së dhe ndryshimet në të;

h. miraton planin vjetor të trajnimeve në zbatim të legjislacionit për shërbimin civil.

**Nga auditimi u konstatua se,** nga relacioni nr. 3697/1, datë 31.08.2020, lidhur me ndryshimet dhe shtesat në strukturën organizative të Autoritetit Kombëtar të Ushqimit, dërguar nga AKU, janë parashikuar veç të tjerave edhe krijimi për herë të parë i Sektorit të Planifikimit Strategjik dhe Raportimit, për të cilin parashikohet hartimi i objektiveve dhe dokumenteve strategjike për AKU-në, plane veprimi me fokus përcaktimin e objektiveve SMART, zhvillimin profesional në drejtime të ndryshme, etj.,

Më pas është miratuar struktura organizative e Autoritetit Kombëtar të Ushqimit nga Kryeministri me Urdhër nr. 128, datë 26.10.2020 “Për miratimin e strukturës dhe të organikës së Autoritetit Kombëtar të Ushqimit”, e cila në përbërjen e saj ka të përfshirë edhe Sektorin e Planifikimit Strategjik dhe Raportimit. Ky sektor është i ri dhe për këtë nuk ka një rregullore të përditësuar dhe/ose propozuar ndryshimi i saj, çka krijon hapësirë dhe ngërç, duke mos pasur kështu të specifikuar më me detaje, kompetencat, detyrat dhe të drejtat për këtë sektor.

### **Strategjia dhe Planifikimi IT**

Strategjia e TIK përfaqëson lidhjen e përbashkët midis objektiveve të Strategjisë së TIK dhe atyre të strategjisë së institucionit. Objektivat e strategjisë së TIK duhet të marrin parasysh nevojat e tashme dhe të ardhshme të biznesit, kapacitetin aktual të TIK për të ofruar shërbime dhe kërkesat e burimeve. Strategjia duhet të marrë në konsideratë ekzistencën e infrastrukturës dhe arkitekturës së IT, investimeve, modelit të ofrimit, burimet duke përfshirë stafin, si dhe paraqitjen e strategjisë që integron këto elementë në një qasje të përbashkët për të mbështetur objektivat e institucionit.

**Nga auditimit u konstatua se,** AKU nuk ka të miratuar ende një strategji institucionale për AKU-në, si dhe nuk ka elementë të strategjisë për teknologjinë e informacionit.

### **2. Procedurat dhe Rregulloret në TIK**

Sipas VKM-së nr. 696, datë 16.08.2013, “Për përcaktimin e procedurave të ushtrimit të kompetencave të Inspektoratit Qendror dhe të rregullave për mirëmbajtjen dhe administrimin e portalit unik e-inspektimi”, ka për qëllim krijimin e kuadrit rregullues për bashkëpunimin dhe mbështetjen e veprimtarisë së inspektorateve shtetërore dhe në raste të veçanta, të ministrive të linjës, nga Inspektorati Qendror, si dhe rregullat për përmbajtjen dhe administrimin e portalit unik të inspektimit. Kjo VKM është e zbatueshme nga institucionet qendrore të ngarkuara me një apo disa funksione në juridiksionin e pushtetit ekzekutiv, të përcaktuara sipas dispozitave në fuqi të ligjit për inspektimin.

Sipas kreut III, pika 1, Inspektorati Qendror miraton rregullat e përgjithshme, mbi bazën e të cilave inspektoratet shtetërore hartojnë dhe miratojnë rregullat specifike për fushën e tyre të inspektimit për:

- a) Metodologjinë e vlerësimit të riskut;
- b) Programimin e inspektimeve;

- c) Dokumentimin e veprimtarisë së inspektimeve;
- d) Raportimin e veprimtarisë së inspektimeve;
- e) Treguesit e efektivitetit dhe cilësisë së veprimtarisë së inspektimit, si dhe kriteret e vlerësimit të tyre.

Për këto rregulla të përgjithshme në pikën 1, citohet *“kanë karakter detyrues për inspektoratet qendrore”*.

AKU në këtë rast është institucioni i cili, ka detyrimin si inspektorat shtetëror të hartojë rregulla specifike lidhur me aktivitetin dhe funksionin e tij si institucion, duke përfshirë të gjithë elementët e mësipërm.

Gjithashtu, sipas kreut XV, ngarkohet Inspektorati Qendror që të miratojë, në formë rregulloreje, rregullat e përgjithshme për portalin e-inspektimi, si dhe hartimin, miratimin dhe publikimin e manualeve dhe rregullave të brendshme për përdorimin dhe përmirësimin e Portalit.

Vihet re se, nëpërmjet korrespondencës midis AKU dhe Inspektoratit Qendror për portalin e-inspektimi vijon kronologjikisht si mëposhtë:

- Me Shkresën nr. 258 prot., datë 19.07.2016, “Për përdorimin e portalit unik të inspektimeve “e-inspektimi”, nga Autoriteti Kombëtar i Ushqimit”, dërguar nga Inspektorati Qendror i cili, ka mbështetur me asistencë procesin për të mundësuar funksionimin me efektivitet të portalit, specifikisht me pajisje elektronike dhe trajnim për 282 punonjësve, si dhe është kërkuar AKU-së ndërmarrja e hapave konkret për të përshpejtuar dhe finalizuar zbatimin e procedurave të inspektimit në terren përmes portalit “e-inspektimi” online.
- Me shkresën nr. 438 prot., datë 28.09.2016, “Për njohje dhe zbatim”, nga Inspektorati Qendror për të gjithë inspektoratet shtetërore është dërguar Urdhri nr. 432, datë 28.09.2016, “Për disa shtesa dhe ndryshime në Urdhrin nr. 15, datë 07.05.2016 “Për miratimin e rregullave për përcaktimin e procedurave dhe mënyrave, për përdorimin e portalit unik të inspektimeve e-inspektimi””.
- Me shkresë nr. 788, datë 20.02.2017, “Mbi zbatimin e procedurës së inspektimit online”, dërguar nga AKU, shprehet për pengesat sipas vlerësimit të tij mund të përbëjnë risk për cilësinë, por edhe mos realizimin e inspektimit.  
Për këtë nuk ka një përgjigje zyrtare të dërguar nga Inspektorati Qendror në protokollin e Autoritetit Kombëtar të Ushqimit.
- Me Urdhër nr. 284, datë 03.05.2017, “Për kryerjen e inspektimeve online”, dërguar inspektorateve shtetërore nga Inspektorati Qendror, ku mos kryerja dhe dokumentimi i veprimtarisë inspektuese online do të ngarkojë me përgjegjësi ligjore.
- Me shkresën nr. 741, datë 13.11.2018, “Për tërheqjen e rregullores nr. 25, datë 10.08.2018, “Për përcaktimin e procedurës, së inspektimeve, si një proces i rregullt administrativ” nga çdo inspektor shtetëror në detyrë pranë Inspektoratit Qendror brenda datës 30.11.2018, dërguar nga Inspektorati Qendror të gjithë inspektorateve shtetërore.
- Inspektorati Qendror me shkresën nr. 185 prot., datë 28.03.2019, “Njoftim për tërheqjen e rregullores”, dërguar Autoritetit Kombëtar të Ushqimit, sjellje në vëmendje për inspektorët që nuk kanë tërhequr rregulloren.

#### **Nga auditimi u konstatua se:**

- Autoriteti Kombëtar i Ushqimit nuk ka ende një Strategji Institucionale si dhe Strategji për Teknologjinë e Informacionit;
- Rregullorja e Brendshme për organizimin dhe funksionimin e AKU-së nuk është përditësuar, duke krijuar ngërçe për vazhdimësinë dhe ndarjen e të drejtave dhe detyrave sipas strukturës;

- Inspektorati Qendror si institucion i cili, ka detyrimin të hartojë dhe miratojë rregullore të përgjithshme, gjithashtu dhe publikimin e tyre, në këtë rast me ndryshimet e rregulloreve, ka informuar AKU për tërheqje rregullore nga inspektorët, pa dërguar në institucion këtë rregullore në mënyrë zyrtare;

AKU megjithëse nuk ka në strukturë specialist të fushës TIK, nuk ka marrë asnjë masë për adresimin e problematikave që ndesh në zbatimin e akteve rregullative miratuar nga CESK si:

- Rregullore mbi mbarëvajtjen dhe mënyrën e dokumentimit të masave të sigurisë;
- Rregullore për kategoritë e incidenteve kibernetike si dhe formatin dhe elementët e raportimit;
- Rregullore për menaxhimin e përdoruesve;
- Rregullore për administrimin e fjalëkalimeve në rrjetet dhe sistemet kompjuterike;
- Rregullore për menaxhimin e Firewall;
- Rregullore për menaxhimin e log-eve digjitale në administratën publike.

**1. Titulli i gjetjes:** Rregullorja e brendshme e AKU është e pa përditësuar.

**Situata:** Nga auditimi mbi aktet rregullative të brendshme që disponon AKU u konstatua se, Rregullorja e Brendshme nuk është e përditësuar në funksion të strukturës organizative pasi në të nuk janë paraqitur detyrat funksionale për Sektorin e Planifikimit Strategjik dhe Raportimit.

**Kriteri:** Urdhër nr.128, datë 26.10.2020 “Për miratimin e strukturës dhe të organikës së Autoritetit Kombëtar të Ushqimit” krahasuar me miratimin e rregullores së brendshme të vitit 2017.

**Ndikimi/Efekti:** Mos efektivitet mos arritje e objektivave.

**Shkaku:** Mos menaxhim të ndryshimit

**Rëndësia:** E lartë

**1.1 Rekomandimi:** Titullari i AKU, të marrë masa për përditësimin e rregullores së brendshme institucionale në të cilën krahas ndryshimeve të detyrave operacionale që mund të kenë ndryshuar të pasqyrohen dhe detyrat e sektorit të ri të Planifikimit Strategjik dhe Raportimit.

Strategjia e TIK përfaqëson lidhjen e përbashkët midis objektivave të Strategjisë së TIK dhe atyre të strategjisë së institucionit. Objektivat e strategjisë së TIK duhet të marrin parasysh nevojat e tashme dhe të ardhshme të biznesit, kapacitetin aktual të TIK për të ofruar shërbime dhe kërkesat e burimeve. Strategjia duhet të marrë në konsideratë ekzistencën e infrastrukturës dhe arkitekturës së IT, investimeve, modelit të ofrimit, burimet duke përfshirë stafin, si dhe paraqitjen e strategjisë që integron këto elementë në një qasje të përbashkët për të mbështetur objektivat e institucionit.

Bazuar në VKM nr. 673, datë 22.11.2017 “Për riorganizimin e Agjencisë Kombëtare të Shoqërisë së Informacionit, i ndryshuar me vendim nr. 36, datë 24.1.2018, me vendim nr. 448, datë 26.7.2018, me vendim nr.872, datë 24.12.2019”, pikën 6, AKSHI ka këto detyrime:

- Merr pjesë në hartimin e strategjive të agjendës digjitale;
  - Bashkërendon planin e veprimit të strategjisë së agjendës digjitale për ofrimin e shërbimeve elektronike në organet dhe institucionet e administratës publike, për qytetarët, si dhe subjektet private;
  - Përcakton standardet Shqiptare të TIK-ut, në përputhje me standardet ndërkombëtare dhe evropiane, të adoptuara, të cilat do të ndiqen nga administrata shtetërore. Këto standarde botohen në Buletinin e Njoftimeve Publike;
- Merr pjesë në hartimin e strategjisë ndër-sektoriale të agjendës digjitale dhe bashkërendon punën për zbatimin e saj;
  - Merr pjesë në hartimin e dokumentit të politikës së zhvillimit në fushën e komunikimeve elektronike e-GOV, si një nga komponentët e rëndësishëm të infrastrukturës TIK;

9. AKSHI është administrator i çdo sistemi TIK që ka si përdorues institucionet apo organet e administratës shtetërore nën përgjegjësinë e Këshillit të Ministrave.

10. Në përbërje të AKSHI-t, pranë çdo institucioni dhe organi të administratës shtetërore nën përgjegjësinë e Këshillit të Ministrave, krijohen dhe funksionojnë njësitë e teknologjisë së informacionit e të komunikimit (NJTIK), si strukturë organizativo-teknike për projektimin, zbatimin dhe administrimin e qeverisjes elektronike, në institucion, nëpërmjet teknologjisë së informacionit e të komunikimit (TIK).

11. Njësia e teknologjisë së informacionit e të komunikimit është përgjegjëse për:

- a) administrimin e infrastrukturës, sistemeve dhe shërbimeve TIK në ministritë e linjës dhe në institucionet e varësisë, në rast se nuk detajohet ndryshe. Për pajisjet, sistemet në të cilat përpunohet informacioni i klasifikuar “sekret shtetëror”, NATO, BE, shteteve dhe organizatave të tjera ndërkombëtare, administrimi i kësaj infrastrukture kryhet sipas legjislacionit në fuqi për informacionin e klasifikuar;
- b) ofrimin e shërbimit të asistencës të nivelit 1, për infrastrukturën fizike, pajisjet TIK dhe funksionimin e sistemit për institucionin ku funksionon njësia.

Për të gjithë kërkesat ligjore të lartpërmendura u konstatua se, AKSHI nuk i përmbush duke mos bashkërenduar dhe bashkëpunuar me IQ dhe AKU.

**2. Titulli i gjetjes:** Mungesa e strategjisë institucionale dhe e TI për AKU.

**Situata:** Nga auditimi u konstatua se, AKU nuk ka ndërtuar dhe miratuar një strategji institucionale me elementë të strategjisë së teknologjisë së informacionit.

**Kriteri:** Ligj nr.10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin” kreu ii përgjegjshmëria menaxheriale neni 8, “Përgjegjshmëria menaxheriale e titullarit” ku citohet “Titullarët e njësive publike në fushën e menaxhimit financiar dhe kontrollit kanë këto kompetenca kryesore:

a) hartimin e politikave, miratimin dhe monitorimin e objektivave të njësive publike që ata drejojnë, të planeve strategjike e vjetore, përfshirë strategjinë e menaxhimit të riskut dhe të plan-veprimeve për arritjen e objektivave;

b) ngritjen e grupit të menaxhimit strategjik të njësisë publike në përputhje me kërkesat e nenit 27 të këtij ligji.

**Ndikimi/Efekti:** Mos arritja e objektivave të strategjisë së TIK.

**Shkaku:** Mos hartimi dhe miratimi i një strategjie për TIK në subjektet në auditim.

**Rëndësia:** E lartë

**2.1 Rekomandimi:** AKU të marrë në konsideratë elementë të strategjisë së teknologjisë së informacionit në hartimin dhe miratimin e strategjisë institucionale që do të zhvillojë në vitet në vijim, e cila në të gjithë hallkat e saj duhet që nëpërmjet teknologjisë të mbështesë arritjen e objektivave të institucionit. Për ofrimin e shërbimeve elektronike AKU të bashkëpunojë me AKSHI-n, si institucion përgjegjës për hartimin e strategjisë së agjendës digjitale dhe bashkërendimin e planit të veprimit për këto shërbime.

*AKSHI, ka paraqitur observacion me shkresën nr.7255/3, datë 25.02.2022 protokolluar në KLSH me nr.978/9 datë 01.03.2022, ku citohet:*

***Pretendimi:** Nuk është përcaktuar në mënyrë të qartë dhe konkrete përgjegjësia që ka AKSHI në gjetjet e konstatuara mbi strukturën e AKU-së dhe detyrat funksionale të një sektori të brendshëm të këtij institucioni.*

***Qëndrimi i grupit të auditimit:***

*Për sa më lart, sqarojmë se sipas VKM nr.673, datë 22.11.2017 “Për riorganizimin e Agjencisë Kombëtare të Shoqërisë së Informacionit”, e ndryshuar, pika 6, germa a dhe b përcakton shumë qartë përgjegjësinë, ku citohet: germa a) “Merr pjesë në hartimin e strategjive të agjendës digjitale, germa b) Bashkërendon planin e veprimit të strategjisë së agjendës digjitale për*

ofrimin e shërbimeve elektronike në organet dhe institucionet e administratës publike,... etj.” Që do të thotë se në digjitalizimin e shërbimeve të AKU, AKSHI duhet të jetë pjesëmarrës aktiv. Ne pranojmë observacionin tuaj pjesërisht duke reflektuar ndryshime në gjetje dhe rekomandim.

*Për sa më lart, grupi i auditimit e merr në konsideratë pjesërisht observacionin.*

*Inspektorati Qendror, ka paraqitur observacion me shkresën nr.44/1, datë 31.01.2022 protokolluar në KLSH me nr.978/6 datë 09.02.2022, ku citohet:*

**Pretendimi:** Objeksione në lidhje me gjetjen nr. 3, lidhur me rregulloren “Për përcaktimin e procedurës së Inspektimit si një proces i rregullt ligjor”, IQ ka dërguar me shkresën nr. 536 prot., datë 29.08.2018, me lëndë “Për zbatim të Urdhrit nr. 25, datë 10.08.2018”, i është dërguar AKU për njohje dhe zbatim të Urdhrit nr. 25, datë 10.08.2018, “Për miratimin e rregullore për përcaktimin e procedurës së inspektimit si një proces i rregullt ligjor”.

**Qëndrimi i grupit të auditimit:**

*Për sa më lart, pretendimi qëndron për sa kohë është dërguar shkresë zyrtare në AKU për rregulloren e procedurës së inspektimit dhe grupi i auditimit e merr në konsideratë observacionin dhe e reflekton në Raporti Përfundimtar.*

*AKSHI, ka paraqitur observacion me shkresën nr.7255/3, datë 25.02.2022 protokolluar në KLSH me nr.978/9 datë 01.03.2022, ku citohet:*

**Pretendimi:** Në asnjë dispozitë ligjore të VKM nr. 673, datë 22.11.2017 “Për riorganizimin e Agjencisë Kombëtare të Shoqërisë së Informacionit”, nuk përcaktohet që AKSHI duke qenë institucion që ofron shërbime TIK për institucionet dhe organet e administratës shtetërore në varësi të Këshillit të Ministrave, është përgjegjëse apo ka për detyrë të miratojë rregullore për përdorimin e portaleve apo sistemeve, të dhënat e të cilave, administrohen nga institucionet e tjera. Sipas kësaj VKM, ngarkohet AKSHI të marrë pjesë në përgatitjen e akteve rregullatore, ligjore e nënligjore, për zhvillimin e SHI-së dhe të TIK-ut, por gjithmonë në bazë të kërkesave të institucioneve përkatëse.

**Qëndrimi i grupit të auditimit:**

Për sa më lart, pretendimi që ju ngrini qëndron, pasi në VKM nr. 673, datë 22.11.2017 “Për riorganizimin e Agjencisë Kombëtare të Shoqërisë së Informacionit”, shprehet qartë në pikën 6/n) ku citohet se AKSHI “Merr pjesë në përgatitjen e akteve rregullatore, ligjore e nënligjore, për zhvillimin e SHI-së dhe të TIK-ut”. Meqënëse AKU nuk është në listën e infrastrukturës kritike apo të rëndësishme, kemi marrë plotësisht parasysh observacionin tuaj.

*Për sa më lart, grupi i auditimit e merr në konsideratë observacionin dhe e pasqyron në këtë Raport Auditimi.*

## **2.2 Auditimi i zhvillimit dhe blerjes në teknologjinë e informacionit**

*Marrëveshjet e nivelit të shërbimit (Service Level Agreement)*

Mbi auditimin e ushtruar në Autoritetin Kombëtar të Ushqimit (AKU), Njësia e Teknologjisë të Informacionit e Agjencisë Kombëtare të Shoqërisë së Informacionit (AKSHI) atashuar për AKU si dhe Inspektorati Qendror (IQ), në bazë të programit të auditimit nr. 978/1, datë 22.10.2021 mbajtur në datë 28.12.2021.

Në zbatim të pikës 2 (dy) të programit të auditimit, u shqyrtuan “Marrëveshjet e Nivelit të Shërbimit (Service Level Agreement)”, në AKU në përmbushje të drejtimit të “Auditimi i zhvillimit dhe blerjes në teknologjinë e informacionit”, si më poshtë:

Baza ligjore e dokumentare për auditimin:

- VKM nr. 673, datë 22.11.2017 “Për riorganizimin e Agjencisë Kombëtare të Shoqërisë së Informacionit”;
- VKM nr. 710 datë 21.08.2013 “Për krijimin dhe funksionimin e sistemeve të ruajtjes së informacionit, vazhdueshmërisë së punës dhe marrëveshjeve të nivelit të shërbimit” i ndryshuar;
- Kontratat e AKSHI-t si Autoriteti Kontraktor lidhur për mirëmbajtjen e sistemit e-inspektimi;
- Inventarin e aktiveve të AKU-së dhe IQ për rrjetet/sistemet, etj.

Ndër detyrat funksionale të AKSHI-t, Njësia e Teknologjisë të Informacionit e AKSHI-t, bazuar në VKM nr. 673, datë 22.11.2017 “Për riorganizimin e Agjencisë Kombëtare të Shoqërisë së Informacionit”, i ndryshuar, pika 6, janë:

- Ngre, mirëmban dhe administron sisteme dhe aplikacione të teknologjisë së informacionit dhe komunikimit, infrastrukturën e qendëruar dhe infrastrukturën TIK, përfshirë edhe ato të klasifikuara si “sekret shtetëror”;
- Organizon, kryen prokurimet e qendëruara dhe lidh kontratat për sistemet, pajisjet software dhe hardware, mirëmbajtjen, si dhe shërbimet e internetit dhe intranetit;
- Përgjigjet për ngritjen, mirëmbajtjen e sistemeve dhe aplikacioneve të teknologjisë së informacionit dhe komunikimit, për infrastrukturën e qendëruar dhe infrastrukturën TIK;
- Administron nga ana teknike sistemin informatik të institucioneve publike si dhe merr pjesë në hartimin e dokumentit të politikës së zhvillimit në fushën e komunikimeve për zhvillimin e Infrastrukturës së TIK-ut;
- Si institucion që nxit veprimtarinë e sektorit të teknologjisë së informacionit dhe komunikimit, është në ngarkim të zhvillimit të procedurave të prokurimit në Institucionet Publike.

Midis Agjencisë Kombëtare të Shoqërisë së Informacionit dhe bashkimit të operatorëve “I. S.” ShPK, dhe “I” ShPK është lidhur kontrata nr. 5549, datë 15.10.2018, me objekt “*Mirëmbajtja e sistemit e-inspektimi për Inspektoratin Qendror*”, me vlerë 77,660,988 lekë me TVSH. Zbatimi i kontratës do të fillojë me lidhjen e kontratës dhe do të vazhdojë për 2 (dy) vite.

**Nga auditimi u konstatua se**, nuk është nënshkruar marrëveshje për shërbimit që ofron AKSHI kundrejt Autoritetit Kombëtar të Ushqimit, ku të përcaktohen shërbimet e ofruara, mënyrat e raportimit, parametrat dhe niveli i ofrimit të shërbimit si p.sh. Orët/nivelet e suportit/përgjegjësitë/ kufizimet, etj.

Sa më lart, është në kundërshtim me, VKM nr.710, datë 21.08.2013 “Për krijimin dhe funksionimin e sistemeve të ruajtjes së informacionit, vazhdueshmërisë së punës dhe marrëveshjeve të nivelit të shërbimit” i ndryshuar, pika 2 dhe 2a që parashikon: “çdo institucion, i cili ka ose do të zhvillojë një sistem në fushën e teknologjisë së informacionit, që ofron shërbime për qytetarët, për biznesin dhe për ndërveprim e shkëmbim informacioni për administratën publike nëpërmjet sistemeve elektronike, duhet të parashikojë dhe të hartojë marrëveshje kontraktuale mbi nivelin e shërbimit. Kjo marrëveshje, nënshkruhet ndërmjet institucionit publik dhe ofruesit të shërbimit të TIK-ut dhe hartohet sipas udhëzimeve të nxjerra nga ministri për çështjet e teknologjisë së informacionit. Institucionet të cilat janë duke zhvilluar sisteme të reja në fushën e teknologjisë së informacionit, duhet të parashikojnë këtë marrëveshje, për mirëmbajtjen e këtyre sistemeve. Kohëzgjatja e kësaj marrëveshjeje duhet të jetë jo më e shkurtër se 4 (katër) vjet.”

Gjithashtu, është në kundërshtim me Udhëzimin nr. 1159, datë 17.03.2014 “Për hartimin e marrëveshjes së nivelit të shërbimit”, Pika 1, ku parashikon: “Çdo institucion, i cili ka ose do

të zhvillojë një sistem në fushën e teknologjisë së informacionit dhe komunikimit (TIK), që ofron shërbime për qytetarët, biznesin dhe për ndërveprim e shkëmbim informacioni për administratën publike nëpërmjet sistemeve elektronike, duhet të parashikojë dhe të hartojë marrëveshje të nivelit të shërbimit (MNSH). Në këtë marrëveshje përcaktohen parametrat dhe niveli i ofrimit të shërbimeve, përfshirë, minimalisht, këto elemente:

- a) orët gjatë të cilave shërbimet janë funksionale;
- b) disponueshmërinë e shërbimeve e kohën mesatare ndërmjet ndërprerjeve të shërbimeve;
- c) kohën mesatare të rikuperimit;
- ç) nivelet e suportit, përgjegjësitë dhe kufizimet.”

**Nga auditimi** mbi zbatimin e kontratës së mësipërme u konstatua se, sipas kushteve të veçanta të kontratës neni 8, është përcaktuar si përfituesi i shërbimit Inspektorati Qendror, i cili do të kryej dhe pagesën, ndërkohë që Autoriteti Kontraktor është Agjencia Kombëtare e Shoqërisë të Informacionit me Kontraktues Bashkimin e operatorëve “I.S.” ShPK, dhe “I” ShPK.

Sipas kushteve të përgjithshme të kontratës baza ligjore për hartimin e kësaj kontrate është Ligji nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, Kodi Civil i Republikës së Shqipërisë, Kreu II, pika 5/j e VKM nr. 673, datë 22.11.2017 “Për riorganizimin e Agjencisë Kombëtare të Shoqërisë së Informacionit”.

Kjo kontratë është firmosur nga AKSHI në cilësinë e Autoritetit Kontraktor në një kohë kur AKSHI organizon, kryen prokurimet e përqendruara për pajisjet TIK, për institucionet e administratës shtetërore nën përgjegjësinë e Këshillit të Ministrave dhe nuk lidh kontrata.

Sa më lart nënshkrimi i kontratës është në kundërshtim me VKM nr. 673, datë 22.11.2017 “Për riorganizimin e Agjencisë Kombëtare të Shoqërisë së Informacionit”, Kreu II, pika 5, germa j) Organizon, kryen prokurimet e përqendruara për pajisjet TIK, përfshirë edhe ato të klasifikuara si “sekret shtetëror”, për institucionet e administratës shtetërore nën përgjegjësinë e Këshillit të Ministrave.

Me VKM nr. 872, datë 24.12.2019 për disa ndryshime dhe shtesa në vendimin nr. 673, datë 22.11.2017, të KM, "Për riorganizimin e Agjencisë Kombëtare të Shoqërisë së Informacionit", të ndryshuar, Në Kreun II, bëhen ndryshimet dhe shtesat, si mëposhtë vijon:..ii. Në shkronjën “j”, fjalët “lidh kontrata”, hiqen”.

Me Urdhër të përbashkët nr. 280 prot., datë 29.04.2020 nga Inspektorati Qendror dhe nr. 1959 prot., datë 21.04.2020 nga AKSHI, është bërë kalimi kapital nga Inspektorati Qendror tek AKSHI i sistemit me objekt “Upgrade i sistemit e-inspektimi” i kontratës nr. 4855, datë 21.09.2018.

Sipas VKM nr. 696, datë 16.08.2013, “Për përcaktimin e procedurave të ushtrimit të kompetencave të inspektoratit qendror dhe të rregullave për përmbajtjen dhe administrimin e portalit unik “e-inspektimi””, kapitulli X pika 2 dhe kapitulli XIII pika 5, ndërkohë që sipas VKM nr. 673, datë 22.11.2017 “Për riorganizimin e agjencisë kombëtare të shoqërisë së informacionit, i ndryshuar me Vendim nr. 36, datë 24.1.2018, me Vendim nr. 448, datë 26.7.2018”, paragrafi II/gj, citohet se AKSHI “Ngre, mirëmban dhe administron sisteme dhe aplikacione të teknologjisë së informacionit dhe komunikimit, infrastrukturën e qendëruar dhe infrastrukturën TIK, përfshirë edhe ato të klasifikuara si “sekret shtetëror”, për institucionet dhe organet e administratës shtetërore nën përgjegjësinë e Këshillit të Ministrave.”. Kështu duke rënë në kundërshtim dy VKM-të për administratorin e portalin e-inspektimi, pasi njëherë qëndron IQ dhe pastaj me miratimin e VKM nr. 673, datë 22.11.2017, administrator i sistemit e-inspektimi është AKSHI, por pa rregulluar apo shfuqizuar VKM nr. 696, datë 16.08.2013.

Me transferimin e asetit tek AKSHI, kjo kontratë është amenduar me nr. 1901 prot., datë 16.04.2020, me arsyen se:

1. Autoriteti Kontraktor dhe Kontraktori kanë lidhur kontratë shërbimi me nr. Prot., 5549, datë 15.10.2018 me objekt “Mirëmbajtja e sistemit e-inspektimi për Inspektoratin Qendror” me vlerë 64,7171,419 lekë pa TVSh ose 77,660,988 lekë me TVSh;
2. Institucioni përfitues, Inspektorati Qendror, nuk ka mundësi në vazhdimësi të disponojë fondet e nevojshme dhe si rrjedhim kryerjen e pagesave respektive sikurse përcaktohet edhe në kontratën e nënshkruar me nr. Prot., 5549, datë 15.10.2018, si dhe argumentuar kjo me shkresën nr. 244 prot., datë 10.04.2020, ku shprehet se: Inspektorati Qendror për vitin 2019, bazuar në ligjin për buxhetin e miratuar për vitin 2019 dhe komunikimit në formë shkresore me Ministrinë e Financave për të parashikuar për vitin 2020 diferencën për të likuiduar detyrimin e kontratës së mësipërme. Në ligjin për buxhetin 2020 fondet për likuidimin e kësaj kontratë i kalojnë AKSHI-t. Në këto kushte fondet për projektin në fjalë “Mirëmbajtja e sistemit e-inspektimi për Inspektoratin Qendror” në cilësinë e paguesit të shërbimit, i kanë kaluar “Agjencisë Kombëtare të Shoqërisë së Informacionit”;
3. Palët bien dakord të ndryshojnë mënyrën e realizimit të pagesës së kontratës së shërbimit, në përputhje me kushtet që vijojnë në këtë Amendament.

Palët bien dakord, sipas objektit të kontratës:

- 1.1 Nëpërmjet këtij amendamenti, palë bien dakord që pagesa e përcaktuar në Nenin 8 të kontratës në pjesën Kushtet e Veçanta, nuk do të kryhet nga Institucioni përfitues i shërbimit Inspektorati Qendror, por nga Agjencia Kombëtare e Shoqërisë së Informacionit;
- 1.2 Si rrjedhojë Kontraktori do të faturojë për llogari të Agjencisë Kombëtare të Shoqërisë së Informacionit, shërbimet sipas faturave të cilat rezultojnë të papaguara nga përfituesi “Inspektorati Qendror”;
- 1.3 Kontraktori do të përgatisë faturë negative për llogari të përfituesit “Inspektorati Qendror” faturave të cilat rezultojnë të papaguara.

Në vijimësi, është lidhur kontrata midis Agjencisë Kombëtare të Shoqërisë së Informacionit dhe bashkimit të operatorëve “I. S.” ShPK, dhe “I” ShPK është lidhur kontrata nr. 255, datë 14.01.2021, me objekt “*Mirëmbajtja e sistemit e-inspektimi për Inspektoratin Qendror*”, me vlerë 77,428,440 lekë me TVSH. Zbatimi i kontratës do të fillojë me lidhjen e kontratës dhe do të vazhdojë për 24 (njëzetë e katër) muaj, dhe sipas kushteve të veçanta të kontratës neni 8, është përcaktuar që pagesa do të kryhet nga AKSHI.

**Nga auditimi u konstatua se,** nuk është nënshkruar marrëveshje për shërbimit që ofron AKSHI kundrejt Autoritetit Kombëtar të Ushqimit, ku të përcaktohen shërbimet e ofruara, mënyrat e raportimit, parametrat dhe niveli i ofrimit të shërbimit si p.sh. Orët/nivelet e suportit/përgjegjësitë/ kufizimet, etj.

Sa më lart, është në kundërshtim me, VKM nr.710, datë 21.08.2013 “Për krijimin dhe funksionimin e sistemeve të ruajtjes së informacionit, vazhdueshmërisë së punës dhe marrëveshjeve të nivelit të shërbimit” i ndryshuar, pika 2 dhe 2a që parashikon: “çdo institucion, i cili ka ose do të zhvillojë një sistem në fushën e teknologjisë së informacionit, që ofron shërbime për qytetarët, për biznesin dhe për ndërveprim e shkëmbim informacioni për administratën publike nëpërmjet sistemeve elektronike, duhet të parashikojë dhe të hartojë marrëveshje kontraktuale mbi nivelin e shërbimit. Kjo marrëveshje, nënshkruhet ndërmjet institucionit publik dhe ofruesit të shërbimit të TIK-ut dhe hartohet sipas udhëzimeve të nxjerra nga ministri për çështjet e teknologjisë së informacionit. Institucionet të cilat janë duke

zhvilluar sisteme të reja në fushën e teknologjisë së informacionit, duhet të parashikojnë këtë marrëveshje, për mirëmbajtjen e këtyre sistemeve. Kohëzgjatja e kësaj marrëveshjeje duhet të jetë jo më e shkurtër se 4 (katër) vjet.”

Në kundërshtim me Udhëzimin nr. 1159, datë 17.03.2014 “Për hartimin e marrëveshjes së nivelit të shërbimit”, Pika 1, ku parashikon: “Çdo institucion, i cili ka ose do të zhvillojë një sistem në fushën e teknologjisë së informacionit dhe komunikimit (TIK), që ofron shërbime për qytetarët, biznesin dhe për ndërveprim e shkëmbim informacioni për administratën publike nëpërmjet sistemeve elektronike, duhet të parashikojë dhe të hartojë marrëveshje të nivelit të shërbimit (MNSH). Në këtë marrëveshje përcaktohen parametrat dhe niveli i ofrimit të shërbimeve, përfshirë, minimalisht, këto elemente:

- a) orët gjatë të cilave shërbimet janë funksionale;
- b) disponueshmërinë e shërbimeve e kohën mesatare ndërmjet ndërprerjeve të shërbimeve;
- c) kohën mesatare të rikuperimit;
- ç) nivelet e suportit, përgjegjësitë dhe kufizimet.”

AKSHI me shkresë nr. 2101, datë 04.05.2018, me lëndë, “Mbi personat e ngarkuar për evidentimin dhe kryerjen e kalimit kapital të infrastrukturës hardware dhe software dhe sistemeve IT” dërguar MBZhR (këtu edhe AKU). Me Urdhër të përbashkët nr. 5242 prot., datë 31.05.2018 nga Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural dhe nr. 2483 prot., datë 31.05.2018 nga AKSHI, kërkohet ngritja e grupit të punës për përcaktimin e listës së aktiveve për infrastrukturën hardware dhe software TIK objekt kalimi kapital. Me Akt-Dorëzimin nr. 3339/2prot., datë 08.06.2018 Autoriteti Kombëtar i Ushqimit është bërë dorëzimi fizik i Aktiveve për infrastrukturën hardware dhe software dhe sistemit TIK tek Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural.

**Nga auditimi u konstatua se**, Inspektorati Qendror nuk i disponon raportet e mirëmbajtjes për sistemin e-inspektimi, si institucion i cili administron sistemin e-inspektimi ka detyrimin që këto raporte të jenë pjesë e dosjes dhe dokumentacionit i cili duhet të mbahet nga Inspektorati Qendror. Ky veprim bie në kundërshtim me Udhëzimin nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, kapitulli II, pika 23/f dhe 23/g. Si dhe këto raporte janë të firmosura vetëm nga OE dhe jo nga të Inspektorati Qendror.

**Nga auditimi u konstatua se:**

- Nuk është nënshkruar marrëveshje për shërbimit që ofron AKSHI kundrejt Autoritetit Kombëtar të Ushqimit, ku të përcaktohen shërbimet e ofruara, mënyrat e raportimit, parametrat dhe niveli i ofrimit të shërbimit si p.sh. Orët/nivelet e suportit/ përgjegjësitë/ kufizimet, etj.
- Nuk është nënshkruar marrëveshje për shërbimit që ofron AKSHI kundrejt IQ, ku të përcaktohen shërbimet e ofruara, mënyrat e raportimit, parametrat dhe niveli i ofrimit të shërbimit si p.sh. Orët/nivelet e suportit/ përgjegjësitë/ kufizimet, etj.
- Kontrata e lidhur me objekt “Mirëmbajtja e sistemit e-inspektimi për Inspektoratin Qendror”, është lidhur me AKSHI-n dhe operatorët ekonomik “I.S.” ShPK, dhe “I” ShPK, ndërkohë që Inspektorati si përfitues i shërbimit ka bërë pagesën e këtij shërbimi në kundërshtim me Udhëzimin nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, kapitulli II, pika 23/f dhe 23/g;
- Raportet e mirëmbajtjes së sistemit e-inspektimi nuk janë pjesë e dokumentacionit që disponon IQ në kundërshtim me Udhëzimin nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, kapitulli II, pika 23/f dhe 23/g.

**3. Titulli i gjetjes:** Nuk është nënshkruar marrëveshje institucionale ndërmjet AKSHI-t dhe AKU-s për shërbimet TIK që ofron AKSHI.

**Situata:** Nuk është nënshkruar marrëveshje për shërbimet TIK që ofron AKSHI kundrejt Autoritetit Kombëtar të Ushqimit dhe IQ, ku të përcaktohen shërbimet e ofruara, mënyrat e raportimit, parametrat dhe niveli i ofrimit të shërbimit si p.sh. Orët/nivelet e suportit/përgjegjësitë/ kufizimet, etj.

**Kriteri:** VKM nr. 673, datë 22.11.2017 “Për riorganizimin e agjencisë kombëtare të shoqërisë së informacionit” Rregullores së Brendshme të AKSHI-t nr. 1900, datë 16.04.2020 “Mbi detyrat dhe funksionimi i Agjencisë Kombëtare të Shoqërisë së Informacionit” dhe Praktikat e institucioneve të tjera, sistemet e të cilave administrohen nga AKSHI.

Udhëzimi nr.1159, datë 17.03.2014 “Për hartimin e marrëveshjes së nivelit të shërbimit”, Pika 1, ku parashikon: “Çdo institucion, i cili ka ose do të zhvillojë një sistem në fushën e teknologjisë së informacionit dhe komunikimit (TIK), që ofron shërbime për qytetarët, biznesin dhe për ndërveprim e shkëmbim informacioni për administratën publike nëpërmjet sistemeve elektronike, duhet të parashikojë dhe të hartojë marrëveshje të nivelit të shërbimit (MNSH).

VKM nr. 710, datë 21.08.2013 “Për krijimin dhe funksionimin e sistemeve të ruajtjes së informacionit, vazhdueshmërisë së punës dhe marrëveshjeve të nivelit të shërbimit” i ndryshuar, pika 2 dhe 2a.

**Ndikimi/efekti:** Mungesa e një marrëveshjeje ndërmjet institucioneve AKSHI-IQ dhe AKSHI AKU, përbën risk për mbarëvajtjen, monitorimin dhe dokumentimin e shërbimeve TIK, përkatësisht në IQ dhe AKU.

**Shkaku:** Të drejtat dhe detyrimet e ndërsjellta midis AKU dhe AKSHI-t nuk janë të rregulluara dhe përcaktuara me një marrëveshje të nënshkruar nga palët, sipas VKM nr.673, datë 22.11.2017 “Për riorganizimin e agjencisë kombëtare të shoqërisë së informacionit”.

**Rëndësia:** E lartë

**Rekomandimi:** AKSHI dhe AKU, të marrin masat e nevojshme për hartimin dhe miratimin e marrëveshjes dypalëshe me qëllim përcaktimin e të drejtave dhe detyrimeve për shërbimet TIK që ofron AKSHI ku të përcaktohet qartë se cilat janë shërbimet, ofrimi si dhe zbatimi i tyre.

**Rekomandimi:** AKSHI dhe IQ, të marrin masat e nevojshme për hartimin dhe miratimin marrëveshjes dypalëshe me qëllim përcaktimin e të drejtave dhe detyrimeve për shërbimet TIK që ofron AKSHI ku të përcaktohet qartë se cilat janë shërbimet, ofrimi si dhe zbatimi i tyre.

**4. Titulli i gjetjes:** Raportet e mirëmbajtjes për portalin e-inspektimi.

**Situata:** IQ nuk disponon raporte periodike të mirëmbajtjes së sistemit e-inspektimi edhe pse është administrator i portalit E-inspektimi sipas përcaktimeve të VKM nr. 696, datë 16.08.2013 “Për Përcaktimin e Procedurave të Ushtrimit të Kompetencave të Inspektoratit Qendror dhe të Rregullave për Përmbajtjen dhe Administrimin e Portalit Unik e-Inspektimi”.

**Kriteri:** Në kundërshtim me Udhëzimin nr.30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, kapitulli II, pika 23/f dhe 23/g.

VKM nr. 696, datë 16.08.2013 “Për Përcaktimin e Procedurave të Ushtrimit të Kompetencave të Inspektoratit Qendror dhe të Rregullave për Përmbajtjen dhe Administrimin e Portalit Unik “e-Inspektimi””.

**Ndikimi/Efekti:** Mangësi në dokumentacion në dosjet përkatëse për raportet e monitorimit të portalit e-inspektimi, kjo ndikon në mbikëqyrjen dhe performancën e punës së IQ lidhur me portalin

**Shkaku:** Neglizhencë e AKSHI-t dhe IQ për zbatimin e kërkesave ligjore që raportet e mirëmbajtjes së portalit e-inspektimi të jenë pjesë e dokumentacionit.

**Rëndësia:** E mesme

**Rekomandimi:** AKSHI si ndjekës i kontratës së mirëmbajtjes për sistemin e-inspektimi të marrë masat për vënien në dijeni të institucionit përfitues të shërbimeve të mirëmbajtjes që në këtë rast është IQ me qëllim informimin e institucionit mbi problematikat e raportuara nga IQ.

*Për sa është trajtuar në këtë pjesë të Raportit Përfundimtar të Auditimit, nga subjektet e audituara nuk janë paraqitur observacione mbi Projekt raportin e Auditimit.*

### **2.3 Auditimi i sigurisë së informacionit.**

Në zbatim të pikës 3“Siguria e Informacionit” të programit të auditimit nr. 978/1, datë 22.10.2021 u shqyrtua dokumentacioni si mëposhtë:

- Aktet ligjore/nënligjore/rregullative mbi sigurinë;
- Risqet e identifikuar, monitoruara, adresuara;
- Procedura/politika që lidhen me sigurinë e informacionit në TI;
- Politikat e vazhdimësisë së shërbimit;
- Listën e përdoruesve të sistemit;
- Të dhënat e publikuara në faqen web <https://aku.gov.al/> ;
- Intervista në ndjekjen dhe realizimin e proceseve të punës, etj.

Sistemet e informacionit janë bashkime komplekse të teknologjisë, proceseve dhe njerëzve që funksionojnë së bashku për të rregulluar procesimin, ruajtjen dhe transferimin e informacionit për të mbështetur misionin dhe funksionet e institucionit. Si rrjedhojë, çdo institucion e ka si detyrim ndërtimin e programit të sigurisë së informacionit.

Objektivi i një programi të sigurisë së sistemit të informacionit është të mbrojë informacionin e institucionit duke reduktuar riskun e humbjes së konfidencialitetit, integritetit dhe gatishmërisë së atij informacioni. Nëse institucioni nuk ka një garanci të sigurisë së informacionit, atëherë do të ndeshet me risqet dhe kërcënimet e mundshme ndaj operacioneve të organizatës, me arritjen e objektivave të përgjithshëm dhe me ndikimin në besueshmërinë ndaj institucionit.

AKU e ushtron aktivitetin e saj bazuar në ligjin nr. 9863, datë 28.01.2008 “Për Ushqimin”, i ndryshuar. Është institucioni përgjegjës për mbikëqyrjen e sigurisë ushqimore në Shqipëri i domosdoshëm për të përmbushur kërkesat ligjore, ekonomike dhe sociale. Autoriteti Kombëtar i Ushqimit është autoriteti kompetent me funksione inspektuese për menaxhimin në nivel kombëtar të fushës së sigurisë dhe mbrojtjes së konsumatorit, mbrojtjes së bimëve dhe shëndetit të kafshëve.

Veprimtaria inspektuese e AKU si dhe mbikëqyrja e kësaj veprimtarie, kryhet online, nëpërmjet sistemit elektronik “e-Inspektimi”. “e-Inspektimi” është Portali unik i inspektimit, që shërben për programimin dhe bashkërendimin e inspektimeve, për kryerjen e veprimtarisë së inspektimeve online, mbikëqyrjen e veprimtarisë inspektuese, shkëmbimin e të dhënave ndërmjet Inspektorateve Shtetërore / Vendore / Trupat e tjera inspektuese, sistemeve të tjera të digjitalizuara të administratës shtetërore.

#### **a. Identifikimi dhe adresimi i risqeve në TIK**

Monitorimi dhe kontrolli i riskut është procesi i identifikimit, analizimit dhe planifikimit për zbulimin e rreziqeve të reja të identifikuar, monitorimit të rreziqeve të identifikuar më parë dhe vlerësimit të atyre ekzistuese për të verifikuar strategjitë e reagimit ndaj rreziqeve të planifikuara për efektivitetin e tyre.

- Autoriteti Kombëtar i Ushqimit nuk disponon regjistër risku lidhur me teknologjinë e informacionit. Në asnjë formë nuk u konstatua të jenë dokumentuar rreziqe të identifikuar, analizuara dhe vlerësuara në periudhën objekt auditimi, lidhur me sigurinë dhe kërcënimet e jashtme ndaj institucionit, aseteve dhe personelit të tij.

- Inspektorati Qendror ka hartuar identifikimin e riskut për vitin 2020-2021 i cili përfshin të gjithë inspektoratet shtetërore që kanë në përdorim sistemin e e-Inspektimit dhe jo specifikisht për AKU. Identifikimi i riskut i hartuar nga IQ nuk është hartuar sipas ligjit përkatës si dhe udhëzimeve të përcaktuara nga Ministri i Financave. Ky risk identifikohet nga: 1. Informacioni bazë i riskut, 2. Informacioni i vlerësimit të riskut si dhe 3. Masat parandaluese.

Gjithashtu, risku në lidhje me teknologjinë e informacionit nuk është identifikuar plotësisht por është përmbledhur duke mos bërë një identifikim të detajuar në këtë dokument, nuk janë identifikuar problemet përkatëse dhe masat parandaluese por përcaktohet se TI, duhet të parashikojë risqet që lidhen me teknologjinë e informacionit, që në fakt duhet të jenë të parashikuara në këtë vlerësim risku.

*Kjo në kundërshtim me nenin 11, pika 2: “Identifikimin dhe krijimin e regjistrit të riskut, vlerësimin, kontrollin e risqeve që vënë në rrezik arritjen e objektivave dhe realizimin me sukses të veprimtarive të strukturave që ata drejtojnë.”, 12 pika 3/d: “Identifikimin dhe krijimin e regjistrit të riskut, vlerësimin, kontrollin e risqeve që vënë në rrezik arritjen e objektivave dhe realizimin me sukses të veprimtarive të strukturave që ata drejtojnë” si dhe nenin 21 të ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010, “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, i ndryshuar me ligjin nr. 110/2015, datë 23.10.2015. Udhëzimin nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, i ndryshuar, udhëzimi nr. 21, datë 25.10.2016 “Për nëpunësit zbatues të të gjitha niveleve”, Udhëzimi i Ministrisë të Financave nr. 16, datë 20.07.2016 “Për përgjegjësitë dhe detyrat e koordinatorit të menaxhimit financiar dhe kontrollit dhe koordinatorit të riskut në njësitë publike.*

### **Politikat e sigurisë**

Politikat e sigurisë së organizatës janë rregulla, praktika që rregullojnë sesi një institucion menaxhon, mbron dhe shpërndan burimet për të arritur objektivat specifike të sigurisë. Këto rregulla dhe praktika duhet të identifikojnë kriteret për autoritetin përkatës.

Disa nga elementët në Sigurinë e TI janë:

- Përkufizim i sigurisë së informacionit - objektivat dhe qëllimi;
- Parimet, standardet dhe kërkesat e detajuara të përputhshmërisë;
- Përkufizim të përgjegjësive të përgjithshme dhe specifike për të gjitha aspektet e sigurisë së informacionit;
- Përdorimi i aseteve të teknologjisë së informacionit;
- Procedurat e backup-it;
- Elemente të trajnimit dhe të edukimit mbi sigurinë;
- Procesi për raportimin e incidenteve të dyshimta të sigurisë;
- Planet e vazhdueshmërisë së institucionit;
- Metodatat e komunikimit me stafin mbi politikat dhe procedurat e përshtatura për sigurinë e SI.

Nga auditimi u konstatua se, nuk disponohen politika të sigurisë së teknologjisë së informacionit, duke mos bërë të mundur identifikimin e elementëve përkatës që duhet të përmbajnë politikat e sigurisë.

Nuk disponohen plane dhe procedura për back-up të të dhënave që ky institucion disponon, nuk ka të dokumentuar politika apo një plan masash për identifikimin, trajtimin e gabimeve që mund të ndodhin në infrastrukturën TI, mungojnë raporte të menaxhimit të incidenteve. Gjithashtu, nuk disponon plane për vazhdimësinë e informacionit. Kjo në kundërshtim me

VKM Nr. 710, datë 21.08.2013 “Për Krijimin dhe Funkcionimin e Sistemeve të Ruajtjes së Informacionit, Vazhdueshmërisë së Punës dhe Marrëveshjeve të Nivelit të Shërbimit”, i ndryshuar.

#### **b. Siguria e të dhënave dhe përdoruesit e sistemit**

Përdoruesit e autorizuar që kanë të drejtë akses në sistemin e-Inspektimi janë të përcaktuar në rregulloren e miratuar me Urdhër nr. 432, datë 28.09.2016 “Për përcaktimin e procedurave dhe mënyrave, për përdorimin e portalit unik të inspektimit, “e-Inspektimi””. Në këtë rregullore detyrat nuk janë specifike dhe jo plotësisht të qarta pasi në disa nene shprehet detyra për hedhjen dhe mirëmbajtjen e përdoruesve në sisteme e cila u është caktuar personave përgjegjës të ndryshëm, renditur si më poshtë:

*Neni 9, pika 2/a)* ku citohet se “Të dhënat individuale sipas përdoruesve të autorizuar që kanë të drejtë akses në portal që janë të specifikuar edhe në Kreun XII, të VKM Nr. 696, datë 16.08.2013, “Për përcaktimin e procedurave të ushtrimit të kompetencave të Inspektoratit Qendror dhe të rregullave për përmbajtjen dhe administrimin e portalit unik “e-Inspektimi”, i dërgohen AKSHI (Agjencisë Kombëtare të Shoqërisë së Informacionit) dhe për dijëni Inspektoratit Qendror për hapje llogarie në direktorinë aktive (AD) të serverit ku është hostuar aplikimi i “e-Inspektimi””;

*Neni 9, pika 2/b)* ku citohet se “Administratorët e sistemit, hedhin të dhënat e përdoruesve sipas roleve në portalin “e-Inspektimi””;

*Neni 10 pika 2* ku citohet se “Log-imi në portal, sigurohet nëpërmjet emrit të përdoruesit dhe fjalëkalimit në përputhje me kredencialet personale të secilit përdorues, pas trajnimit nga Inspektorati Qendror dhe hapjes së llogarisë së tij nga AKSHI”;

*Neni 10 pika 6* ku citohet se “Heqjen e të drejtave të aksesit në Portal për përdoruesit e autorizuar, të cilët lirohen nga detyra, e ka Inspektorati Qendror, pas njoftimit me shkrim të bërë nga Kryeinspektori i Inspektoratit Shtetëror, ose eprori i drejtpërdrejtë i këtij përdoruesi të sistemit, brenda 2 (dy) ditëve punë pas largimit të tij nga detyra”;

*Neni 11, Pika 5/b)* ku citohet se “Administratori i Inspektoratit Qendror krijon dhe mirëmban të dhënat e përdoruesve në Active Directory për aksesin në portal”.

*Neni 11, Pika 9* ku citohet se “Administratori i Inspektoratit Shtetëror administron dhe mirëmban të dhënat e Portalit të Inspektoratit Shtetëror / Vendor / Trupës inspektuese përkatëse”;

*Neni 11, Pika 12/a dhe 12/c* ku citohet se “Burimet Njerëzore i Inspektoratit Shtetëror Hedh dhe administron të dhënat e inspektorëve të inspektoratit përkatës” dhe “Përditëson emërimin dhe largimin nga detyra për inspektorët shtetërorë”;

Procedura që ndiqet në AKU, për hapjen dhe mbylljen e përdoruesve është si në vijim: për çdo person të emëruar drejtorinë Rajonale nga sektori i Burimeve Njerëzore të AKU dërgohet urdhër emërimi, largimi apo ndryshim pozicioni të punonjësit në Sektorin e Financës dhe Shërbimeve të Brendshme të DRAKU përkatës. Këta të fundit koordinohen me TIK në AKU e cila, njofton me email IQ dhe AKSHI-n për hapjen dhe mbylljen e përdoruesve. Ndërsa për punonjësit e drejtorisë së përgjithshme vetë BNJ dërgojnë email pranë TIK në AKU.

Nga auditimi u konstatua se, në AKU ka pasur raste në të cilat nuk kanë mbetur gjurmët e lëna për dërgimin e kërkesës me email për hapje, mbyllje apo ndryshim pozicioni për përdoruesit nga ana e Sektorit të Shërbimeve Mbështetëse në DRAKU apo edhe në Drejtorinë e Përgjithshme të AKU. Kjo pasi janë larguar punonjësit të cilët kanë bërë komunikimet me email dhe nuk ka dokumente të shkruara apo një dokument elektronik për menaxhimin e punonjësve që janë punësuar apo janë larguar.

Me anë të shkresës Nr. 1197 Prot., datë 05.03.2020, “Në lidhje me përmirësimin e përdorimit të sistemit E-inspektimi” nga Autoriteti Kombëtar i Ushqimit është dërguar tek Inspektorati Qendror ku ndër të tjera kërkohet: *“Aksesimi i sistemit nga një numër i kufizuar punonjësish në Drejtorinë e Përgjithshme me qëllim marrjen e të dhënave të cilat do të shërbejnë jo vetëm si statistika për hartimin e politikave të brendshme të AKU por ç’është më e rëndësishme këto të dhëna do të shërbejnë për analizimin dhe vlerësimin e riskut për OBU apo produkte të veçanta”*.

Nga auditimi u konstatua se, nuk kanë akses në sistemin “e-inspektimi” burimet njerëzore, arkiv protokollit e cila ka për detyrë hedhjen dhe përcaktimin në portal të dokumenteve të protokolluara për çështjet e inspektimit, përgjegjësit e sektorëve të rëndësive të veçanta të cilët merren me menaxhimin e vlerësimit të riskut të Inspektorateve Shtetërore etj.

Nga auditimi mbi përdoruesit u konstatua se, nuk disponohet një politikë apo rregullore e dokumentuar dhe miratuar për administrimin/menaxhimin e tyre, në të cilën të jenë të përcaktuara procedurat që do të ndiqen për krijimin, fshirjen, ndryshimin e roleve dhe të të drejtave, ndryshimin e fjalëkalimeve etj.

Sipas Urdhrit nr. 432, datë 28.09.2016 *“Për përcaktimin e procedurave dhe mënyrave, për përdorimin e portalit unik të inspektimit, “e-Inspektimi”, Neni 8 pika vii., një nga Funksonet e Portalit “e-Inspektimi” është edhe “Mbajtja e Regjistrit Kombëtar të Inspektorëve”*.

Të dhënat e inspektorëve në sistem sipas fushave përbërëse janë: Emri, Mbiemri, Datëlindja, Adresa NID, Gjuhë të huaja, Testime, Është aktiv, I vlefshëm deri më, Photo, AD user, Fusha e inspektimit, Inspectorate ID, ADMetodolog, FullName, Roli, ADGroupInsp, IsTest.

Nga auditimi u konstatua se, për monitorimin e përdoruesve nëpërmjet sistemit nuk ka raporte, portali nuk të ofron mundësin e gjenerimit të të dhënave. Nuk është e mundur të gjenerohet raport për të gjithë të dhënat e përdoruesve ose të të japë mundësinë e zgjedhjes së të dhënave të kombinuara mbi përdoruesit. Mënyra e vetme është kërkimi dhe gjenerimi për informacione specifike duke kërkuar për çdo përdorues.

Gjithashtu, nga auditimi i këtyre fushave në sistem dhe verifikimi i tyre me disa prej të dhënave të gjeneruara nga sistemi u konstatua se:

- Datëlindja, është e njëjtë për të gjithë 1/1/1970;
- Adresa NID, është e pasaktë dhe e njëjta ID për të gjithë përdoruesit 1234567890;
- Gjuhë e huaj, është fushë boshe;
- I vlefshëm deri më datë 12/31/2999;
- Rajoni, jo në çdo përdorues është plotësuar;
- “Modified”, në disa përdorues nuk del edhe viti se kur është bërë modifikimi i fundit por vetëm data dhe muaji.

Ndërkohë nga sistemi është verifikuar se përdoruesit me këto të dhëna nuk janë test.

Të dhënat e përdoruesve që ju vendosën në dispozicion grupit të auditimit të gjeneruara nga sistemi janë:

FullName - në të cilin shënohet emri dhe mbiemri i përdoruesit;

Inspector\_x0020\_Since - në të cilin shënohet data që ka filluar punën si inspektor për herën e parë përdoruesi përkatës;

Is\_x0020\_Active – tregon nëse përdoruesi është aktiv me vlerë 1 ose inaktiv nëse është me vlerë 0;

UserName – emir i përdoruesit me të cilin do të aksesohet në sistem;

Modified – data e fundit e modifikimit kur është 0 Inactiv nënkupton largimin e punonjësit;

Created – data e krijuar në sistem;

Inspectorate name – emri i inspektoratit përkatës ku inspektori është i punësuar;

Roli – Roli i secilit përdoruesi në sistem.

*Nga auditimi mbi përdoruesit e sistemit e-Inspektimi u konstatua se:*

- Datë të mirëfilltë largimi të punonjësit nuk ka në sistem, si e tillë merret i mirëqenë modifikimi i fundit kur është bërë inactive;
  - Për përdoruesit që janë fshirë nuk ka asnjë lloj informacioni;
  - Të dhënat e NID nuk gjenerohen nga sistemi;
  - Mbajnë statusin “aktiv” përdorues të cilët nuk kanë asnjë marrëdhënie aktive me AKU. Rastet e konstatuara janë inspektorë të cilët janë larguar për arsye të ndryshme si: mbushja e moshës për pension pleqërie, dorëheqja si dhe përdorues të tjerë që rezultojnë aktive në sistem;
  - Rezulton më shumë se një përdorues për të njëjtin person;
  - Në disa raste ka mospërputhje të pozicionit të punës dhe rolit të tij në sistem, p.sh.; punonjësi emëruar në pozicionin e Specialistit në Sektorin e Financës dhe Shërbimeve të Brendshme ka akses në sistem dhe roli që ky specialist ka në sistem është si Kryeinspektor Rajonal;
  - Një përdorues është me emrin “Ligjor AKU” në DRAKU Tiranë me rol në sistem “Ligjor Inspektorati” dhe Inspektor AKU si përdorues aktiv në sistem me kredenciale të përgjithshme të cilët nuk janë përcaktuar se nga cili punonjës posedohen dhe përdoren;
  - Nga njoftimi i fillimit të punës në hapjen apo mbylljen e user-it ka një afat më të gjatë në hapjen e tij në kundërshtim me VKM nr. 696, datë 16.08.2013 “Për Përcaktimin e Procedurave të Ushtrimit të Kompetencave të Inspektoratit Qendror dhe të Rregullave për Përmbajtjen dhe Administrimin e Portalit Unik “e-Inspektimi”” Kreu V pika 3 dhe 4 përkatësisht: “3. Inspektoratet shtetërore njoftojnë Inspektoratin Qendror për çdo emërim në detyrë të inspektorëve në provë jo më vonë se 2 (dy) ditë pune nga emërimi i tyre. 4. Inspektoratet njoftojnë Inspektoratin Qendror për çdo lirim nga detyra të inspektorëve shtetërorë jo më vonë se 2 (dy) ditë pune nga lirimi i tyre, të shoqëruar me një relacion shpjegues me motivacionin e lirim të tyre nga detyra”.
- Nga auditimi u konstatua se, në disa raste të përzgjedhur rastësisht dhe verifikimi i tyre ka rezultuar se nga këto shembuj ka afate gati dhe për një periudhë 1 vit nga largimi i punonjësit deri në mbylljen e aksesit për të, apo edhe afati i gjatë nga momenti që është punësuar deri në hapjen e një përdoruesi në sistem;
- Ka user-a të cilët janë hapur përpara se të hynte AKU në sistemin e e-Inspektimit si p.sh., user-a të cilët janë krijuar në sistem në vitin 2015, 2016 dhe 2017 ndërkohë AKU është futur në sistem në vitin 2018, gjithashtu përdoruesit si inspektorë pavarësisht se është e punësuar në PIK të cilët nuk kanë ende akses në sistem.

### **Ambienti fizik i dhomave të serverëve**

Dhoma e serverëve është vendi fizik ku ruhen dhe qëndrojnë kryesisht serverët dhe pajisje të tjera ndihmëse që nevojiten për shërbimet e komunikimit, sinjalizimit dhe pajisje të tjera elektronike. Dhoma e serverëve është pika me sensibël për të dhënat që mbahen në AKU për efekt raportimi apo dhe të proceseve të punës që zhvillojnë në AKU pavarësisht me sistem apo pa sistem.

Referuar VKM-së nr. 673, datë 22.11.2017 “Për riorganizimin e Agjencisë Kombëtare të Shoqërisë së Informacionit” dhe Rregullores për ndërtimin e dhomës së serverëve (versioni 1.0, datë 02.12.2008) miratuar nga AKSHI, parashtrihen standardet e TIK për administratën publike.

Nga verifikimi i dhomës së server-it në AKU, u konstatua se, ambientet fizike nuk janë në përputhje me standardet e përcaktuara në Rregulloren për ndërtimin e dhomës së server-it (Versioni 1.0, datë 02.12.2008) miratuar nga AKSHI (Agjencia Kombëtare e Shoqërisë së Informacionit), përkatësisht:

Ruajtja e pajisjeve fizike, kontrolli i aksesit fizikë mbi pajisjet, kontrolli mbi personat që kanë akses fizik:

- Pajisjet elektronike si serverat dhe pajisjet e rrjetit janë të ruajtura në këto hapësira, ku kanë akses specialistet e TI, nuk ka pajisje të sigurisë fizike të aksesit dhe sistem të kufizimit të personave të paautorizuar;
- Aksesit në ambientin e dhomës së server-it nuk është i kontrolluar me teknologji të tilla si: skanime, lexues karte, etj.;
- Instalimi elektrik i dhomave të serverëve nuk është veçmas instalimit të përgjithshëm;
- Mungon sistemi i alarmit. Duhet të ketë të tillë në mënyrë që të sinjalizojnë problemet me rrymën elektrike, me ambientin fizik, sensor për rrjedhjen e ujit, sensor për parandalimin e dëmtimeve fizike të strukturës së dhomës

**Figura 1:** Pamjet e mëposhtme tregojnë gjendjen e dhomës së serverave dhe aseteve të ndodhura në të (Paraqiten server, switch, UPS etj.).



*Burimi: AKU*

Energjia është një tjetër faktorë që duhet testuar vazhdimisht për sigurinë e burimeve dhe sistemeve të TI. Furnizuesit rezervë të energjisë ose të pa ndërprerë mund të mbështesin pajisjet në një ndërprerje të shkurtër të energjisë ose të ofrojnë kohën për të ruajtur të dhënat dhe të kryejnë procedurat e mbylljes.


Drejtoria e Përgjithshme e AKU operon në një godinë ku infrastruktura e të cilës është jo e përshtatshme në funksion të mbarëvajtjes normale të punës me pajisjet kompjuterike. Një problem i konstatuar nga grupi i auditimit dhe gjatë fazës në terren është shkëputja e shpeshtë e energjisë elektrike duke bërë të pamundur vazhdimësinë e punës në institucion, nga komunikimet e zhvilluara me institucionin ky problem është prezent pothuajse gjithmonë në institucion.

Konstatohet se në AKU nëse do të ketë shkëputje për një kohë të gjatë atëherë situata nuk mund të menaxhohet më duke mos bërë të mundur vazhdimësinë e punës, monitorimin, komunikimin dhe vlerësimin e riskut të inspektimeve të zhvilluara. Disa kompjuter janë të pajisur me UPS të cilët në raste të tilla mbajnë jo më shumë se 5-10 minuta, ndërsa të tjerë bëjnë fikje të menjëhershme.

Në kushtet e mungesës së energjisë elektrike për një kohë më të gjatë se mbajtja e baterisë në gjendje pune të dhomës së serverëve, AKU duhet të marrë masat për krijimin e kushteve për mos ndërprerje të procesit të punës dhe humbje të kontrollit të situatës edhe në dhomën e serverave. Shkëputja shumë e shpeshtë e energjisë elektrike rrezikon të gjitha pajisjet

teknologjike në AKU. Jo të gjithë kompjuterët kanë UPS dhe bëjë fikje të menjëhershme të pajisjeve. Gjithashtu, rrezikojnë të digjen apo të kenë probleme teknike të gjitha pajisjet e tjera.

Në figurën më poshtë është vendosur një screen shot, marrë si rezultat i testimit të Webpage nga ku aksesohet sistemi i e-Inspektimit:



*Burimi: grupi i auditimit*

Nga auditimi dhe mbikëqyrja e faqes Web për akses në portal u konstatua se, nuk përdoret një lidhje e sigurt (connection security) HTTP (Transfer Hyper Text Protocol) dhe HTTPS (Transfer Hyper Text Protocol Secure) (Not Secure Status), që do të thotë se serveri i faqes së internetit nuk përdor një certifikatë sigurie për të vërtetuar identitetin e internetit në shfletues. Mungesa e kësaj certifikate mbart riskun e cenimit të privatësisë, ndryshimit të informacionit dhe shkëmbimit të tij që merret ose jepet përmes këtij portali.

**5. Titulli i Gjetjes:** AKU dhe IQ nuk kanë identifikuar risqet mbi teknologjinë e informacionit.

**Situata:** Nga auditimi u konstatua se, Autoriteti Kombëtar i Ushqimit si dhe Inspektorati Qendror nuk disponojnë regjistrë risku me elemente të teknologjisë së informacionit. Për periudhën objekt auditimi, nuk rezulton të jenë identifikuar, dokumentuar, analizuar dhe vlerësuar risqe lidhur me teknologjinë e informacionit që disponojnë institucionet.

**Situata:** Inspektorati Qendror ka hartuar identifikimin e risqeve për vitin 2020-2021 i cili përfshin të gjithë inspektoratet shtetërore që kanë në përdorim sistemin e e-Inspektimit dhe jo specifikisht për AKU. Identifikimi i riskut i IQ-së nuk është hartuar sipas Ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010, “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, i ndryshuar.

**Kriteri:** Ligji nr.10296, datë 08.07.2010, “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, i ndryshuar. Udhëzimin nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, i ndryshuar.

**Ndikimi/Efekti:** Mungesa e një regjistri risku ka ndikim negativ në arritjen e objektivave.

**Shkaku:** Nuk janë marrë masat për hartimin e regjistrit të riskut mbi Teknologjinë e Informacionit.

**Rëndësia:** E Lartë

**Rekomandimi:** AKU dhe IQ të marrin masa për hartimin e regjistrit të riskut për teknologjinë e informacionit në institucionet respektive, ku të jenë evidentuar ngjarje të mundshme të cilat mund të kenë efekt negativ në mbarëvajtjen e punës institucionale, me qëllim krijimin e një plani pune në rastet e shfaqjes së problematikave të ndryshme në fushën e teknologjisë së informacionit. Risqet e identifikuara që lidhen me funksionalitetin e sistemit “e-inspektimi” t’i adresohen IQ dhe AKSHI-t si administrator të këtij sistemi.

*Agjencia Kombëtare e Shoqërisë së Informacionit, ka paraqitur observacion me shkresën nr.7255/3, datë 25.02.2022 protokolluar në KLSH me nr. 978/9 datë 01.03.2022, ku citohet:*

**Pretendimi:** Objeksione në lidhje me rekomandimin nr.6 në këtë raport: AKSHI në funksion të përmbushjes së detyrave funksionale të institucionit ka hartuar regjistrit e riskut për sigurinë e informacionit

**Qëndrimi i grupit të auditimit:**

Sqarojmë se konstatimi dhe rekomandimi ynë është riformuluar për arsye se Risqet në TIK cdo institucion duhet t'i identifikojë vetë, ndërsa duhet të adresojë ato risqe të cilat nuk ndiqen teknikisht nga vetë institucioni por i adresohen AKSHI-t apo IQ-s.

*Për këtë arsye ky observacion juaj mund të konsiderohet pjesërisht i marrë në konsideratë sepse ju do të mbani risqe të adresuara nga institucioni të cilat vetë institucioni i identifikon por nuk ka njohuri teknike t'i ndjekë në zbatim. Ndryshimet pasqyrohen në këtë raport auditimi.*

**6. Titulli i Gjetjes:** Mungesa e planeve dhe procedurave për sigurinë e informacionit dhe vazhdimësinë e ofrimit të shërbimit.

**Situata:** Nga auditimi u konstatua se:

- IQ nuk ka hartuar dhe miratuar politika, procedura apo akte rregullative që garantojnë sigurinë e informacionit, procedura për back-up të të dhënave të sistemit e-inspektimi ku bën pjesë dhe AKU, rregullore për trajtimin e gabimeve që mund të ndodhin në infrastrukturën TIK, menaxhimin e incidenteve, vazhdimësinë e ofrimit të shërbimit të inspektimit online në rast ndërprerje.

- IQ nuk disponon rregullore për administrimin e përdoruesve të sistemit, ku të jenë përcaktuar hapat që do të ndiqen për krijimin, fshirjen, ndryshimin e roleve, të drejtave, fjalëkalimeve si dhe raportimin e tyre.

**Kriteri:** VKM Nr. 710, datë 21.08.2013 “Për Krijimin dhe Funksonimin e Sistemeve të Ruajtjes së Informacionit, Vazhdueshmërisë së Punës dhe Marrëveshjeve të Nivelit të Shërbimit”.

**Ndikimi/Efekt:** Risk në ruajtjen e të dhënave të inspektimit me të cilat AKU planifikon dhe vepron në aktivitetin e saj.

**Shkaku:** -.

**Rëndësia:** E Lartë

**Rekomandimi:** IQ të marrë masat e nevojshme për hartimin dhe vënien në dispozicion të procedurave apo akteve rregullative për administrimin e përdoruesve si dhe informimin e tyre për elementët e sigurisë së informacionit që ka miratuar institucioni që lidhen me inspektimet online, back-upin e të dhënave si dhe vazhdimësinë e ofrimit të shërbimit të inspektimit në rast ndërprerje.

IQ të adresojë tek AKSHI përgjegjësinë teknike për zbatimin në elementët e sigurisë së informacionit, back-upin e të dhënave si dhe vazhdimësinë e ofrimit të shërbimit të inspektimit në rast ndërprerje.

*Agjencia Kombëtare e Shoqërisë së Informacionit, ka paraqitur observacion me shkresën nr.7255/3, datë 25.02.2022 protokolluar në KLSH me nr. 978/9 datë 01.03.2022, ku citohet:*

**Pretendimi:** Objeksione në lidhje me rekomandimin nr.7 në këtë raport gjetja nr.6: Dispozitat e akteve të sipërcituara janë hartuar nga AKSHI dhe nëpërmjet tyre janë vënë në dispozicion të të gjitha institucioneve të administratës shtetërore politikë, procedurat apo aktet rregullative që garantojnë sigurinë e informacionit, back-up të të dhënave, vazhdimësinë e ofrimit të shërbimeve.

**Qëndrimi i grupit të auditimit:**

Sqarojmë se observacioni juaj merret në konsideratë pjesërisht pasi tek ju adresohen hapat teknik që institucioni jo vetëm e ka të pamundur t'i zgjidh, por janë identifikuar si shërbime në VKM nr. 673, datë 22.11.2017 “Për riorganizimin e Agjencisë Kombëtare të Shoqërisë së Informacionit”, i ndryshuar.

*Për këtë arsye ky observacion pranohet pjesërisht dhe ndryshimet pasqyrohen në këtë raport auditimi.*

**7. Titulli i Gjetjes:** Parregullsi në të dhënat e përdoruesve të AKU në sistemin e-inspektimi.

**Situata:** Nga auditimi mbi të dhënat e inspektorëve dhe verifikimi i tyre nga sistemi u konstatua se:

- Datëlindja, është e njëjtë për të gjithë 1/1/1970;
- Adresa NID, është e pasaktë dhe e njëjta ID për të gjithë user-at 1234567890;
- Gjuhë e huaj, është fushë boshe;
- I vlefshëm deri më, vendosur data 12/31/2999;
- Rajoni, jo në çdo user është plotësuar;
- Modified, në disa user-a nuk del edhe viti se kur është bërë modifikimi i fundit por vetëm data dhe muaji.

**Situata:** - Datë të mirëfilltë largimi të punonjësit nuk ka në sistem, si e tillë merret i mirëqenë modifikimi i fundit kur është bërë inactive;

- Nuk ka asnjë lloj informacioni për përdoruesit e fshirë;
- Mbjajnë statusin “aktiv” përdorues të cilët nuk kanë asnjë marrëdhënie aktive me AKU. Rastet e konstatuara janë inspektorë të cilët janë larguar për arsye të ndryshme si: mbushja e moshës për pension pleqërie, dorëheqja si dhe përdorues të tjerë;
- Ka raste kur i njwjt i punonjws ka mw shumw se një përdorues;
- Në disa raste ka mospërputhje të pozicionit të punës dhe rolit të tij në sistem, p.sh.; punonjësi emëruar në pozicionin e Specialistit në Sektorin e Financës dhe Shërbimeve të Brendshme ka akses në sistem dhe roli që ky specialist ka në sistem është si Kryeinspektor Rajonal;
- Një përdorues është me emrin “Ligjor AKU” në DRAKU Tiranë me rol në sistem “Ligjor Inspektorati” dhe Inspektor AKU si përdorues aktiv në sistem me kredenciale të përgjithshme të cilët nuk janë përcaktuar se nga cili punonjës posedohen dhe përdoren;
- Nga njoftimi i fillimit të punës në hapjen apo mbylljen e user-it ka një afat më të gjatë në hapjen e tij në kundërshtim me VKM nr. 696, datë 16.08.2013 “Për Përcaktimin e Procedurave të Ushtrimit të Kompetencave të Inspektoratit Qendror dhe të Rregullave për Përmbajtjen dhe Administrimin e Portalit Unik “e-Inspektimi””.

Nga auditimi u konstatua se, në disa raste të përzgjedhur rastësisht dhe verifikimi i tyre ka rezultuar se nga këto shembuj ka afate gati dhe për një periudhë 1 vit nga largimi i punonjësit deri në mbylljen e aksesit për të, apo edhe afati i gjatë nga momenti që është punësuar deri në hapjen e një përdoruesi në sistem;

- Ka user-a të cilët janë hapur përpara se të hynte AKU në sistemin e e-Inspektimit si p.sh., user-a të cilët janë krijuar në sistem në vitin 2015, 2016 dhe 2017 ndërkohë AKU është futur në sistem në vitin 2018, gjithashtu përdoruesit si inspektorë pavarësisht se është e punësuar në PIK të cilët nuk kanë ende akses në sistem.

**Kriteri:** VKM nr. 696, datë 16.08.2013 “Për Përcaktimin e Procedurave të Ushtrimit të Kompetencave të Inspektoratit Qendror dhe të Rregullave për Përmbajtjen dhe Administrimin e Portalit Unik “e-Inspektimi””. Urdhër nr. 432, datë 28.09.2016 “Për përcaktimin e procedurave dhe mënyrave, për përdorimin e portalit unik të inspektimit, “e-Inspektimi””.

**Ndikimi/Efekti:** Risk për komprometimin e të dhënave dhe humbjes së gjurmës audituese. Risk për kryerjen e veprimeve në sistem nga persona të paautorizuar.

**Shkaku:** Mos hartimi dhe miratimi i akteve rregullative.

**Rëndësia:** E Lartë

**Rekomandimi:** AKU dhe IQ si përgjegjës për të dhënat e sistemit e-inspektimi të verifikojnë dhe të sistemojnë të dhënat mbi përdoruesit. IQ të adresojë tek AKSHI si administrator i sistemit dhe ndjekës i kontratës së mirëmbajtjes, të gjitha rastet që do të konsiderohen si anomali të sistemit me qëllim saktësimin dhe plotësimin e tyre nga ofruesi i shërbimit.

*Agjencia Kombëtare e Shoqërisë së Informacionit, ka , ka paraqitur observacion me shkresën nr.7255/3, datë 25.02.2022 protokolluar në KLSH me nr. 978/9 datë 01.03.2022, ku citohet:*

**Pretendimi:** Objeksione në lidhje me rekomandimin nr. 8 në këtë raport: Ndërkohë në Kreun XII përcaktohen përdoruesit e autorizuar të portalit ku qartazi vihet re që nuk është AKSHI në listën e përcaktuar në pikën 1 të këtij kreu, fakt ky që provon edhe një herë që nuk është AKSHI institucioni përgjegjës për verifikimin, inspektimin, saktësimin apo plotësimin e të dhënave të e-inspektimit në kushtet ku këto të fundit administrohet nga IQ-ja.

**Qëndrimi i grupit të auditimit:**

Sqarojmë se konstatimi i problematikave qëndron ndërsa është pranuar observacioni pjesërisht për rekomandimin për faktin se AKSHI është administratori i sistemit dhe ndjekës i kontratës e nevojitet të ndjekë rastet që do të konsiderohen anomali të sistemit.

*Për këtë arsye ky observacion pranohet pjesërisht dhe ndryshimet pasqyrohen në në këtë raport auditimi.*

**8. Titulli i Gjetjes:** Ambientet e mbajtjes se serverëve të AKU nuk plotësojnë kushtet teknike të përcaktuara në Rregulloren e miratuar nga AKSHI “Për ndërtimin e dhomës së serverave” (versioni 1.0, datë 02.12.2008).

**Situata:** Nga verifikimi i dhomës së serverëve në AKU, u konstatua se ambientet fizike nuk janë në përputhje me standardet e përcaktuara në “Rregulloren për ndërtimin e dhomës së serverave” (Versioni 1.0, datë 02.12.2008) miratuar nga AKSHI (Agjencia Kombëtare e Shoqërisë së Informacionit).

Disa nga problematikat e konstatuara, janë të renditura si më poshtë:

- Aksesit në ambientin e dhomës së serverave nuk është i kontrolluar me teknologji të tilla si: skanime, lexues karte, etj.;
- Pajisjet elektronike si serverat dhe pajisjet e rrjetit janë të ruajtura në këto hapësira, ku kanë akses specialistët e TI, nuk ka pajisje të sigurisë fizike të aksesit dhe sistem të kufizimit të personave të paautorizuar;
- Aksesit në ambientin e dhomës së serverave nuk është i kontrolluar me teknologji të tilla si: skanime, lexues karte, etj.;
- Instalimi elektrik i dhomave të serverave nuk është veçmas instalimit të përgjithshëm;
- Mungon sistemi i alarmit. Duhet të ketë të tillë në mënyrë që të sinjalizojnë problemet me rrymën elektrike, me ambientin fizik, sensor për rrjedhjen e ujit, sensor për parandalimin e dëmtimeve fizike të strukturës së dhomës.

**Kriteri:** “Rregullore për ndërtimin e dhomës së serverave” (versioni 1.0, datë 02.12.2008) miratuar nga AKSHI

**Ndikimi/Efekti:** Risk për humbje ose dëmtim të pajisjeve kompjuterike, aksesit të paautorizuar, kopjimit ose shikimit të informacionit sensitiv.

**Shkaku:** Mos analizim nga ana e AKSHI-t të kësaj problematike e cila cenon të dhënat e përdoruesve në dokumente elektronik që rezultojnë jashtë sistemit të cilat tek AKU janë të sheshta për shkak se nuk janë një institucion i informatizuar në të gjitha hallkat e aktivitetit të tij.

**Rëndësia:** E Lartë

**Rekomandimi:** AKSHI si institucioni administruer për teknologjinë e informacionit në AKU të marrë masa për identifikimin e të dhënave që ruhen jashtë sistemit elektronik, por që janë të rëndësishme për punonjësit dhe vetë AKU-n, pasi lidhen drejtpërdrejtë me detyrat e tyre funksionale apo raportuese, në mënyrë që të gjejë zgjidhjen ekonomikisht më të favorshme në ruajtjen e tyre.

*Agjencia Kombëtare e Shoqërisë së Informacionit, ka , ka paraqitur observacion me shkresën nr.7255/3, datë 25.02.2022 protokolluar në KLSH me nr. 978/9 datë 01.03.2022, ku citohet:*

**Pretendimi:** Objeksione në lidhje me rekomandimin nr. 9 në këtë raport: Kërkesa për pëmirësimin e dhomës së serverave, duke qenë se konsiderohet investim, duhet të ishte

parashikuar nga institucioni përfitues, dhe të ishte parashikuar nga institucioni përfitues, dhe të ishte dërguar kërkesa për kryerjen e procedurës së prokurimit pranë AKSHI-t.

***Qëndrimi i grupit të auditimit:***

Sqarojmë se konstatimi dhe rekomandimi i grupit të auditimit do të qëndrojë për sa kohë në asnjë rast nuk është rekomanduar investimi në dhomën e serverave, por AKSHI nëpërmjet specialistëve të ngarkuar për shërbimet në AKU, si institucioni administrues për teknologjinë e informacionit në AKU duhet të marrë masa për identifikimin e të dhënave që ruhen jashtë sistemit elektronik, por që janë të rëndësishme për punonjësit dhe vetë AKU-n, pasi lidhen drejtpërdrejtë me detyrat e tyre funksionale apo raportuese, në mënyrë që të gjejë zgjidhjen ekonomike më të favorshme për ruajtjen e këtyre të dhënave.

*Për këtë arsye ky observacion mbetet i njëjtë në këtë raport auditimi.*

**9. Titulli i Gjetjes:** Mungesa e elementeve të sigurisë në faqen web.

**Situata:** Nga auditimi dhe mbikëqyrja e faqes Web të Inspektoratit Qendror, nëpërmjet së cilës aksesohet dhe portali “e-inspektimi” u konstatua se, nuk përdoret një lidhje e sigurt (connection security) HTTP (Hyper Text Transfer Protocol) dhe HTTPS (Hyper Text Transfer Protocol Secure) (Not Secure Status). Mungesa e kësaj certifikate mbart riskun e cenimit të privatësisë, ndryshimit të informacionit dhe shkëmbimit të tij përmes këtij portali.

**Kriteri:** Ligji nr. 2/2017 “Për sigurinë kibernetike”.

**Ndikimi/Efekti:** Humbja e privatësisë, ndryshimit të informacionit që merret ose jepet me anë të portalit.

**Shkaku:** Mungesa e certifikatës së sigurisë.

**Rëndësia:** E Mesme

**Rekomandimi:** Inspektorati Qendror në bashkëpunim me AKSHI-n të marrin masa për sigurimin e faqes web të IQ, nëpërmjet të cilit të gjithë inspektoratet aksesojnë sistemin elektronik të inspektimit “e-inspektimi”.

*Agjencia Kombëtare e Shoqërisë së Informacionit, ka , ka paraqitur observacion me shkresën nr.7255/3, datë 25.02.2022 protokolluar në KLSH me nr. 978/9 datë 01.03.2022, ku citohet:*

***Pretendimi:*** Objeksione në lidhje me rekomandimin nr. 10 në këtë raport: AKSHI nuk ka asnjë detyrim ligjor për të marrë masat për të siguruar faqet web të institucioneve.

***Qëndrimi i grupit të auditimit:***

Sqarojmë se konstatimi dhe rekomandimi i grupit të auditimit do të qëndrojë për sa kohë mbështetet në VKM nr. 673 datë 22.11.2017, e ndryshuar, ku një nga shërbimet që AKSHI ofron sipas kataogut të shërbimeve është dhe certifikatat e sigurisë SSL. Rekomandimi është riformuluar në mënyrë që kjo kërkesë të identifikohet dhe të nisë nga IQ, ndërsa zgjidhja teknike është detyrë e AKSHI-t.

*Për këtë arsye, ky observacion nuk pranohet dhe mbetet i njëjtë në këtë raport auditimi.*

**2.4 Auditimi i sistemeve**

*Verifikim i kontrolleve të aplikacioneve për të dhënat Input/Output*

*Auditimi mbi kontrollet e aplikacioneve dhe të dhënat Input/Output*

*Objektivi.* Vlerësimi i kontrolleve të aplikacioneve për të dhënat Input/Output ka si qëllim të verifikojë kontrollet e implementuara në aplikacionet që disponon dhe operon Autoriteti Kombëtar i Ushqimit si dhe hyrjen me saktësi të të dhënave dhe raportimin e tyre në funksion të arritjes së objektivave.

Në zbatim të pikës 4 “*Auditimi i Sistemeve*” me drejtim “*Auditimi mbi kontrollet e aplikacioneve dhe të dhënat Input/Output*”, kemi shqyrtuar:

- Manualët e përdorimit të sistemit e-inspektimi;
- Ndjekjen e realizimit të proceseve të punës ose ndryshe Workflow;
- Analizimin e gjurmës audituese të dokumentuar në letër apo elektronike (logs);
- Pyetësorë e Intervista me punonjës, monitorim të hapave inspektues online në terren ;
- Aktet ligjore/nënligjore/rregullative që përcaktojnë regjistrimin dhe ruajtjen e të dhënave;
- Standardet e miratuara nga CESK, etj.

## **I. Regjistrimi i bazave me të dhëna shtetërore**

*Regjistrimi i bazës së të dhënave shtetërore në AKU.* AKSHI i është drejtuar AKU me shkresën nr.1453/1, datë 18.08.2015 në përgjigje të shkresës nr.8461/1, datë 30.07.2015 me qëllim plotësimin e mangësive të konstatuara në dokumentacionin e përgatitur nga AKU lidhur me procesin e regjistrimit të bazës së të dhënave shtetërore.

AKSHI me anë të shkresës nr.3222, datë 07.05.2021 njofton përsëri AKU, për detyrimin ligjor që rrjedh prej ligjit nr.10325, datë 23.09.2010 “Për bazat e të dhënave shtetërore”, i kërkon Autoritetit Kombëtar të Ushqimit, marrjen e masave për hartimin e aktit të krijimit për bazën e të dhënave shtetërore dhe dërgimin për verifikim të të dhënave parësore që gjeneron.

*Nga auditimi u konstatua se,* megjithëse AKU ka pasur një sistem informatikë për të dhënat e inspektimeve, etiketave, gjobave, certifikatave veterinarë etj., me të dhëna parësore dhe të rëndësishme që gjenerohen vetëm nga Autoriteti për Sigurinë Ushqimore, këto të dhëna nuk janë të regjistruara si të dhëna shtetërore.

AKU që prej vitit 2018 operon për inspektimet në sistemin e-inspektimi dhe nuk ka asnjë sistem informatikë në funksion për inspektimin, çfarë e vështirëson identifikimin e të dhënave për regjistrimin e bazës së të dhënave të cilat gjenerohen nga aktiviteti i saj.

Drejtuesit e AKU që vitit 2012, janë përgjegjës për mos zbatim të akteve ligjore dhe nënligjore për bazat e të dhënave shtetërore si:

- Ligjit nr.10325, datë 23.09.2010 “Për bazat e të dhënave shtetërore” dhe konkretisht nenet 4.1, 4.2, 5, 7, 8;
- VKM nr.945, datë 02.11.2012 “Për miratimin e rregullores “administrimi i sistemit të bazave të të dhënave shtetërore” dhe konkretisht nenet: 4, 5, 6, 7, 8, 9 etj.

*Regjistrimi i bazës së të dhënave shtetërore në IQ.* AKSHI i është drejtuar IQ me shkresën nr.98, datë 13.01.2017 në përgjigje të shkresës nr.572/1, datë 14.12.2016 me qëllim plotësimin dhe qartësimin e informacionit për shërbimet që ofrohen nga baza e të dhënave të sistemit e-inspektimi, përgatitur nga IQ për procesin e regjistrimit të bazës së të dhënave shtetërore.

Në këtë dokument drejtuar IQ, AKSHI si institucion koordinues i të dhënave nuk kërkon apo informon IQ për të dhënat të cilat ajo i ka detyrues sepse nuk është IQ institucioni që i gjeneron këto të dhëna me ligj, pavarësisht se ka ndërtuar një sistem me qëllim inkorporimin e inspektimeve në një sistem online.

AKSHI me anë të shkresës nr.3168, datë 06.05.2021, pra në të njëjtin muaj që i ka dërguar njoftim AKU-s për detyrimin ligjor që rrjedh prej ligjit nr.10325, datë 23.09.2010 “Për bazat e të dhënave shtetërore”, i kërkon IQ që të vijojë me procesin e regjistrimit të të dhënave duke filluar me dërgimin e kërkesës pranë ARK/AKSHI-t.

*Nga auditimi u konstatua se,* IQ ka një sistem informatikë që mbledh informacion për të dhënat e inspektimeve, por nuk ka kryer regjistrimin e të dhënave detyrues që merr nga institucionet që gjenerohen, si dhe përgjegjësi e kujt janë këto të dhëna dhe çfarë përgjegjësie ka IQ në ruajtjen dhe sigurinë e tyre.

Duke qenë se të dhënat nuk i përkasin IQ edhe pse ruhen nëpërmjet sistemit e-inspektimi për të cilin ka qenë dhe administrator deri në fund të 2017, ndërveprimi me bazën e të dhënave të QKB duhej të ishte i ndaluar, në bazë të nenit 8 të ligjit nr.10325, datë 23.9.2010 “*Bazat e të dhënave shtetërore*”.

Nga auditimi u konstatua se, sistemi e-inspektimi është në funksion dhe ndërvepron me sistemin e QKB, në kundërshtim me:

- Nenin 8 të ligjit nr.10325, datë 23.9.2010, për “*Bazat e të dhënave shtetërore*”, ku citohet se “1. Ndërveprimi ndërmjet bazave të dhënave shtetërore bëhet vetëm me të dhënat parësore. 2. Ndalohet ndërveprimi i bazave të dhënave shtetërore me të dhënat dytësore”;
- Nenin 9 pika 5 e VKM nr. 945, datë 02.11.2012 “Për miratimin e rregullores “administrimi i sistemit të bazave të të dhënave shtetërore” ku citohet se “Një bazë të dhënash shtetërore, e cila nuk është e regjistruar në ARK, nuk vihet në përdorim dhe as ndërvepron me të tjera baza të dhënash shtetërore”.

**Për këtë mban përgjegjësi drejtuesi i AKSHI-t/ARK veprimet e të cilëve janë në kundërshtim me:**

- **Nenin 8 i ligjit nr.10325, datë 23.9.2010, për “*Bazat e të dhënave shtetërore*”;**
- **Nenin 9, pika 5 e VKM nr. 945, datë 02.11.2012 “Për miratimin e rregullores “administrimi i sistemit të bazave të të dhënave shtetërore””;**

AKSHI dhe ARK si Autoriteti Rregullator Koordinues. Me kalimin e strukturës së teknologjisë së informacionit nga AKU tek AKSHI në zbatim të VKM nr. 673, datë 22.11.2017 “*Për riorganizimin e agjencisë kombëtare të shoqërisë së informacionit, i ndryshuar*”, AKU nuk ka specialistë të teknologjisë së informacionit në strukturën e saj, që të ndihmojnë identifikimin dhe procesin e regjistrimit të të dhënave si të dhëna shtetërore. E njëjtë është situata dhe për Inspektoratin Qendror.

Nga auditimi mbi këto të dhëna u konstatua se, IQ nuk gjeneron të dhëna parësore përveç numrit të inspektorëve dhe nuk mund të regjistrojë një bazë të dhënash shtetërore ku të dhëna parësore të jenë të dhënat e inspektimeve.

Të dy institucionet IQ dhe AKU nuk kanë kërkuar dhe as marrë asnjë informacion nga AKSHI/ARK nëse të dhënat e tyre janë të regjistruara si të dhëna parësore të një institucioni tjetër në zbatim të nenit 6, pika 1 e VKM nr. 945, datë 02.11.2012 “Për miratimin e rregullores “administrimi i sistemit të bazave të të dhënave shtetërore”” ku citohet se “*Institucioni, i cili kërkon të krijojë një bazë të dhënash shtetërore ose për të ndryshuar përbërjen e të dhënave të mbledhura në një bazë të dhënash shtetërore, duhet të kërkojë pranë ARK-së, nëse të dhënat e nevojshme janë mbledhur ose mblidhen nga një tjetër bazë të dhënash shtetërore ekzistuese.*”

AKSHI kërkon nga institucionet që të hartojnë dhe identifikojnë të dhënat, në mungesë të punonjësve të specializuar ndërkohë që sipas pikës gj. në paragrafin II Kompetencat, detyrat dhe përgjegjësitë e AKSHI-t në VKM nr.673, datë 22.11.2017 “*Për riorganizimin e Agjencisë Kombëtare të Shoqërisë së Informacionit, i ndryshuar*” është përgjegjës për ngritjen, mirëmbajtjen dhe administrimin e sistemeve dhe aplikacioneve të teknologjisë së informacionit dhe komunikimit, infrastrukturën e qendëruar dhe infrastrukturën TIK.

**10. Titulli i Gjetjes:** Mbivendosje ligjore për administrimin e sistemit e-inspektimi në VKM nr.696, datë 16.08.2013 dhe VKM nr.673 datë 22.11.2017.

**Situata:** Nga auditimi u konstatua se, sipas përcaktimeve të VKM nr. 696, datë 16.08.2013 dhe VKM nr. 673 datë 22.11.2017, IQ dhe AKSHI janë të dy institucione administrues të aplikacionit informatik “e-inspektimi”. Sipas pikës 2 paragrafi X i VKM nr. 696, datë 16.08.2013 “Për përcaktimin e procedurave të ushtrimit të kompetencave të Inspektoratit

*Qendror dhe të rregullave për përmbajtjen dhe administrimin e portalit unik “e-inspektimi” dhe pikës gj, paragrafi II në VKM nr. 673, datë 22.11.2017 “Për riorganizimin e Agjencisë Kombëtare të Shoqërisë së Informacionit, i ndryshuar”, në të cilat respektivisht citohet se:*

- Inspektorati Qendror është përgjegjës për krijimin, administrimin dhe mirëmbajtjen e Portalit, i cili mbahet në format elektronik. Regjistrimi, përpunimi, përdorimi, publikimi dhe ruajtja e të dhënave e informacionit në të kryhen nëpërmjet një sistemi të informatizuar.

- AKSHI ngre, mirëmban dhe administron sisteme dhe aplikacione të teknologjisë së informacionit dhe komunikimit, infrastrukturën e qendëruar dhe infrastrukturën TIK, përfshirë edhe ato të klasifikuara si “sekret shtetëror”, për institucionet dhe organet e administratës shtetërore nën përgjegjësinë e Këshillit të Ministrave.

**Kriteri:** Pika 2 paragrafi X i VKM nr.696, datë 16.08.2013 “Për përcaktimin e procedurave të ushtrimit të kompetencave të Inspektoratit Qendror dhe të rregullave për përmbajtjen dhe administrimin e portalit unik “e-inspektimi” dhe pika gj. paragrafi II në VKM nr.673, datë 22.11.2017 “Për riorganizimin e Agjencisë Kombëtare të Shoqërisë së Informacionit, i ndryshuar”.

**Ndikim/Efekti:** Mbivendosje kompetencash e cila shkakton mos marrje të përgjegjësisë për zgjidhjen e problematikave që i takon mirëmbajtjes.

**Shkaku:** Nuk janë marrë masat e nevojshme nga institucionet për të iniciuar ndryshimet ligjore.

**Rëndësia:** E lartë

**Rekomandimi:** Inspektorati Qendror dhe AKSHI si administratore të sistemit e-inspektimi mbështetur në aktet ligjore respektive, të ndjekin hapat e nevojshëm ligjorë për interpretim dhe shfuqizim nëse do të jetë e nevojshme të një prej neneve që mbivendosin të drejtën administrative të këtij sistemi.

*Agjencia Kombëtare e Shoqërisë së Informacionit, ka , ka paraqitur observacion me shkresën nr.7255/3, datë 25.02.2022 protokolluar në KLSH me nr. 978/9 datë 01.03.2022, ku citohet:*

**Pretendimi:** Objeksione në lidhje me rekomandimin nr. 11 në këtë raport: AKSHI shprehet se: përmbajtjet e secilit vendim që i referohet grupi i auditimit nuk janë aspak në kundërshtim me dhe për këtë arsye AKSHI me IQ nuk kanë përplasjesh kopetencash dhe përgjegjësish. Kjo sepse në shkronjën “y”, të pikës 6, të Kreut II, të Vendimit nr. 673, përcaktohet shprehimisht se: Regjistrat e të dhënave të këtyrë institucioneveqë përbëhen nga bazat e të dhënave mbeten nën administrimin të instiucioneve respektive.

Gjithashtu AKSHI shpehet se interpretimet mbi kuadrin ligjor në fuqi janë kopetencë e Gjykatës Kushtetuese dhe jo e KLSH-s.

**Qëndrimi i grupit të auditimit:**

Në gjykimin tonë, përcaktimet ligjore mbi administrimin e sistemit e-inspektimi janë në konflikt, për këtë arsye ne kemi rekomanduar që të dy institucionet IQ dhe AKSHI si administratorë të këtij sistemi, mbështetur në aktet ligjore respektive nevojitet të ndiqni hapat e nevojshëm.

*Për këtë arsye, ky observacion nuk pranohet por riformulohet me qëllim qartësimin e subjektit, në këtë raport auditimi.*

**11. Titulli i Gjetjes:** Regjistrimi i të dhënave shtetërore të inspektimit nuk është përfunduar.

**Situata:** Nga auditimi mbi të dhënat shtetërore të AKU dhe IQ u konstatua se, AKSHI edhe pse **institucion administrues i sistemeve dhe aplikacioneve, njëkohësisht dhe Autoriteti Rregullator Koordinues, ka kërkuar** nga IQ dhe AKU përmbushjen e një detyrimi ligjor lidhur me regjistrimin e të dhënave që gjenerojnë si të dhëna shtetërore.

Në nenin 7, pika 1 të VKM nr.945, datë 02.11.2012 “Për miratimin e rregullores “Administrimi i sistemit të bazave të të dhënave shtetërore””, citohet se “Institucioni, i cili kërkon të krijojë

*një bazë të dhënash shtetërore, bashkëpunon me ARK-në për përgatitjen e dokumentacionit të bazës së të dhënave”, tregon se nevojitet një bashkëpunim nga ana e AKSHI-t, jo thjesht delegim tek institucionet plotësimi i detyrimeve ligjore për bazat e të dhënave shtetërore. IQ dhe AKU nuk kanë në strukturën e tyre asnjë specialist të fushës së teknologjisë së informacionit, për administrimin e të dhënave të cilat janë aktualisht pa përgjegjësi. Administrimi i të dhënave është përgjegjësi e institucionit që i krijon ato.*

**Situata:** Nga auditimi u konstatua se, sistemi e-inspektimi është në funksion dhe ndërvepron me sistemin e QKB, në kundërshtim me:

- Nenin 8 të ligjit nr.10325, datë 23.9.2010, për “Bazat e të dhënave shtetërore”, ku citohet se “1. Ndërveprimi ndërmjet bazave të dhënave shtetërore bëhet vetëm me të dhënat parësore. 2. Ndalohet ndërveprimi i bazave të dhënave shtetërore me të dhënat dytësore”;

- Nenin 9 pika 5 e VKM nr. 945, datë 02.11.2012 “Për miratimin e rregullores “administrimi i sistemit të bazave të të dhënave shtetërore” ku citohet se “Një bazë të dhënash shtetërore, e cila nuk është e regjistruar në ARK, nuk vihet në përdorim dhe as ndërvepron me të tjera baza të dhënash shtetërore”.

**Kriteri:** Neni 7, pika 1 të VKM nr.945, datë 02.11.2012 “Për miratimin e rregullores “Administrimi i sistemit të bazave të të dhënave shtetërore””.

**Ndikim/Efekti:** Një bazë të dhënash e paregjistruar, me të cilën janë ndërtuar ndërveprime me baza të dhënash shtetërore në kundërshtim me ligjin dhe sigurinë e të dhënave.

**Shkaku:** Deri në vitin 2017 nuk janë marrë masa nga vetë institucionet AKU dhe IQ për përfundimin e këtij regjistrimi si detyrim ligjor i ligjit nr. 10325, datë 23.09.2010 “Për bazat e të dhënave shtetërore” dhe VKM nr.945, datë 02.11.2012 “Për miratimin e rregullores “Administrimi i sistemit të bazave të të dhënave shtetërore””.

Prej viti 2018 kur institucionet nuk kanë pasur më në strukturën e tyre specialistë të teknologjisë së informacionit, është AKSHI ai që nuk ka vepruar për përfundimin e regjistrimeve të të dhënave në këto subjekte, për më tepër kur gjatë kësaj kohe AKU nuk ka pasur sistem, por të dhënat e saj administrohen nga dy administratorët e sistemit e-inspektimi, AKSHI dhe IQ.

**Rëndësia:** E lartë

**Rekomandimi:** AKU dhe IQ të marrin masat e nevojshme për ndryshime në strukturën e tyre institucionale me qëllim shtimin e një ose më shumë pozicioneve që do të kryejnë detyrat e administrimit të të dhënave që secili prej institucioneve krijon dhe administron në mënyrë elektronike. Administrimi i të dhënave është një shërbim që nuk i ngarkohet dhe nuk e mbulon AKSHI me specialistët e tij në institucionet tuaja.

**Rekomandimi:** AKSHI si Autoriteti Rregullator Koordinues, me ndryshimin e strukturës dhe përcaktimin e punonjësve përgjegjës, për të dhënat elektronike që disponojnë apo krijojnë institucionet IQ dhe AKU, të bashkëpunojë për regjistrimin e bazës së të dhënave duke pasur në konsideratë identifikimin e të dhënave parësore, të dhënat dytësore dhe çdo element që është i nevojshëm me qëllim përfundimin e procesit të regjistrimit të të dhënave shtetërore të inspektimit.

**Rekomandimi:** AKSHI të marrë masa të menjëhershme në identifikimin e përgjegjësish dhe dhënien e masës administrative për ndërveprimin e ndërtuar dhe lejuar ndërmjet një baze të dhënash shtetërore sic është ajo e QKB me një bazë të dhënash jo shtetërore sic është ajo e inspektimit.

*Agjencia Kombëtare e Shoqërisë së Informacionit, ka , ka paraqitur observacion me shkresën nr.7255/3, datë 25.02.2022 protokolluar në KLSH me nr. 978/9 datë 01.03.2022, ku citohet:*

**Prendimi:** Objeksione në lidhje me rekomandimin nr. 12 në këtë raport: AKSHI shprehet se: Grupi i auditimit nuk ka marrë si duhet përcaktimet ligjore të ligjit nr.10325/2010, ku në nenin 4 përcaktohet se: Aktet ligjore krijohen me Ligj dhe me VKM. Akti i krijimit të bazës së të dhënave shtetërore përcakton: Institucionin administruar të bazës së të dhënave shtetërore; të

dhënat parësore dhe dytësore; dhënësit/ dhënësin e informacionit; ndërveprimin me bazat e tjera të të dhënave; nivelin e aksesimit për subjektet e interesuara. Për sa më sipër mbetet e paqartë nga ana jonë se në cilin legjislacion bazohet grupi i auditimit për hedhjen e përgjegjësisë tek AKSHI për përcaktimin e të dhënave parësore e dytësore për institucionet IQ dhe AKU.

#### ***Qëndrimi i grupit të auditimit:***

Duam t'ju sqarojmë se për stafin jo teknik që kanë tashmë institucionet, është e vështirë të kuptojnë ndryshimin midis administrimit të të dhënave dhe administrimit të sistemit. Kërkesa juaj për regjistrimin e të dhënave shtetërore nuk mund të zbatohet sa kohë institucionet nuk kanë asnjë përgjegjësi për të dhënat e tyre. Në këtë rast të dy institucionet IQ dhe AKU nuk e kuptojnë çfarë ju kërkoni, e kjo do të thotë se kujtesa që ju i bëni për regjistrimin e të dhënave është në rregull nga pikëpamja pragmatiste, por problemi do të qëndrojë aty pa u zgjidhur. Institucionet por mbi të gjitha përgjegjësitë do të ishin shumë të qarta nëse ju si instiucioni i përqëndruar për shërbimet t'i udhëzonit institucionet çfarë të bëjnë që asnjë drejtim i IT mos të mbetet pa përgjegjësi si kundër janë aktualisht.

*Grupi gjykon se meqënëse është e qartë si për ne ashtu dhe për AKSHI-n se të dhënat janë përgjegjësi e institucioneve gjetja dhe rekomandimi do të riformulohet me qëllim që të rekomandohet ndryshim strukture tek të dy instiucionet që ky drejtim në TIK të mos mbetet pa përgjegjësi. Ndryshimet pasqyrohen në këtë raport auditimi.*

## **I. Sistemi AKU-net**

AKU-net është një aplikacion me bazën e të dhënave në ORACLE. Ky aplikacion është ndërtuar në kuadër të projektit IPA 2009 dhe 2010 me suport të ekspertëve ndërkombëtarë për krijimin e moduleve për PIK dhe Laboratorët.

Deri në fillim të vitit 2017, sistemi AKU-net ka funksionuar si një platformë ku administroheshin **të dhënat për:**

- Inspektimet;
- Notifikimi i etiketave;
- Statusi aktual i çdo gjobe të vendosur;
- Numrin e certifikatave veterinare.

Nga KLSH është konstatuar në auditimet e mëparshme se, AKU ka lidhur kontrata për mirëmbajtjen e sistemit AKU -net, për të tre vitet 2015- 2016 deri në gusht 2017 , periudhë në të cilën është bërë pagesa e fundit për këto shërbime, ky sistem ka pasur standard suport të tij dhe suport zhvillimi sipas përshkrimit të shërbimeve të cilat kanë qenë në shumën 144,166,126 lekë. Ky sistem ka shfaqur probleme për gjatë vitit 2016 kohë në të cilën ishte nën suport dhe mirëmbajtje, për të cilën paguheshin dhe miratoheshin raporte nga AKU. E njëjta situatë ka vazhduar dhe përgjatë vitit 2017, ku për të cilin janë shpenzuar fonde buxhetore për mirëmbajtjen e tij sipas kontratave të cilësuar më sipër, deri sa në vitin 2018 ky sistem nuk ishte më në përdorim nga AKU. Aksesimi i tij herë pas here bëhet për të dhëna historike të AKU-s, të cilat dhe sot nuk janë importuar në sistemin e-inspektimi.

Gjatë periudhës 2020-2021 me kërkesë të AKSHI-t, AKU ka identifikuar e renditur kërkesat që i nevojiten përmirësimit të sistemit AKU-net. Sistemi **“AKU-net i përmirësuar” mendohetë ndërtohet në përputhje me gjithë fushëveprimin e AKU-s dhe të ndër-veprojë me disa sisteme të tjera të rëndësishme** si: sistemi doganor Asycuda, e-inspektimin, sistemin e QKB dhe QKL, sistemin e tatimeve si dhe sisteme të tjera të rëndësishme të cilat gjenerojnë të dhëna informuese për aktivitetin e AKU-s.

**Aktualisht të dy institucionet AKSHI dhe AKU kanë me shumë se 2 vjet që bashkëpunojnë për hartimin e specifikimeve teknike.**

Në asnjë rast nga ana e AKSHI-t, si administrator i sistemit “e-inspektimi” që prej 2018, nuk është konsideruar, zhvillimi apo përmirësimi i këtij sistemi, por është parë e arsyeshme hartimi i kërkesave për të përmirësuar AKU-net, për të cilat ende institucionet nuk kanë arritur në përmbledhjen përfundimtare, për shkak të ndryshimeve në specifikat teknike që paraqesin të dy palët.

Nga dokumentacioni i vënë në dispozicion nga IQ u konstatua se, vlera e kontratës së mirëmbajtjes për sistemin “E-inspektimi” ka qenë në vlerën **656,250 lekë në muaj pa TVSH**. Mirëmbajtja e sistemit “E-inspektimi”, nënshkruar nga AKSHI, mban vlerën **64,523,700 lekë** pa TVSH, për një periudhë 2 vjeçare (24 muaj shkruar në kontratë), ku vlera mujore përlllogaritet afërsisht **2,688,487.5 pa TVSH, ose afërsisht 4 herë më shumë se vlera mujore e kontraktuar kur ky sistem administrohej nga IQ.**

Sistemi AKU-net, një sistem për të cilin AKU ka paguar për periudhën 2015 deri në gusht 2017, vlerën e mirëmbajtjes në **shumën 144,166,126 lekë**, që prej vitit 2018 AKU nuk kryen më asnjë veprim, pasi procedurat e inspektimit u vendos të kryheshin nëpërmjet sistemit “E-inspektimi”, administruar deri në 2018 nga Inspektorati Qendror, ndërsa prej 2018 e deri sot nga AKSHI.

Inspektorati Qendror, me shkresën nr.Prot.567, datë 20.12.2021 ka përcjellë pranë Kryeministrit të dërgimin e dokumentacionit të draftit me ndryshimet ligjore, për inspektimin në Republikën e Shqipërisë me objekt “Riorganizimi i trupave inspektuese shtetërore sipas fushave të inspektimit me funksione të ngjashme inspektuese si dhe menaxhimin dhe koordinimin më të mirë të të gjithë inspektorateve shtetërore”.

**12. Titulli i Gjetjes:** Riorganizimi i Inspektoriatit Qendror dhe Inspektorateve Shtetërore.

**Situata:** Inspektorati Qendror dhe Inspektoratet Shtetërorë ku bën pjesë dhe AKU, aktualisht janë në fazë ristrukturimi, kërkesa dërguar Kryeministrit të shkresën nr.561, datë 20.12.2021 nga IQ. Me miratimin e këtij ristrukturimi, inspektoratet shtetërorë do të jenë pjesë e Inspektoratit Qendror, përfshirë dhe AKU. Për këtë arsye për përmirësimin e sistemit AKU-net duhet të merren në konsideratë ndryshimet ligjore të propozuara të cilat ndikojnë në veprimtarinë e AKU.

**Kriteri:** Propozimet ligjore dërguar Kryeministrit të shkresën nr.561, datë 20.12.2021.

**Ndikim/Efekti:** Risk i lartë për ndërtimin e një sistemi ndërkohë që institucioni parashikohet të jetë pjesë e ristrukturimit të Inspektoratit Qendror me propozimet ligjore në proces miratimi.

**Shkaku:-**

**Rëndësia:**E lartë

**Rekomandimi:** AKSHI dhe AKU të marrin në konsideratë ndryshimet ligjore të cilat do të ndikonin tek AKU me miratimin e ri-organizimit të trupave inspektuese kërkuar nga IQ, në mënyrë që përmirësimi i sistemit të jetë në përputhje me këto ndryshime duke siguruar në këtë mënyrë mirë administrimin e fondeve për këtë qëllim.

*Titullari i AKU znj. Jeta Dede, ka paraqitur observacion me shkresën nr.3411/3, datë 28.02.2022 protokolluar në KLSH me nr. 978/7 datë 28.02.2022, ku citohet:*

**Pretendimi:** Objeksione në lidhje me gjetjen nr.14: Nuk mund të bëhet shkak për të ndaluar proceset e filluara nga AKSHI dhe AKU, për rivitalizimin dhe përmirësimin e sistemit AKU-net, supozimi se AKU mund të jetë pjesë e IQ.

Së dyti, veprimtaria në PIK momentalisht nuk zhvillohet në mënyrë të automatizuar dhe pikërisht për këtë AKU në bashkëpunim me AKSHI-n ka filluar veprimet, për të vënë në efikasitet sistemin e saj AKU-net.

**Qëndrimi i grupit të auditimit:** Që Inspektimet në PIK, kanë mbetur jashtë sistemit “e-inspektimi” është konstatuar dhe nga auditimi, për të cilin janë lënë masa rekomanduese, ekzaktësisht me nr. 15 në këtë raport auditimi. Hapat që ndiqen në PIK nuk janë të njëjta me formatet e inspektimit të zakonshëm dhe nuk është bërë i mundur ndërtimi e një procesi me hapat specifik për këtë lloj inspektimi, dhe bazuar në informacionin e marrë nga Inspektorati Qendror, u konstatua se ky institucion është duke punuar për hartimin e dokumentacionit të Inspektimit në PIK, për portalin Unik “e-inspektimi”. IQ nuk mund të jetë duke bërë një punë për inspektimet e AKU-s pa dijeninë tuaj.

Ju sqaroj se shkresa të cilës i referohet grupi për ristrukturimin e trupave audituese është me nr. Prot.561, datë 20.12.2021 dërguar nga IQ në Kryeministri dhe nuk është **supozim i yni**. Detyra jonë kryesore si auditues është auditimi mbi administrimin me ekonomicitet, efikasitet dhe efektivitet të fondeve publike dhe nisur nga ky objektivi ju kemi vënë në dijeni se mund të jeni në një risk, për shpenzim jo të mirë të fondeve me përmirësimin e një sistemi specifik AKU-net, ndërkohë që si nga AKU dhe nga IQ është pranuar se kanë nisur procedurat për informatizimin e PIK në sistemin e-inspektimi.

Gjithashtu, rekomandimi ynë ishte për një pezullim të përkohshëm dhe jo përfundimtar me qëllim që fondet e planifikuara për këtë sistem mos të keqpërdoren apo sistemi të mos gjejë zbatim për shkak të ndryshimeve ligjore që janë kërkuar nga IQ.

Megjithatë, grupi i auditimit, vendos t’ju ngarkojë ju përgjegjësinë e menaxhimit të kësaj situatë të cilën mendoni se ne po bëhemi pengesë për informatizimin e proceseve që kaq kohë kanë mbetur jashtë sistemit si ai në PIK. Për këtë arsye, ky rekomandim do të riformulohet dhe ndryshimet pasqyrohen në këtë raport përfundimtar auditimi.

*Agjencia Kombëtare e Shoqërisë së Informacionit, ka paraqitur observacion me shkresën nr.7255/3, datë 25.02.2022 protokolluar në KLSH me nr. 978/9 datë 01.03.2022, ku citohet:*

**Pretendimi:** Objeksione në lidhje me rekomandimin nr. 13 në këtë raport: AKSHI shprehet se: aktualisht AKU ka në administrim sistemin AKU-net i cili mbulon një pjesë të mirë të proceseve të punës që kryhen nga AKU. Përmirësimi i sistemit ka ardhur si kërkesë e AKU ku dhe vetë grupi i auditimit ka dalën me rekomandimet e përmirësimit të situatës në TIK sepse sistemi aktual nuk i përmbush të gjitha kërkesat që ka AKU. Është e pamundur nga ana jonë që të ndalojmë kryerjen e procedurës së prokurimit bazuar në rekomandime të grupit të auditimit mbi njoftimin se IQ ka draftuar ndryshime ligjore të legjislativës në fuqi.

**Qëndrimi i grupit të auditimit:**

Duam t’ju sqarojmë se pari se AKU ka të dhëna në sistemin AKU-net por ky sistem nuk është më në funksion që prej vitit 2018 dhe AKU nuk kryen asnjë proces pune nëpërmjet tij.

Së dyti shkresa të cilës i referohet grupi për ristrukturimin e trupave audituese është shkresa me nr. Prot.561, datë 20.12.2021 dërguar nga IQ në Kryeministri dhe nuk është supozim i yni. Rekomandimi ynë ishte për një pezullim të përkohshëm dhe jo përfundimtar me qëllim që fondet e planifikuara për këtë sistem mos të keqpërdoren apo sistemi të mos gjejë zbatim për shkak të ndryshimeve ligjore që janë kërkuar nga IQ.

Megjithatë, grupi i auditimit, vendos t’ju ngarkojë ju përgjegjësinë e menaxhimit të kësaj situatë të cilën mendoni se ne po bëhemi pengesë për informatizimin e proceseve që ka të nevojshme AKU, për këtë arsye ky rekomandim është riformuluar në këtë raport përfundimtar auditimi.

## II. Sistemi e-Inspektimi

Në vitin 2017 nga Inspektorati Qendror u krijua dhe u vendos në funksion *platforma e-inspektimi*, platformë e cila ka pasur si qëllim rritjen e transparencës, me kryerjen e procedurave të inspektimit online.

E-inspektimi është portali unik i inspektimit, që shërben për programimin dhe bashkërendimin e inspektimeve, për kryerjen e veprimtarisë së inspektimeve online, mbikëqyrjen e veprimtarisë inspektuese, shkëmbimin e të dhënave ndërmjet inspektorateve shtetërorë/ vendore/ trupat e tjera inspektuese, sistemeve të tjera të digjitalizuara të administratës shtetërore si dhe informimin e publikut. Platforma online “*e-Inspektimi*”, ofrohet në dy versione Web dhe Mobile.

Qëllimi kryesor i këtij sistemi elektronik është të jetë një instrument i fuqishëm për funksionimin e përditshëm të inspektorëve, në mënyrë që të lehtësojnë punën e tyre, të ndërtojnë dhe monitorojnë një proces transparent të inspektimit.

Nëpërmjet kësaj platformë, është menduar të mbulohen të gjitha informacionet e nevojshme për të përgatitur dhe të kryer një procedurë inspektimi. Veprimtaria e përditshme e inspektorateve shtetërore dhe e inspektorëve pasqyrohet në portalin unik të inspektimit “*e-Inspektimi*” dhe aplikacionit mobile “*e-Inspektimi*”.

Pjesë e kësaj platforme është bërë dhe AKU që prej vitit 2018, si institucion inspektues kombëtar, për ushqimin në vend.

*Komponentët e sistemit online “e-Inspektimi”, në versionin Web janë:*

1. Moduli i portalit e-inspection, i cili shërben si panel për administrimin e përmbajtjes që duhet të shfaqen te website-in <http://www.e-inspektimi.gov.al/SitePages/Home.aspx> të cilat shikohen dhe nga publiku.
2. Moduli i të dhënave të inspektorit dhe inspektorateve, i cili shërben për menaxhimin e përdoruesve, inspektorateve që përdorin sistemin.
3. Moduli i programimit, i cili shërben për konfigurimin e programeve vjetore, mujore dhe krijimin e gjenerimin e çështjeve brenda planit.
4. Moduli i njohurive dhe të mësuarit, i cili shërben për konfigurimin e listave verifikuese që përdoren gjatë inspektimeve.
5. Moduli i administrimit të çështjeve të inspektimit, i cili shërben për krijimin e çështjeve jashtë planit dhe procedimin e çështjeve brenda apo jashtë planit sipas hapave përkatës që ndiqen gjatë një procesi inspektimi. Ky modul përfshin Sistemin e Administrimit të Inspektimeve (Case Administration Management System - CAMS), Sistemin e administrimit të Dokumenteve (Documents Management System - DMS) dhe Sistemi i Arkivimit të Dokumenteve (Records Management System - RMS).
6. Moduli i vlerësimit të riskut, i cili shërben për konfigurimet e faktorëve të riskut që ndikojnë në vlerësimin e riskut të subjektit, dhënien e vlerësimit nga inspektori për çdo faktor risku brenda çështjes nën inspektim dhe më pas përlllogaritjen automatike finale të riskut të çdo subjekt që inspektohet, sipas formulave të specifikuar nga IQ (Inspektorati Qendror).
7. Moduli i subjekteve dhe i të dhënave të objekteve të inspektimit, i cili shërben për ruajtjen e subjekteve që mund të inspektohen dhe aktivitetet përkatëse në të cilat operojnë subjektet.
8. Moduli i raportimit, i cili shërben për shfaqjen e raporteve të ndryshme statistikore për Inspektoratin Qendror dhe Inspektoratet Shtetërore.
9. Moduli i ndërveprimit dhe komunikimit shërben për shkëmbimin e të dhënave me sistemet e institucioneve të tjera pjesë e rrjetit GovNet.

*Komponentët e sistemit online “e-Inspektimi”, në versionin Mobile janë:*

1. Modulin e mbledhjes së të dhënave të shërbimeve të të gjitha llojeve të Inspektorateve në nivel kombëtar, nëpërmjet rrjetit 4G/LTE.
2. Modulin e menaxhimit të të dhënave – të rendisë dhe ruajë informacionet (raportet) gjeneruar gjatë punës së përditshme. Të dhënat duhet të jenë të organizuara në tabelë të detajuara, në mënyrë që informacioni i ruajtur lehtësisht në to, të jetë lehtësisht i lexueshëm dhe i përdorshëm për të krijuar raporte sipas nevojës së IQ.
3. Modulin e raportimeve online – duhet të gjenerojë raporte të optimizuara nga databaza qendrore.
4. Moduli i menaxhimit në back office – të mundësojë konfigurimet e ndryshme në çdo kohë në përputhje me ndryshimet që mund të ketë legjislacioni i përditësuar, menaxhimin e përdoruesve, të drejtave dhe kufizimeve, azhornimeve të nevojshme për aplikacionet nëpër termialet (tabletat) që janë në përdorim nga Inspektorët në gjithë vendin.
5. Moduli i suportit teknik (help desk) – të ofrojë shërbimin e suportit teknik dhe këshillimit procedural për Inspektorët, si dhe për të gjithë qytetarët apo subjektet e interesuara.
6. Modulin/ndërfaqen që bën të mundur për nënshkrimin elektronik të aktit të inspektimit. (nëpërmjet tabletit)
7. Moduli i sinkronizimit të të dhënave – të mundësojë sinkronizimin e të dhënave nga tableta në server dhe anasjelltas në mënyrë që aplikacioni të jetë i përdorshëm edhe kur nuk ka rrjet, në modalitetin "offline".
8. Modulin/ndërfaqen për mundësimin e regjistrimit të të dhënave për pozicionimin gjeografik, si dhe regjistrimin e plotë elektronik të çështjes së inspektimit në infrastrukturën e serverave.

*Funksionet e Portalit e-inspektimi sipas rregullores për përcaktimin e procedurave dhe mënyrave, për përdorimin e portalit unik të inspektimit “e-inspektimi” janë:*

- Mbledhja, përpunimi dhe administrimi i të dhënave nga IQ, Inspektoratet Shtetërore / Vendorë dhe trupat e tjera inspektuese, në përputhje me parashikimin e ligjit të inspektimit, ligjet sektoriale, rregullores dhe akte të tjera ligjore në fuqi;
- Koordinimi dhe lehtësimi i veprimtarisë inspektuese të inspektorateve shtetërore / vendorë dhe trupave të tjera inspektuese si dhe mbikëqyrja e kësaj veprimtarie nga IQ;
- Plotësimi online i dokumenteve standarde dhe listë-verifikimit të inspektimit nga inspektorët gjatë kryerjes së veprimtarisë së inspektimeve në terren përmes portalit e-inspektimi;
- Administrimi i veprimtarisë së përditshme inspektuese, për të rritur efikasitetin, efektivitetin, dhe transparencën në fushën e inspektimit;
- Informimin e publikut në lidhje me të drejtat, detyrimet dhe kompetencat e parashikuara nga legjislacioni shqiptar dhe i zbatueshëm në fushën e inspektimit si dhe veprimtarinë e Inspektoratit Qendror, Inspektorateve Shtetërore/Vendore/Trupa të tjera Inspektuese;
- Përgatitja e raporteve periodike dhe vjetore në lidhje me veprimtarinë e inspektimit;
- Mbajtja e regjistrit kombëtar të inspektoreve;

Inspektorati Qendror na informon se ka përfunduar integrimin në sistemin elektronik “e-Inspektimi” për të gjithë Inspektoratet Shtetërore (strukturën e inspektoratit, të dhënat e përdoruesve sipas nivelit, dokumentet standarde të inspektimit, listat e verifikimit, legjislacionin, etj.). Në total janë pesëmbëdhjetë Inspektorate Shtetërore. Gjithashtu, pranë çdo Bashkie të Vendit (61 në total) funksionojnë Inspektoratet Vendore. Ka përfunduar integrimi i 9 inspektorateve vendore: Tiranë, Sarandë, Gjirokastrë, Fëniq, Himarë, Vlorë, Durrës, Divjakë, Kavajë. Gjatë kësaj faze pritet të bëhet dhe integrimi i Inspektorateve të tjera Vendore.

Çdo inspektorat i përfshirë në sistemin e-Inspektimi ka mundësinë të kryejë inspektimet nëpërmjet aplikacionit mobile, me tabletë, ose nëpërmjet versionit Web.

Inspektorati Qendror nëpërmjet urdhrin nr.58/1 me datë 22.01.2015, “Për miratimin e formateve standard për dokumentimin e veprimtarisë së inspektimit në Republikën e Shqipërisë”, ka përcaktuar formatet standarde për dokumentacionet si mëposhtë:

Formati nr.1: Autorizim Inspektimi

Formati nr.2: Procesverbal Inspektimi

Formati nr.2/1: Procesverbal Inspektimi (aty për aty)

Formati nr.3: Procesverbal Inspektimi (i posaçëm)

Formati nr.4: Vendimi i Ndërmjetëm (për marrjen e masës urgjente)

Formati nr.5: Vendimi Përfundimtar i Inspektimit

Formati nr.6: Vendimi për Zgjidhjen E Ankimit të Veçantë

Formati nr.7: Autorizim për Ndryshimin e Inspektoreve

Formati nr.8: Kërkesë për Refuzim të Autorizimit të Inspektimit

Formati nr.9: Kërkesë për Shtyrje të Autorizimit të Inspektimit

Formati nr.10: Vendim për Shtyrje të Autorizimit të Inspektimit

Formati nr.11: Vendimi i Komisionit të Ankimit

Formati nr.12: Ankesë për Vendimin Përfundimtar

Formati nr.13: Ankimi i Veçantë

AKU nuk ushtron inspektime me “Njoftim Paraparak” siç parashikohet në nenin 1 të ligjit nr.10433, datë 16.06.2011 “Për inspektimin në Republikën e Shqipërisë”. Në nenin 32 të po këtij ligji, në pikën 2.a dhe 2.b thuhet se njoftimi paraparak nuk kryhet në ato raste kur:

a. Ekziston rreziku që njoftimi mund të pengojë kryerjen me efektivitet të inspektimit;

b. Kur mos njoftimi përcaktohet shprehimisht nga ligji i posaçëm;

Nisur nga sa më sipër AKU, nuk mund të kryejë inspektime sipas modelit të ndërtuar në sistemin e-inspektimi me “Njoftim Paraparak” të subjektit nën inspektim, veprime të cilat mund të cenojnë drejtpërsëdrejti sigurinë ushqimore.

**13. Titulli i Gjetjes:** Ndërtimi i manualeve dhe workflow të sistemit parashikon kryerjen e inspektimit me “Njoftim paraparak” në kundërshtim me ligjin nr.10433, datë 16.06.2011 “Për inspektimin në Republikën e Shqipërisë” nenin 32 “Njoftimi i inspektimit”, pika 2.a dhe 2.b.

**Situata:** Nga auditimi mbi workflow dhe manualët e përdorimit të aplikacionit “e-inspektimi”, u konstatua se materialet udhëzuese workflow, manuale dhe video prezantimi, janë hartuar sipas hapave inspektues bazuar në nenin 1 të ligjit nr. 10433, datë 16.06.2011 “Për inspektimin në Republikën e Shqipërisë”, ku përcaktohet njoftimi paraparak i subjekteve, ndërkohë që AKU nuk kryen inspektime me njoftim paraparak të subjekteve në inspektim. AKU nuk mund të jetë pjesë e unifikimit të hapave inspektues lidhur me njoftimin paraparak, për këtë arsye dhe në manualët e inspektimeve duhej të trajtohet ndryshe nga inspektimet e tjera.

**Kriteri:** Ligjinr.10433, datë 16.06.2011 “Për inspektimin në Republikën e Shqipërisë” nenin 32 “Njoftimi i inspektimit”, pika 2.a dhe 2.b.

**Ndikim/Efekti:** Nuk janë ndërtuar manuale dhe workflow për institucionin e AKU e cila nuk mund të jetë pjesë e unifikimit të hapave inspektues sipas nenit 1 njoftim paraparak.

**Shkaku:** Unifikimi i hapave të inspektimit kërkon zhvillimin e një inspektimi nga fillimi në fund më të njëjtët pavarësisht institucionit inspektues.

**Rëndësia:** E lartë

**Rekomandimi 1:** IQ si institucioni përgjegjës për unifikimin e hapave të inspektimit në bashkëpunim me AKU të marrin masat e nevojshme për hartimin dhe miratimin e workflow, ndërsa AKSHI për hartimin e manualeve në përputhje me aktivitetin e AKU, sipas

përcaktimeve që bën ligji për kryerjen e inspektimeve pa njoftim paraprak, ashtu sikurse ndodh në sistemin e-inspektimi.

Nga auditimi mbi informatizimin e inspektimeve dhe të dhënat ndihmëse në mbështetje të procesit të inspektimit u konstatua se:

- *Inspektimet në PIK*, kanë mbetur jashtë sistemit të ndërtuar nga IQ sepse hapat që ndiqen në PIK nuk janë të njëjtë me formatet e inspektimit të zakonshëm dhe nuk është bërë i mundur ndërtimi e një procesi me hapat specifik për këtë lloj inspektimi. Bazuar në informacionin e marrë nga Inspektorati Qendror, ky institucion është duke punuar për hartimin e dokumentacionit të Inspektimit në PIK, për portalin Unik “e-inspektimi”.
- *Protokoll Arkiva*, nuk hedh të dhëna mbi dokumentet e protokolluara për çështjet e inspektimit, megjithëse është përcaktuar në rregulloren, neni 11, pika 13.a.
- *Burimet Njerëzore* nuk hedhin të dhëna në sistemin e-inspektimi për inspektorët, megjithëse këto detyra janë përcaktuar në rregullore neni 11, pikat 12.a, 12.b, 12.c, 12.d, 12.e.
- *Vendimet Administrative*. Ndjekja dhe plotësimi i të dhënave në lidhje me të gjitha shkallët e ankimit gjyqësor janë të dhëna që nuk regjistrohen në sistemin e-inspektimi edhe pse këto detyra janë përcaktuar në rregullore neni 11, pikat 10.a, 10.b, 10.c, 10.d
- *Ankesat e ndryshme që paraqiten në AKU*, nuk i bashkëngjiten praktikës së inspektimit dhe nuk regjistrohen në sistem për efekt kontrolli në inspektimet aktuale apo të së ardhmes.

**14. Titulli i Gjetjes:** AKU kryen inspektimet nëpërmjet procedurës e-inspektimi, por nuk ka respektuar urdhrin nr.432, datë 28.09.2016 të Inspektoratit Qendror për informatizimin e moduleve: *Protokoll Arkiva, Burimet Njerëzore, Vendimet Administrative*.

**Situata:** Nga auditimi mbi përdorimin e sistemit elektronik e-inspektimi u konstatua se, AKU ka vijuar aktivitetin jashtë sistemit informatik e-inspektimi për modulet *Protokoll Arkiva, Burimet Njerëzore, Vendimet Administrative*, në kundërshtim me rregulloren e miratuar me urdhrin nr.432, datë 28.09.2016, “Për disa shtesa dhe ndryshime në urdhrin nr.15, datë 07.05.2016 “Për miratimin e rregullave për përcaktimin e procedurave dhe mënyrave, për përdorimin e portalit unik të inspektimeve e-inspektimi”, në të cilin janë përcaktuar detyrimet për hedhjen e të dhënave në modulet Protokoll Arkiva, Burimet Njerëzore dhe Vendimet Administrative.

**Kriteri:** Neni 11 në rregulloren e miratuar me urdhrin nr.432, datë 28.09.2016, “Për disa shtesa dhe ndryshime në Urdhrin nr. 15, datë 07.05.2016 “Për miratimin e rregullave për përcaktimin e procedurave dhe mënyrave, për përdorimin e portalit unik të inspektimeve e-inspektimi”.

**Ndikim/Efekti:** Të dhëna të pa regjistruara në sistem, mungesë bashkëpunimi nga ana e AKU për informatizimin e të dhënave.

**Shkaku:** Mos zbatim i rregullores së miratuar me urdhrin nr.432, datë 28.09.2016, “Për disa shtesa dhe ndryshime në urdhrin nr.15, datë 07.05.2016 “Për miratimin e rregullave për përcaktimin e procedurave dhe mënyrave, për përdorimin e portalit unik të inspektimeve e-inspektimi”.

**Rëndësia:** E lartë

**Rekomandimi 1:** IQ të marrë masa për trajnimin e punonjësve të AKU për modulet që rezultojnë të pa informatizuar: *Protokoll Arkiva, Burimet Njerëzore, Vendimet Administrative*; në mënyrë që informatizimi për të dhënat në këto module të sistemit e-inspektimi, të fillojë sa më parë.

**Rekomandimi 2:** AKU të marrë masa që me përfundimin e trajnimit të punonjësve që kryejnë detyra në: *Protokoll Arkiva, Burimet Njerëzore, Vendimet Administrative*; të fillojnë hedhjen e të dhënave në sistemin e-inspektimi.

*Titullari i AKU znj. Jeta Dede, ka paraqitur observacion me shkresën nr.3411/3, datë 28.02.2022 protokolluar në KLSH me nr. 978/7 datë 28.02.2022, ku citohet:*

**Pretendimi:** Objeksione në lidhje me rekomandimin nr.16.1 në këtë raport 15.1: Ne vlerësojmë rekomandimin në kuptimin e automatizimit të proceseve Protokoll/Arkive, Burime Njerëzore, Vendime Administrative, por kontestojmë referencën e sistemit, pasi kjo ngurtëson marrdhëniet ndërfaqëse me të dhëna të sistemeve të tjera ose lë jashtë shërbime si ai laboratorik etj.

**Qëndrimi i grupit të auditimit:**

Sqarojmë se konstatimi dhe rekomandimi ynë do të qëndrojë për sa kohë janë aktet rregullative në fuqi dhe përcaktojnë detyrimin për informatizimin e këtyre moduleve. Grupi i auditimit nuk mund t'ju rekomandojë të mos respektoni rregulloret, aq më tepër kur këto rregullore nuk janë kundërshtuar nga ana e AKU-s.

*Për këtë arsye ky observacion nuk pranohet dhe mbetet i njëjtë në këtë raport auditimi.*

Për të realizuar misionin e saj, në mbështetje të kuadrit të përgjithshëm të misionit, pjesë e veprimtarisë së AKU-së është dhe rishikimi dhe vlerësimi i të dhënave në mënyrë periodike, ruajtja e integritetit të tyre, zhvillimi i standardeve për vlerësimin krahasues me qëllim përmirësimin e performancës si dhe raportime të ndryshme sipas grupeve të interesit. Kryerja e këtyre analizave kërkon të dhëna nga sistemi i inspektimit të cilat drejtorja e përgjithshme e AKU i mbledh në raportime manuale nga inspektorët dhe drejtoritë rajonale për arsye se nëpërmjet e-inspektimit nuk gjenerohen të dhëna në përputhje me kërkesat e raportimit që i nevojiten AKU.

**15. Titulli i Gjetjes:** Përmbledhja e të dhënave dhe raportimi i buletineve statistikore të AKU kryhet jashtë sistemit e-inspektimi, manualisht.

**Situata:** Nga auditimi mbi outputin e sistemit e-inspektimi u konstatua se, buletinet statistikore të inspektimeve të AKU popullohen manualisht dhe ruhen jashtë sistemit informatikë e-inspektimi. Të dhënat që buletinet përmbajnë, gjenden të regjistruara në sistemin e-inspektimi, por gjenerimi i raportimeve nga sistemi e-inspektimi nuk është bërë në përputhje me kërkesat funksionale të AKU. Kjo formë jo vetëm është një punë e dyfishtë për inspektorët që duhet të bëjnë raportimet jashtë sistemit, por rrit mundësinë për raportime jo të sakta. Mënyra e gjenerimit të të dhënave në trajtë raportesh nga sistemi e-inspektimi nuk mundëson modelet e raportimit që i nevojiten aktivitetit të AKU-s.

Nga auditimi u konstatua se AKU deri në këto momente, nuk ka arritur të përfitojë nga funksionaliteti i sistemit “e-inspektimi” përcaktuar në nenin 8/vi në rregulloren e miratuar nga IQ me urdhrin nr.432, datë 28.09.2016 “Për përcaktimin e procedurave dhe mënyrave për përdorimin e portalit unik të “e-inspektimit”” ku citohet se një nga funksionalitetet është “Përgatitja e raporteve periodike dhe vjetore në lidhje me veprimtarinë e inspektimit”.

**Kriteri:** Nenin 8/vi në rregulloren e miratuar nga IQ me urdhrin nr.432, datë 28.09.2016 “Për përcaktimin e procedurave dhe mënyrave për përdorimin e portalit unik të “e-inspektimit”” ku citohet se një nga funksionalitete është “Përgatitja e raporteve periodike dhe vjetore në lidhje me veprimtarinë e inspektimit”.

**Ndikim/Efekti:** Punë e dyfishtë për inspektorët dhe përpunuesit e informacionit për raportim si dhe mundësi për raportimeve jo të sakta.

**Shkaku:** Gjenerimi i raportimeve nuk është bërë në përputhje me kërkesat funksionale të AKU.

**Rëndësia:** E lartë

**Rekomandimi:** IQ në bashkëpunim me AKSHI-n, si intitucione administrues të sistemit e-inspektimi, ku AKSHI është njëkohësisht dhe ndjekës i kontratës së mirëmbajtjes të marrin masat për automatizimin e buletineve statistikore në sistemin informatik të inspektimit me

qëllim minimizimin e raportimeve manuale që kryejnë gjithë përdoruesit e Autoritetit Kombëtar të Ushqimit përfshirë dhe inspektorët.

*Agjencia Kombëtare e Shoqërisë së Informacionit, ka, ka paraqitur observacion me shkresën nr.7255/3, datë 25.02.2022 protokolluar në KLSH me nr. 978/9 datë 01.03.2022, ku citohet:*

**Pretendimi:** Objeksione në lidhje me rekomandimin nr. 16 në këtë raport: AKSHI shprehet se: sjellim në vëmendje se përmirësimi i sistemit të AKU nuk është dëshirë e AKSHI-t por është detyrim për t'u zbatuar kur lind nevoja. Zhvillim i procedurës së prokurimit nuk mund dhe nuk duhet të varet kurrësi nga një organizim i brendshëm i trupave të inspektimit. AKU nuk ka paraqitur asnjë kërkesë në lidhje me raportimin automatik të Buletineve Statistike. Theksojmë se edhe njëherë, se të gjitha kërkesat për përmirësimin e sistemit duhet të paraqiten pranë AKSHI-t nga institucioni që i administron të dhënat e sistemit të e-inspektimit.

**Qëndrimi i grupit të auditimit:**

Ju sqarojmë se buletinet statistikore kanë plot 3 vjet që punohen manualisht jashtë sistemit e-inspektimi. Pra, problemi ka aty për një kohë të gjatë dhe nuk e ka penguar mungesa e AKU-net. Drejtuesit e AKU-s nuk i kanë dhënë rëndësi problematikave që hasnin gjatë inspektimit. Raportimet e problematikave dhe zgjidhja e tyre janë përgjegjësi rast pas rasti e të tre institucioneve, që prej fillimit nëse problemi është kërkuar nga AKU të zgjidhet e deri tek ju si ndjekës i kontratës për të raportuar se çfarë është bërë në rastet që raportohet një problematikë. Situata është ashtu sic u konstatua nga auditimi, e në këto kushte më shumë rëndësi ka zgjidhja e saj, e cila varet plotësisht në dëshirën ndërmjet 3 institucioneve për bashkëpunim.

*Për sa më sipër, observacioni nuk merret në konsideratë, por riformulohet për të qartësuar për subjektin çfarë kërkohet me këtë rekomandim në këtë raport përfundimtar auditimi.*

*Nga auditimi mbi fazat dhe gjithë dokumentimin që mbahet gjatë inspektimit në terren u konstatua se, jo vetëm nuk janë informatizuar të gjitha të dhënat për modulet që ofrohen tek e-inspektimi, por dhe vetë procesi i inspektimit nuk përfundon në mënyrë elektronike në sistem, por jashtë tij hartohen dhe mirëmbahen dokumentacione fizike në lidhje me: asgjësimin, fletëshoqërimin për laborator si dhe faturën e arkëtimit për gjobën.*

**16. Titulli i Gjetjes:** Të dhënat historike të AKU nuk janë importuar në sistemin e-inspektimi si dhe inspektori nuk ka të drejtë të shohë të dhënat historike të subjektit që po inspekton.

**Situata:** Nga auditimi mbi historikun dhe aksesin në të dhëna u konstatua se, në sistemin e-inspektimi, AKU përballet me një papërshtatshmëri funksionale dhe operacionale. Nisur sa më sipër, nga auditimi u konstatua se:

- Mungojnë të dhënat me rekordet historike të AKU për periudhën 2012-2018 të cilat nuk janë importuar në sistemin e e-inspektimi si rekorde historike të inspektimeve përgjatë periudhës 2018 – 2021; Drejtoria qendrore e AKU disa herë i është drejtuar IQ për problematikën që ndeshin në sistemin e-inspektimi të cilat pengojnë aktivitetin e institucionit. Me anë të shkresës nr.1197, datë 05.03.2020 drejtoria qendrore i është drejtuar IQ përveç të tjerave dhe për importimin e të dhënave historike të AKU-net në sistemin e-inspektimi;

- Të dhënat e inspektimeve të ruajtura në bazën e të dhënave të IQ-së për periudhën 2018 e në vazhdim nuk janë të disponueshme për gjithë punonjësit që zhvillojnë analiza apo monitorime të inspektimeve të AKU-së me qëllim vlerësimin e riskut apo vlerësimin e performancës së inspektorëve të vet; Kjo çështje është trajtuar në detaje tek “*Siguria e të dhënave dhe përdoruesit e sistemit*”;

- Inspektori nuk ka të drejtë të shohë rezultatin e inspektimit të mëparshëm të zhvilluar në subjektin ku ai ndodhet nëse nuk ka qenë vetë ai për inspektim, duke e bërë të pamundur kontrollin për zbatimin e detyrave të lëna nga inspektimi i mëparshëm;

**Kriteri:** Të dhënat historike të institucionit.

**Ndikim/Efekti:** Aktiviteti institucional bazohet në të dhënat historike, me mungesën e tyre rrezikohet apo cenohet planifikimi dhe arritja e objektivave institucional.

**Shkaku:** Mirëmbajtja e sistemit dhe ndjekja kryhet nga AKSHI që prej vitit 2018, ndërkohë që AKU i është drejtuar IQ për problematika si dhe mungesën e të dhënave historike.

**Rëndësia:** E lartë

**Rekomandimi 1:** IQ dhe AKSHI si institucione administrues të sistemit e-inspektimi ku AKSHI njëkohësisht dhe ndjekës i kontratës së mirëmbajtjes të marrë masat për përmbushje nga ana e OE detyrimit për importimin e të dhënave historike të AKU në sistemin e-inspektimi për të siguruar në këtë mënyrë vazhdimësinë historike dhe të gjurmueshme të të dhënave inspektuese që janë kryer ndër vite.

**Rekomandimi 2:** IQ dhe AKSHI si institucione administrues të sistemit e-inspektimi ku AKSHI njëkohësisht dhe ndjekës i kontratës së mirëmbajtjes të kërkojnë përmbushjen nga OE, të drejtën për të parë në sistem rezultatin e inspektimit të mëparshëm të zhvilluar në subjektin nga çdo inspektor që është aktualisht për inspektim.

*Agjencia Kombëtare e Shoqërisë së Informacionit, ka, ka paraqitur observacion me shkresën nr.7255/3, datë 25.02.2022 protokolluar në KLSH me nr. 978/9 datë 01.03.2022, ku citohet:*

**Pretendimi:** Objeksione në lidhje me rekomandimin nr. 17 në këtë raport: AKSHI shprehet se: Migrimi i të dhënave në një sistem kërkohet nga institucioni administrues i tyre, në mënyrë që të analizohet mënyra e migrimit dhe të kryhet nga institucioni administrues i sistemit që është AKSHI. Në asnjë moment kjo kërkesë nuk ka ndodhur. Rrejdhimisht, rekomandimi është i pamundur të zbatohet nga AKSHI nëse nuk inicohet kërkesa nga institucioni administrues i të dhënave.

**Qëndrimi i grupit të auditimit:**

Ju sqarojmë se drejtoria qendrore e AKU disa herë i është drejtuar IQ për problematikat që ndeshin në sistemin e-inspektimi të cilat pengojnë aktivitetin e institucionit. Me anë të shkresës nr.1197, datë 05.03.2020 drejtoria qendrore i është drejtuar IQ përveç të tjerave dhe për importimin e të dhënave historike të AKU-net në sistemin e-inspektimi. Ashtu sic edhe kuptohet AKU punon në kushte të paqarta përgjegjësie për administrimin e të dhënave që konstatoam se rrjedh prej mbivendosjes së të drejtës administrative të sistemit e-inspektimi për të cilin ju duhet të merrni masat e nevojshme në një rekomandim përmendur më sipër nga grupi i auditimit.

*Për sa më sipër, observacioni nuk merret në konsideratë pasi nuk kundërshton problemin për këtë arsye nuk ka asnjë ndryshim për këtë gjetje, ndërsa është shtuar tek rekomandimi dhe IQ si administrator sistemi, ndryshimet pasqyrohen në këtë raport përfundimtar auditimi.*

*Gjurma e auditimit ose Audit log.* Për aksesimin e aplikacionit në web ruhet një numër i caktuar e cila varet nga trafiku dhe hapësira në server. Në bazën e të dhënave të ruhen të dhëna në bazë të kapacitetit dhe kohës, ku nga verifikimi ynë rezultoi se janë të tre muajve të fundit. Këto gjurmë auditimi i shërbejnë më shumë zhvilluesve të sistemit se sa administratorëve të sistemit IQ dhe AKSHI-t, pasi në këto gjurmë (audit log) nuk ruhen informacione për investigime në rast të ndërhyrjeve në të dhëna, duke e ekspozuar sistemin ndaj një risku të lartë për sigurinë e të dhënave.

Në bazën e të dhënave të sistemit e-inspektimi ruhen vetëm lloji i veprimit si Insert, Update, Delete. Në rastet e ndryshimit të të dhënave nuk ruhen gjurmë mbi të dhënat e ndryshuara si ishte dhe si u bë, çfarë e bën të pamundur investigimin mbi të dhëna që mund të ndryshojnë gabimisht apo qëllimisht.

**17. Titulli i Gjetjes:** Mungon gjurma elektronike e auditimit (audit log) sipas përcaktimeve të rregullores për menaxhimin e log-eve digjitale, miratuar me urdhrin nr.109 datë 10.06.2016 të Drejtorit të Agjencisë Kombëtare për Sigurinë Kompjuterike (ALCIRT).

**Situata:** Nga auditimi mbi gjurmën e auditimit (audit log) u konstatua se, për sistemin e-inspektimi mungon gjurma elektronike e auditimit (audit log) sipas përcaktimeve të rregullores për menaxhimin e log-eve digjitale miratuar me urdhrin nr.109 datë 10.06.2016 të Drejtorit të Agjencisë Kombëtare për Sigurinë Kompjuterike (ALCIRT).

**Kriteri:** Urdhri nr.109 datë 10.06.2016 i Drejtorit të Agjencisë Kombëtare për Sigurinë Kompjuterike (ALCIRT).

**Ndikim/Efekti:** Pamundësi për të identifikuar ndërhyrjet në sistem nga përdoruesit e sistemit.

**Shkaku:** Udhëzimi është ndërtuar më vonë se sa ndërtimi i aplikacionit. Nuk janë kërkuar zhvillime të sistemit në këtë drejtim.

**Rëndësia:** E lartë

**Rekomandimi:** IQ me ndryshimet në strukturën e saj, të fillojë sa më shpejt marrjen e masave për identifikimin e të dhënave që nevojiten të ruhen për garantimin e gjurmës elektronike sic parashikojnë udhëzimet dhe t'i delegojë këto kërkesa tek ndjekësit e kontratës që është AKSHI. Nëëprmet sigurimit të kësaj gjurme investigimi mbi të dhënat e ndryshuara apo të fshira do të jetë më i lehtë për institucionin i cili do të mbajë përgjegjësinë e administrimit të këtyre të dhënave.

**Rekomandimi:** AKSHI të marrë masat në lidhje me sigurimin nga ana teknike të ruajtjes së gjurmës elektronike e cila do të ketë për qëllim sigurimin e investigimit të detajuar të veprimeve që ndodhin në sistemin e-inspektimi nga përdoruesit e tij.

*Agjencia Kombëtare e Shoqërisë së Informacionit, ka , ka paraqitur observacion me shkresën nr.7255/3, datë 25.02.2022 protokolluar në KLSH me nr. 978/9 datë 01.03.2022, ku citohet*

**Pretendimi:** Objeksione në lidhje me rekomandimin nr. 18 në këtë raport: AKSHI shprehet se: Sistemi e-inspektimi nuk përdoret nga AKSHI, por nga AKU dhe IQ, çfarë nënkupton që të dhënat që hidhen apo që fshihen janë përgjegjësi e përdoruesve të AKU dhe të IQ.

**Qëndrimi i grupit të auditimit:**

Ju sqarojmë se nuk është kuptuar nga ana juaj se tjetër është çështja e gjenerimit të gjurmës elektronike të auditimit dhe tjetër është krijimi i kushteve teknike që kjo gjurmë të ruhet. Si administrator të sistemit ju duhet të ofroni kushtet teknike që kjo gjurmë të ruhet, ndërsa se çfare do të ruhet e përcakton institucioni administrues i të dhënave që është IQ.

*Për sa më sipër, observacioni merret në konsideratë vetëm për formulimin ose qartësimin e rekomandimeve, pasqyruar në këtë raport përfundimtar auditimi.*

*Drejtoritë Rajonale kanë informuar AKU e cila po ashtu ka informuar IQ se gjatë përdorimit të portalit hasin këto vështirësi:*

- Hapja e autorizimit shfaqet pa numër;
- Portali e-inspektimi nuk logohet dot, shfaqet faqe blu me mesazh për pozicion, ndërkohë që GPS është i hapur;
- Gjatë logimit në adresën e inspektorit ose gjatë hedhjes së procedurës ndodh mos funksionimi i sistemit për shkak të mos njohjes së pozicionit gjeografik dhe GPS;
- Në momentin e ruajtjes së listë verifikimit ose proces verbalit aplikacioni i hapur në tablete të kthen në faqen fillestare dhe inspektorët janë detyruar ta plotësojnë procedurën nga fillimi, duke marrë shumë kohë në orarin e inspektimit në subjekt;
- Mungesë e plotë e internetit në shumë vendndodhje biznesesh. Hedhja e praktikave nuk kryhet direkt në subjekt arsye se jo të gjithë subjektet kanë wi-fi;
- Spostim faqesh gjatë momentit të hapjes dhe plotësimit të listë-verifikimit në momentin e plotësimit të çështjes;

- Mungesë në numër të tabletave dhe zëvendësim të atyre ekzistuese;
- Vështirësi të ngarkimit të fotove dhe videove të procedurës së Inspektimit;
- Ndodh që sistemi merr automatikisht dhe gabimisht datën e hapjes dhe mbylljes të proces verbalit;
- Gjatë hedhjes së procedurës së inspektimit kalimi nga njëra adresë e një inspektori në adresën e inspektorit tjetër;
- Gjatë plotësimit online ndodh mbyllja e faqes së E-Inspektimit;

*Nga auditimi mbi raportimin e të dhënave të sistemit u konstatua se:*

- Nga sistemi e-inspektimi nuk është e mundur marrja në kohë reale e të dhënave apo informacionit për indikatorë të veçantë në rang qarku apo në rang kombëtarë.

Në rastet kur janë marrë masa administrative apo marrje mostre duhet të hapet çdo praktikë inspektimi më vete për të marrë informacion të detajuar, por nuk ka asnjë mënyrë të gjenerimit të këtyre të dhënave nëpërmjet raporteve me kriterë specifike.

Për ndjekjen e kësaj procedure si në drejtorinë rajonale ashtu dhe në drejtorinë e përgjithshme punonjësit e AKU regjistrojnë gjithë të dhënat në mënyrë manuale në tabela excel për të dhënat që kërkohen si në Drejtorinë e Përgjithshme ashtu dhe për të dhënat e kërkuara nga MBZHR.

- Gjenerimi i të dhënave statistikore eksportohet në excel për analiza të mëtejshme, por kërkon ndërhyrje për rregullimin e formatit pasi dalin rreshtat e përsëritur të të dhënave. Totali përsëritet gjithashtu në dy rreshta. Dhe raportet më të thjeshta kanë nevojë për ndërhyrje manuale pas eksportimit në excel, çfarë tregon se nuk janë lehtësuar punonjësit nga veprimet manuale edhe pse janë duke punuar me një sistem informatik.

*Nga auditimi mbi plotësinë dhe raportimin e të dhënave u konstatua se:*

- *Totali i Inspektimeve vjetore/mujore*- përsëriten rreshtat në dy për çdo degë inspektorati të zgjedhur nga lista, gjithashtu totali është përsëritur. Kjo tregon se raporti nuk është ndërtuar në formatin që kërkon me pak punë nga përdoruesi.

- *Lista e Inspektorëve* - Çdo inspektor mund dhe duhet të punojë nëpërmjet sistemit, por shumë të dhëna për këta inspektorë nga auditimi u konstatua se, nuk regjistrohen në sistem dhe nuk administrohen nëpërmjet tij. Këto të dhëna që mungojnë i përkasin kolonave me emërtim: Periudhë prove, Ka dhënë provim, Rezultati i provimit, Data e dhënies së provimit, i certifikuar, Fillimi i certifikimit, Përfundimi i certifikimit, Performanca, Datë mbyllje apo ç ‘aktivizim të përdoruesit.

Në sistemin e-inspektimi, AKU aktualisht nuk është bërë e mundur gjenerimi i të dhënave në trajtë raportesh për inspektimin online në lidhje me:

- Inspektimet që janë kryer apo në proces në çdo OBU (historiku i inspektimeve);
- Inspektimet në të gjithë vendin;
- Inspektimet me data në të gjithë vendin;
- Raporte me fjalë kyçe si “Prodhim përpunim qumështi” apo “Drejtuesi Teknik”, etj.;
- Nuk janë vendosur të dhëna të detyrueshme në listat e kontrollit, apo të ndërtohen raporte për fushat me rendësi në një listë kontrolli si p.sh. “Drejtuesi Teknik”, një kriter i domosdoshëm për monitorimin e dy punësimit për drejtuesit teknik për shkak të pamundësisë së tij në të qenit prezent në dy operator biznesi ushqimor në të njëjtën kohë.
- Raportet e gjeneruara në sistemin e-inspektimi janë të kufizuara për kriteret e inspektimit, që do të thotë se për të parë detaje apo të dhëna të veçanta të inspektimeve përdoruesi duhet të shohë rekordet e inspektimit një nga një, njëjtë sikur të ishte në dosje fizike edhe pse të dhënat ndodhen në një sistem informatik.

**18. Titulli i Gjetjes:** Të dhënat output të sistemit e-inspektimi që nuk gjenerohen sipas nevojës së AKU-s.

**Situata:** Nga auditimi i të dhënave output që gjenerohen nëpërmjet sistemit e-inspektimi u konstatua se:

- Nuk është e mundur marrja në kohë reale e të dhënave për indikatorë të veçantë në rang qarku apo në rang kombëtarë;
- Gjenerimi i të dhënave statistikore eksportohet në excel për analiza dhe formatime të mëtejshme, pasi dalin rreshtat e përsëritur të të dhënave;
- Për inspektorët nuk mbahen të dhëna për: Periudhë prove, Ka dhënë provim, Rezultati i provimit, Data e dhënies së provimit, i certifikuar, Fillimi i certifikimit, Përfundimi i certifikimit, Performanca, Datë mbyllje apo ç ‘aktivizim të përdoruesit;
- Nuk gjenerohen të dhëna në trajtë raportesh për inspektimin online në lidhje me Inspektimet që janë kryer apo në proces në çdo Operator Biznesi Ushqimor - OBU (historiku i inspektimeve), Inspektimet në të gjithë vendin, Inspektimet me data në të gjithë vendin;
- Nuk gjenerohen të dhëna në trajtë raportesh me fjalë kyçe si “*Prodhim përpunim qumështi*” apo “*Drejtuesi Teknik*”, etj.;
- Nuk janë bërë të dhëna të detyrueshme “*mandatory field*”, ku plotësimi i tyre të mos lejojë kalimin në një fazë tjetër.

**Kriteri:** Veprimtaria dhe aktiviteti raportues i AKU si dhe neni 8/vi në rregulloren e miratuar nga IQ me urdhrin nr.432, datë 28.09.2016 “Për përcaktimin e procedurave dhe mënyrave për përdorimin e portalit unik të e-inspektimit”, ku citohet se një nga funksionalitetet është “*Përgatitja e raporteve periodike dhe vjetore në lidhje me veprimtarinë e inspektimit*”.

**Ndikim/Efekti:** Punë manuale për mbledhjen e të dhënave, të dhëna të raportuara dhe ruajtura jashtë sistemit, mundësi për të dhëna jo të sakta.

**Shkaku:** Mungesa e raporteve në sistem sipas kërkesave dhe aktivitetit të institucionit AKU.

**Rëndësia:** E lartë

**Rekomandimi 1:** AKSHI si institucion administrues i sistemit e-inspektimi dhe njëkohësisht ndjekës i kontratës së mirëmbajtjes, të marrë masat për ndërtimin e raporteve në sistemin e-inspektimi, me qëllim ofrimin e kushteve të raportimit që i nevojiten aktivitetit të AKU-s.

**Rekomandimi 2:** AKSHI si institucion administrues i sistemit e-inspektimi dhe njëkohësisht ndjekës i kontratës së mirëmbajtjes, në bashkëpunim me IQ dhe AKU të identifikojë të dhënat e detyrueshme të listë kontrollit, për vendosjen e tyre duke i parametrizuar ato të detyrueshme dhe në sistem.

*Agjencia Kombëtare e Shoqërisë së Informacionit, ka , ka paraqitur observacion me shkresën nr.7255/3, datë 25.02.2022 protokolluar në KLSH me nr. 978/9 datë 01.03.2022, ku citohet*

**Pretendimi:** Objeksione në lidhje me rekomandimin nr. 19 në këtë raport: AKSHI shprehet se: ....IQ dhe AKU duhet të bashkëpunojnë me njëra tjetrën.. si dhe të sqarojnë se çfarë raportesh ofron ky sistem që të analizojmë kërkesat për përmirësim...

**Qëndrimi i grupit të auditimit:**

Ju sqarojmë se, si administrator i sistemit e-inspektimi nuk mund të mos jeni në dijeni çfarë ofron sistemi, në çdo drejtim të tij. Ne audituam vetëm AKU, por nuk kemi audituar institucione të tjera inspektuese për të parë se çfarë problematikash kanë në këtë sistem. Ju si administrator duhet të jeni në dijeni për çdo problem që raportohet nga çdo inspektoriat, në të kundërt administrimi është një proces formal. Sistemi gjeneron raporte pasi na u prezantuan nga specialistët e AKSHI-t tek IQ, por jo ato raporte që i nevojiten AKU-s të cilat i kemi përmendur më sipër, të cilat AKU i ka kërkuar vazhdimisht, besoj problematika qëndron dhe në inspektoriate të tjerë. Ndërtimi i raporteve është detyrë e mirëmbajtjes sa kohë e keni përmendur se jeni dhe i vetmi administrator i sistemit e-inspektimi.

*Për sa më sipër, observacioni nuk merret në konsideratë, në këtë raport përfundimtar auditimi.*

Grupi i auditimit kreu dy verifikime inspektim në terren në të cilët aplikoheshin lista kontrolli të ndryshme me qëllim identifikimin e problematikave.

Nga auditimi dhe monitorimi në terren mbi përdorimin e sistemit informatik e-inspektimi nga inspektorët e AKU u konstatuan disa mangësi të cilat renditen mëposhtë:

- Punonjësit logohen në sistem me pajisjet tabletë duke u lidhur me internetin e celularit personal. Në të dy rastet e monitorimit nga audituesit u shfrytëzuan pajisje personale për plotësimin e inspektimit online. Për ruajtjen e rekordeve përdoruesit që janë inspektorët shtypin “Save” herë pas here, ku për shkaqe të ndërprerjes së internetit apo difekteve në “Touch” të pajisjeve, ju duhet të përsëritin hedhjen e të dhënave sepse nuk janë ruajtur dhe duhet të riksuesojnë përsëri sistemin.
- Në çështjet që i përkasin kategorizimit “Plane monitorimi”, monitorime të cilat mund të zhvillohen në kohë të ndryshme, nga arsye të ndryshme dhe më kërkesa të pakufizuara, sistemi nuk të jep mundësinë e plotësimin të urdhrit apo vendimit mbi të cilin po bëhet ky monitorim duke lënë pa informacion këto rekorde të rëndësishme.
- Në sistem nuk janë aplikuar kritere për verifikimin e licencimit të veprimtarisë së subjektit, pra inspektorit nuk i del në mënyrë automatike nëpërmjet sistemit nëse subjekti në të cilin ai ndodhet për inspektim duhet të jetë i pajisur me licencë apo jo. Kjo do të thotë se kritere përzgjedhëse kategorizuese në sistem nuk janë plotësuar dhe mbetet në vlerësimin e inspektorit nëse subjekti nën inspektim nëse nuk e ka licencën është në shkelje apo jo.
- Listat e kontrollit janë hartuar me opsionet “Po” dhe “Jo”, pra nëse plotësohet me “Jo” nga inspektori atëherë subjektit i përlogaritet një gjobë, ndërkohë që kjo kërkesë mund të mos jetë e aplikueshme në këtë subjekt për shkak të madhësisë apo xhiros vjetore, apo dhe arsye të tjera të argumentuara. Kjo formë e listave të kontrollit i jep mundësinë inspektorit që plotësimin e kësaj kërkesë ta formalizojë me përgjigjen “Po” edhe pse nuk aplikohet në këtë subjekt. Opsioni “*Nuk aplikohet*” mungon në listë kontrollet e përpunimit të qumështit, tregtim peshku, thertore etj., pothuajse në të gjitha rastet. Vetëm në listën e kontrollit për përpunimin e mishit është konsideruar dhe vendosur opsioni “*Nuk aplikohet*”.
- Në listë kontrollin e thertoreve kërkesat 2.1.2 si dhe 3.1.2 duhet të jenë përmbledhje e kritereve mëposhtë dhe jo pikë kontrolli, pasi nën këto dy çështje janë vendosur zgjedhjet “Po” dhe “Jo”.

**19. Titulli i Gjetjes:** Inspektorët e AKU si përdorues të sistemit informatik e-inspektimi hasin gjatë përdorimit të këtij sistemi në disa vështirësi apo mangësi që u konstatuan nga auditimi.

**Situata:** Nga auditimi dhe monitorimi në terren mbi përdorimin e sistemit informatik e-inspektimi nga inspektorët e AKU u konstatuan disa mangësi të cilat renditen si më poshtë:

- Punonjësit logohen në sistem me pajisjet tabletë duke u lidhur me internetin e celularit personal. Në të dy rastet e monitorimit nga audituesit u shfrytëzuan pajisje personale për plotësimin e inspektimit online. Për ruajtjen e rekordeve përdoruesit që janë inspektorët shtypin “Save” herë pas here, ku për shkaqe të ndërprerjes së internetit apo difekteve në “Touch” të pajisjeve, ju duhet të përsëritin hedhjen e të dhënave sepse nuk janë ruajtur dhe duhet të riksuesojnë përsëri sistemin.
- Sistemi nuk të jep mundësinë e plotësimin të urdhrit apo vendimit mbi të cilin po bëhet plani i monitorimit, monitorime këto të cilat mund të zhvillohen në kohë të ndryshme, nga arsye të ndryshme dhe me kërkesa të pakufizuara;
- Opsioni “*Nuk aplikohet*” mungon në pothuajse të gjitha listë kontrollet si përpunimi i qumështit, tregtim peshku, thertore etj.;

**Kriteri:** Veprimtaria inspektuese e realizuar nëpërmjet sistemit e-inspektimi.

**Ndikim/Efekti:** Të dhëna të paplota, plotësime fiktive, vështirësi të realizimit të detyrave inspektuese.

**Shkak:** Mungesa e internetit në pajisjet tablet, problematika në këto pajisje, mos dhënia rëndësi e problematikave që hasin përdoruesit në sistem.

**Rëndësia:** E lartë

**Rekomandimi 1:** AKU në bashkëpunim me IQ të marrin masat, për sigurimin e internetit dhe riparimin apo zëvendësimin e pajisjeve tablet të inspektorëve të AKU në mënyrë që inspektorët të kryejnë në mënyrë të sigurtë dhe pa ndërprerje detyrat inspektuese në terren.

**Rekomandimi 2:** IQ në bashkëpunim me AKSHI-n si institucione administrues të sistemit e-inspektimi, ku AKSHI është njëkohësisht dhe ndjekës i kontratës së mirëmbajtjes të marrin masat për evidentimin e të gjithë fushave në listat e kontrollit që nuk është vendosur opsioni “Nuk aplikohet”. Nëse kjo është kërkuar, por nuk është realizuar nga OE, atëherë të përlllogariten penalitete mbi vlerën e mirëmbajtjes, në përputhje me kohën që kur kjo kërkesë apo dakordësim është marrë nga OE.

*Agjencia Kombëtare e Shoqërisë së Informacionit, ka, ka paraqitur observacion me shkresën nr.7255/3, datë 25.02.2022 protokolluar në KLSH me nr. 978/9 datë 01.03.2022, ku citohet*

**Pretendimi:** Objeksione në lidhje me rekomandimin nr. 20 në këtë raport: AKSHI shprehet se: ...institucionet janë përgjegjëse për prokurimet me vlerë të vogël dikur 800,000 lekë sot 1,000,000 lekë. Nëse institucionet duan që këtë procedurë ta zhvillojë AKSHI duhet të depozitojnë një kërkesë për këtë qëllim pranë tij...

**Qëndrimi i grupit të auditimit:**

Ju sqarojmë se në gjykimin e grupit të auditimit nëse do të konsiderohej zgjidhja e problemit për gjithë inspektoriatet atëherë nuk dihej nëse do të realizohet kjo procedurë me vlerë të vogël sepse grupi nuk ka dijeni se sa tablete disponojnë institucionet e tjera inspektuese. *Megjithatë ky observacion është marrë në konsideratë nga ana jonë dhe është pasqyruar në këtë raport përfundimtar auditimi në mënyrë që AKU të gjejë zgjidhjen.*

**20. Titulli i Gjetjes:** Problematika të identifikuar nga testimi në sistemin e-inspektimi.

**Situata:** Nga auditimi mbi përdorimin e sistemit informatik e-inspektimi dhe hyrjen e të dhënave gjatë inspektimeve nëpërmjet sistemit e-inspektimi u konstatuan disa mangësi, konkretisht:

- AKU nuk informohet në mënyrë periodike në asnjë formë nga QKB për subjektet e hapura kohët e fundit të cilët kanë veprimtari me objekt inspektimi nga AKU. E njëjta situatë është edhe për subjektet që kanë mbyllur veprimtarinë, të cilët AKU i ka planifikuar për inspektim si rezultat i mungesës së informacionit.
- Me zgjedhjen e llojit të inspektimit nuk është bërë e mundur nëpërmjet sistemit inspektorët të zgjidhen nga lista e sektorit që do të kryejë atë lloj inspektimi, duke marrë në konsideratë kualifikimin e tyre dhe sektorin në të cilin ndodhen, çfarë do të garantonte që për çdo inspektim janë zgjedhur inspektorët e lejuar për ta kryer.
- Në listat e kontrollit ka kërkesa të cilat kontrollohen dhe nga institucione të tjera inspektuese si p.sh: largimi i mbetjeve, ujërave të ndotura etj., të cilat vetë subjektet u shprehën se kontrollohen dhe nga inspektorati i mjedisit.
- Në sistemin e-inspektimi nuk rezulton të jetë implementuar procedura e asgjësimit së bashku me procesverbalin përkatës, por ky proces ndiqet jashtë sistemit edhe pse ai është i rëndësishëm po aq sa inspektimi.
- Në listat e kontrollit në sistem nuk është aplikuar në asnjë rast plotësim me zgjedhje nga një numër mundësish që mund të mirëmbahet lehtësisht në sistem, duke ndikuar sadopak në kohë që nevojitet për plotësimin e listë kontrollit në subjekt.
- Në listat e kontrollit ka përsëritje të fushave që do të thotë se do të ketë plotësime me informacion përsëritës, duke rritur në këtë mënyrë fiktivisht kohën e plotësimit si p.r.sh.

drejtuesi teknik është një nga fushat të cilat plotësohet dy herë nga inspektori, por kjo nuk është e vetmja.

- Në krijimin e çështjeve gjatë përzgjedhjes së aktivitetit nuk janë të gjitha kategoritë e aktiviteteve, por nga AKU nuk janë kërkuar shtime të aktiviteteve të tjera të nevojshme.
- Lista e Qendrës së Depurimit të Midhjes nuk të lejon aksesimin e gjenerimit në sistem me firmën Digjitale, por punohet nëpërmjet versionit web të aplikacionit.

**Kriteri:** Veprimtaria inspektuese e realizuar nëpërmjet sistemit e-inspektimi

**Ndikim/Efekti:**

**Shkaku:** Vonesa e përgjigjes së laboratorëve në rrezik konsumatorët, por njëkohësisht arritjen e objektivave të AKU.

**Rëndësia:** E lartë

**Rekomandimi 1:** IQ me bashkëpunimin e AKU-s, pas përfundimit të regjistrimit të dhënave shtetërore, të hartojë dhe delegojë tek AKSHI kërkesën për ndërveprim me të dhënat e regjistrit të biznesit në QKB, për shkëmbimin e informacionit mbi subjektet e hapura dhe të mbyllura në mënyrë periodike, me qëllim lehtësimin e planifikimit inspektues. Ky ndërveprim do të shërbejë jo vetëm AKU por gjithë inspektoriateve.

**Rekomandimi 2:** IQ në bashkëpunim me AKU-n të identifikojnë nevojat për përmirësim të sistemit e-inspektimi që kanë të bëjnë me procese të inspektimit, mbetur jashtë sistemit si procedura e asgjësimit prej fillimit deri në procesverbalin përkatës.

**Rekomandimi 3:** IQ të identifikojë të dhënat inspektuese që përsëriten nga inspektorate të tjerë dhe që janë njëkohësisht në listë kontrollet e AKU, me qëllim eliminimin e kontrolleve të dyfishta në subjektet që inspektohen.

**Rekomandimi 4:** AKSHI si institucion administrues i sistemit e-inspektimi dhe njëkohësisht ndjekës i kontratës së mirëmbajtjes, por dhe administrues i sistemit të QKB, me përfundimin e regjistrimit të bazave të të dhënave shtetërore, të marrë masa për realizimin e ndërveprimit ndërmjet sistemit e-inspektimi dhe sistemit të QKB, për shkëmbimin e informacionit mbi subjektet e hapura dhe të mbyllura në mënyrë periodike çfarë do të ndihmonte AKU-n në hartimin e planeve të inspektimit. Gjithashtu, të vlerësojë dhe gjejë zgjidhjet teknike për kërkesat që vijnë prej IQ dhe AKU të cilat i shërbejnë punës së tyre inspektuese.

*Agjencia Kombëtare e Shoqërisë së Informacionit, ka, ka paraqitur observacion me shkresën nr.7255/3, datë 25.02.2022 protokolluar në KLSH me nr. 978/9 datë 01.03.2022, ku citohet*

**Pretendimi:** Objeksione në lidhje me rekomandimin nr. 21 në këtë raport: AKSHI shprehet se: ...IQ duhet të kërkojë ndërveprimin me të dhënat e cituara nga ana juaj me qëllim që AKSHI të vijojë me implementimin e ndërveprimit. Rrjedhimisht rekomandimi duhet të jetë për IQ dhe jo për AKSHI-n. ...mënyra dhe përdorimi i sistemit si dhe përzgjedhja e inspektorëve nuk është detyrë apo përgjegjësi e AKSHI-t....

Gjithashtu, AKSHI shprehet se “... i ka identifikuar nevojat që i nevojiten AKU, ndërsa për sistemin e-inspektimi duhet ti bëjë IQ..”

**Qëndrimi i grupit të auditimit:**

Ju sqarojmë se meqënëse keni nevojë për një dokument kërkesë për çdo shërbim që ofroni, ky rekomandim do të ndahet çfarë duhet të bëjë IQ dhe çfarë duhet të bëjë AKSHI. Rekomandimet tona kanë për qëllim të propozojnë zgjidhjen e situatave të cilat kemi konstatuar dhe kanë ardhur si rezultat i mungesës së bashkëpunimit çfarë e kemi shprehur dhe në opinionin tonë të auditimit dhe jo për ta kthyer procesin në një komunikim formal. Sqarojmë gjithashtu se rekomandimet të cilat i drejtoheshin për zbatim institucionit tuaj, bazuar në faktin se jeni ndjekës i kontratës së mirëmbajtjes, pra zbatimi i kësaj kërkesë mund dhe duhet të bëhet nga ju ashtu sic parashikohet në VKM nr.673, në katalogun e shërbimeve emërtuar Software/Hardware.

Sqarojmë se, AKU inspektimet i kryen nëpërmjet sistemit e-inspektimi që prej 2018, dhe nuk i takon institucionit tuaj t'i thotë se cili i shërben dhe cili nuk i shërben sa kohë ata vetë nuk e bëjnë.

Në pothuajse të gjitha rastet nuk observoni situatën që ne si auditues kemi konstatuar, por angazhimi juaj është fokusuar tek përgjegjësia apo zbatimi i rekomandimit. Për këtë arsye rekomandimet mund të jenë riformuluar për të ndarë pjesën e përgjegjësive që ju si intitucione nuk e ndani dot duke bashkëpunuar.

*Megjithatë ky observacion është marrë pjesërisht në konisderatë duke bërë riformulim dhe ndarje të përcaktuar të detyrave që kërkohet të kryhen nga ju apo IQ/AKU, pasqyruar në këtë raport përfundimtar auditimi.*

**21. Titulli i Gjetjes:** Mbyllja e rekordeve të inspektimit në sistem në rastet kur është marrë mostër për analizim, por nuk ka një përgjigje të rezultatit të analizave.

**Situata:** Nga auditimi i hapave që ndjekin inspektorët në terren u konstatua se, rekordi i inspektimit mbyllet me gjenerimin e procesverbalit përfundimtar edhe në rastet kur në subjekt është marrë një mostër dhe përgjigja e saj kërkon një afat që është përcaktuar në aktet ligjore. Në rastet kur analiza mund të rezultojë me ngarkesë bakteriale apo mikrobiologjike, në sistem krijohet një autorizim i ri duke humbur kështu gjurmën me rekordin e inspektimit që ndodhet në sistem regjistruar nga inspektorët të cilët kanë kërkuar kryerjen e një analize laboratorike. Mbyllja e rekordeve kryhet në të gjitha rastet, nisur nga fakti se përgjigjet laboratorike nuk kthehen brenda afateve, dhe masat e marra në vazhdimësi të këtij inspektimi të kryer janë në kundërshtim me aktet ligjore, duke detyruar kështu krijimin e një tjetër inspektimi, por këtë herë bazuar në rezultatin e mostrës. Vonesa e përgjigjes së laboratorëve vë në rrezik konsumatorët, por njëkohësisht arritjen e objektivave të Autoritetit Kombëtar të Ushqimit.

**Kriteri:** Veprimtaria inspektuese e realizuar nëpërmjet sistemit e-inspektimi

**Ndikim/Efekti:** Produkte të konsumuara në popullatë apo në mbrojtjen e bimëve dhe inpueteve bujqësore për shkak të vonesës së përgjigjes laboratorike.

**Shkaku:** Vonesa e përgjigjes së laboratorëve vë në rrezik konsumatorët, njëkohësisht arritjen e objektivave të AKU.

**Rëndësia:** E lartë

**Rekomandimi 1:** AKU dhe IQ të marrin masa të menjëhershme në ndryshimin e hapave inspektues duke mos lejuar mbylljen e rekordeve inspektuese në sistem përpara afatit që përcakton ligji për marrjen e përgjigjes nga laboratorit për analizimin e mostrës.

Në rastet kur afati ligjor i dërgimit të përgjigjes nga laboratorit është tejkaluar, rekordi mund të mbyllet automatikisht nga sistemi, meqenëse çdo masë ndaj subjektit do të përbënte një kundërvajtje ligjore nga ana e AKU-s.

*Titullari i AKU znj. Jeta Dede, ka paraqitur observacion me shkresën nr.3411/3, datë 28.02.2022 protokolluar në KLSH me nr. 978/7 datë 28.02.2022, ku citohet:*

**Pretendimi:** Objeksione në lidhje me rekomandimin nr.22.2 në këtë raport: Vonesat e përgjigjeve laboratorike nuk janë pjesë e AKU-s, por për secilën prej tyre ka metodologji të cilat evidentojnë edhe kohën e nevojshme të kryerjes së analizave. Angazhohemi që të ushtrojmë presionin e nevojshëm për uljen e kohës së kryerjes së analizave me laboratorët vecanërisht vendas por edhe jashtë vendit.

**Qëndrimi i grupit të auditimit:**

Ky rekomandim nuk do të ndryshonte situatën mbi kohën e përgjigjeve laboratorike për të cilat dhe vetë ju jeni në dijeni se kjo nuk varet nga ju por ndikojnë në aktivitetin tuaj.

Ajo që ne insistojmë është rekomandimi nr.1 nën këtë gjetje. Ndryshimi i hapave inspektues për mos lejimin e mbylljes së rekordeve inspektuese në sistem përpara afatit që përcakton ligji për marrjen e përgjigjes nga laboratorit për analizimin e mostrës, do t'ju detyrojë automatikisht

të intensifikoni kërkesat ndaj laboratorëve. Për këtë arsye, rekomandimi nr.2 do të hiqet pasi vlerësojmë se ai do të përmbushet brenda rekomandimit nr.1.

Tek përdoruesi i loguar në e-inspektimi renditen 3 opsione: Profili im, Dil dhe Log-ohu si përdorues tjetër, siç duket dhe në figurën më poshtë.

**Figura 3: Opsionet tek përdoruesi**

About Me
Dil
Logohu si përdorues tjetër

“About me” është opsioni ku përdoruesi mund të shikojë të dhënat e profilit të tij si pozicioni, por mund të ndryshojë dhe fjalëkalimin.

“Dil” është opsioni kur përdoruesi kërkon të dalë nga sistemi si një mënyrë sigurie që të mos hyjë dikush tjetër pa dijeninë e tij.

Log-ohu si përdorues tjetër është opsioni ku duke përdorur të njëjtën pajisje mund të logohet një punonjës tjetër.

**22. Titulli i Gjetjes:** Në opsionet e vetë administrimit të përdoruesit nuk ofrohen elementët më bazikë të sigurisë nga përdoruesit duke cenuar sigurinë dhe mbrojtjen nga veprimet e paautorizuara në këtë sistem.

**Situata:** Gjatë auditimit, nëpërmjet testimeve të sistemit, u konstatua se:

- Në opsionin “About me” shfaqet error që tregon se nuk kemi asnjë mundësi të kryejmë veprime si ndryshimi i fjalëkalimit në kundërshtim me rregulloren që përcakton se ky veprim mund të kryhet nga përdoruesi sipas nenit 10, pika 3 ku citohet se “Portali ofron për çdo përdorues mundësinë e ndryshimit në çdo moment kohe të fjalëkalimit dhe garanton ruajtjen e fshehtësisë së tij”;

- Opsioni “Dil”, nuk është komandë e zbatueshme nga ana e sistemit pasi përdoruesi mbetet i loguar në sistem edhe pas thirrjes së këtij opsioni duke lejuar nëpërmjet sistemit të ndodhin gabime njerëzore, por dhe gabime të qëllimshme pasi dikush tjetër mund të veprojë në emër të përdoruesit që mendon se ka dalë jashtë sistemit. Kjo problematikë rezultoi e pa identifikuar, e pa raportuar dhe e pazgjithur, megjithëse sistemi është ndërtuar që në vitin 2011.

**Kriteri:** Neni 10, pika 3 e urdhrin nr.432, datë 28.09.2016 “Për përcaktimin e procedurave dhe mënyrave për përdorimin e portalit unik të inspektimit e-inspektimi”, ku citohet se “Portali ofron për çdo përdorues mundësinë e ndryshimit në çdo moment kohe të fjalëkalimit dhe garanton ruajtjen e fshehtësisë së tij”.

**Ndikim/Efekti:** Mungesë e elementëve më bazikë të sigurisë për përdoruesit.

**Shkaku:** Mungesë e testimeve dhe verifikimeve në sistem nga ana e ndjekësve të kontratës dhe administratorët e sistemit e-inspektimi.

**Rëndësia:** E lartë

**Rekomandimi:** AKSHI dhe IQ si institucione administrues të sistemit e-inspektimi të kryejnë testime në sistem për të verifikuar të gjitha problematikat që shfaqen në sistemin e-inspektimi ku në të bëjnë pjesë dhe opsionet e vetë administrimit të përdoruesit dhe ti adresojnë problematikat të cilat vijnë si rezultat i mangësive në sistem tek AKSHI si ndjekës i kontratës së mirëmbajtjes.

Agjencia Kombëtare e Shoqërisë së Informacionit, ka, ka paraqitur observacion me shkresën nr.7255/3, datë 25.02.2022 protokolluar në KLSH me nr. 978/9 datë 01.03.2022, ku citohet **Pretendimi:** Objeksione në lidhje me rekomandimin nr. 23 në këtë raport: AKSHI shprehet se: Kontrata për mirëmbajtjen e sistemit të inspektimit të IQ përfshin raportet periodike mbi

mbarëvajtjen e sistemit dhe problematikat e hasura e të zgjidhura nga ana e institucioneve dhe operatorit ekonomik të kontraktuar.

***Qëndrimi i grupit të auditimit:***

Ju sqarojmë se përderisa kemi konstatuar gjithë ato problematika që i gjeni të dokumentuara në këtë raport auditimi do të thotë se ka çaluar procesi i mirëmbajtjes për këtë sistem. Në sistemin e-inspektimi, me mirëmbajtje të kontraktuar 4 herë më shumë në vlerë **se vlera mujore e kontraktuar kur ky sistem administrohej nga IQ**, problematikat janë akoma aty. *Për këtë arsye ky observacion është marrë në konsideratë pjesërisht në këtë raport përfundimtar auditimi.*

**Mangësitë e konstatuara në sistemin e-inspektimi janë përgjegjësi e 2 institucioneve administrues IQ dhe AKSHI-t, ku AKSHI është njëkohësisht ndjekës i kontratës së mirëmbajtjes për periudhën objekt auditimi.**

**Parregullsitë e konstatuara në këtë Raport Auditimi dhe mos marrja e masave organizative për zgjidhjen e tyre, ngarkon me përgjegjësi drejtuesit e 3 institucioneve për periudhën objekt auditimi 01.01.2020-30.06.2021:**

Z. R. L me detyrë Drejtor i Përgjithshëm i Autoritetit Kombëtar të Ushqimit për periudhën Janar 2020 – Tetor 2020;

Z. B. S. me detyrë Drejtor i Përgjithshëm i Autoritetit Kombëtar të Ushqimit për periudhën Tetor 2020 - Qershor 2021;

Z. Sh. H. me detyrë Drejtor i Përgjithshëm i Inspektoratit Qendror;

Zj. M. K. me detyrë Drejtor i Përgjithshëm i AKSHI-t.

*Inspektoriati Qendror, ka paraqitur observacion me shkresën nr.44/1, datë 31.01.2022 protokolluar në KLSH me nr.978/6 datë 09.02.2022, ku citohet:*

***Pretendimi:*** Objeksione në lidhje me gjetjen nr.15: Në sistemin e-inspektimi çështjet krijohen dhe pa njoftim paraprak.

***Qëndrimi i grupit të auditimit:***

Sqarojmë se, konstatimi ka të bëjë me dokumentimin e Proceseve të punës (workflow) dhe të manualit të e-inspektimit, në të cilët nuk gjenden të dokumentuar hapat e inspektimit pa “Njoftim paraprak”. Pra dokumentacioni udhëzues për punën në sistemin e-inspektimi nuk është i njëjtë me hapat që ndiqen në sistem për inspektimet pa njoftim paraprak. Në mënyrë që të përputhet sistemi me manualin dhe workflow, nevojitet të dokumentohen këto procese ashtu si ato realizohen në rastet pa njoftim.

*Për sa më lart, konstatimi qëndron dhe grupi i auditimit nuk e merr në konsideratë observacionin për sa kohë konfirmohet dhe nga ana juaj se në sistem çështja kryhet pa njoftim, por dokumentet tregojnë se duhet të bëhen me njoftim.*

***Pretendimi:*** Objeksione në lidhje me gjetjen nr.17. IQ ka iniciuar hedhjen në sistemin e-inspektimi të statistikave që rrjedhin nga kërkesat kryesore të ligjit për inspektimin. Për sa i takon kërkesave për të dhëna statistikore specifike, është kërkuar që të hartohen nga çdo inspektoriat sipas nevojave për t'i integruar më pas në sistem. Nga ana e AKU nuk është paraqitur asnjë formular statistikor për gjenerimin e të dhënave në përputhje me kërkesat funksionale të saj. Asgjësimi, fletë shoqërimi për laboratorë, fatura e arkëtimit për gjobën duhet të paraqiten pranë IQ në mënyrë që të bëhet hedhja e këtij dokumentacioni shoqërues në sistem.

***Qëndrimi i grupit të auditimit:***

Sqarojmë se, statistikave nuk duhet të jenë të dhëna që plotësohen në formate të miratuara manualisht, por raporte të gjeneruara në mënyrë komplekse me të dhënat që përmban sistemi. AKU aktualisht e ka një format por plotësimi i tij bëhet në excel, dhe ky raport është nga më kryesorët pasi tregon për aktivitetin e institucionit në lidhje me inspektimin. Ky raport duhet të

gjenerohet nga sistemi, përndryshe ajo që keni informatizuar është vetëm marrdhënia inspektuese AKU-subjekt dhe kjo jo e plotë sa kohë nuk përfundon i gjithë procesi në mënyrë elektronike. Asgjësimi, fletë shoqërimi për laboratorë, fatura e arkëtimit për gjobën nuk duhet të paraqiten pranë IQ për t'u hedhur në sistem, vetë inspektori e ka atë përgjegjësi.

*Për sa më lart, konstatimi qëndron dhe grupi i auditimit nuk e merr në konsideratë observacionin.*

**Pretendimi:** *Objeksione në lidhje me gjetjen nr.18.* Inspektori nuk ka të drejtë të shohë inspektimin e mëparshëm në subjekt nëse nuk e ka kryer vetë këtë inspektim. I është kërkuar I.shpk të bëjë të mundur që inspektorët të shohin inspektimet e mëparshme në subjektet e inspektuara.

**Qëndrimi i grupit të auditimit:** Sqarojmë se, konstatimi konfirmohet nga ana juaj. Por, si institucion bashkë administrues me AKSHI-n nevojitet që këtë çështje t'ia komunikoni dhe AKSHI-t i cili mban përgjegjësi për ndjekjen e kontratës së mirëmbajtjes.

*Për sa më lart, konstatimi qëndron dhe grupi i auditimit nuk e merr në konsideratë observacionin.*

**Pretendimi:** *Objeksione në lidhje me gjetjen nr.19.* Sistemi e-inspektimi e ben te mundur shikimin e historikut të inspektimeve nëpërmjet raportit “Inspektimet që janë kryer apo në proces në çdo OBU”. E njëjta gje mund të realizohet për AKU.

**Qëndrimi i grupit të auditimit:** Sqarojmë se, situata gjatë auditimit rezultoi ashtu sic paraqitet në këtë gjetje. Pas këtij konstatimi ju mund të ndërmerrni hapat e duhur për të rregulluar situatën në përmirësim të veprimeve operacionale për AKU, por jo vetëm.

*Për sa më lart, konstatimi qëndron dhe grupi i auditimit nuk e merr në konsideratë observacionin.*

**Pretendimi:** *Objeksione në lidhje me gjetjen nr.20.* IQ ka kërkuar të rishikohen të gjitha raportet në nivel vendi, përfshirë dhe të dhënat e detyrueshme për AKU, të cilat duhet t'i paraqiten IQ.

Gjithashtu, sistemi lejon që shtyrja të kryhet në të njëjtën datë sepse bazuar në ligjin për nr.10433, datë 16.06.2011 “Për inspektimin në Republikën e Shqipërisë”, neni 29 kemi inspektime 4 orë të cilat llogariten si gjysëm dite inspektimi. Në rastet e opsionit “nuk aplikohet” të munguar, kjo është përgjegjësi e kompanisë zhvilluese, pasi dakordësia ka qenë që ky opsion të jetë i vlefshëm për çdo pyetje të listë verifikimit.

**Qëndrimi i grupit të auditimit:** Sqarojmë se, grupi pranon observacionin për shtyrjen që kryhet në të njëjtën datë, ndërsa observacioni për opsionin “nuk aplikohet”, konfirmohet dhe nga ana juaj se konstatimi qëndron.

Për sa më lart, konstatimi qëndron dhe grupi i auditimit merr në konsideratë vetëm për konstatimin “Shtyrja e inspektimit për arsye të ndryshme, të lejueshme në procedurën e inspektimit, mund të aplikohet brenda të njëjtës datë, veprim i cili duhet ndaluar të ndodhë nëpërmjet sistemit si një hap kontrollues dhe ndihmues në veprimet operacionale”, i cili do të reflektohet në këtë raport përfundimtar.

*Në çështjet e tjera konstatimi qëndron dhe grupi i auditimit nuk e merr në konsideratë observacionin.*

**Pretendimi:** *Objeksione në lidhje me gjetjen nr.21.* Në sistemin e-inspektimi ekziston fillimi i një çështje jashtë programit me arsyen e inspektimit “Plan Monitorimi”. Kjo çështje ka të njëjtën workflow si çështjet e tjera në sistem.

**Qëndrimi i grupit të auditimit:**

Sqarojmë se, gjatë auditimit u konstatua se, sistemi e-inspektimi nuk të jep mundësinë e plotësisimit të urdhrimit apo vendimit mbi të cilin po bëhet plani i monitorimit, monitorime të cilat mund të zhvillohen në kohë të ndryshme, nga arsye të ndryshme dhe më kërkesa të pakufizuara.

*Për sa më lart, konstatimi qëndron dhe grupi i auditimit nuk e merr në konsideratë observacionin.*

**Pretendimi:** *Objeksione në lidhje me gjetjen nr.22.* Mbivendosja e listë verifikimeve do të kontrollohet nga ana e IQ dhe do të bëhen ndryshimet për evidentimin e tyre. Marrja e listës së subjekteve të hapura rishitas apo të mbyllura është kërkuar vazhdimisht nga QKB të vihet në dispozicion të sistemit e-inspektimi.

**Qëndrimi i grupit të auditimit:**

Sqarojmë se, QKB si bazë të dhënash shtetërore nuk mund t'ju vejë në dispozicion të dhëna për sistemin tuaj sa kohë ju nuk keni një bazë të dhënash shtetërore të regjistruar. Sapo ju të jeni regjistruar si bazë të dhënash shtetërore, ndërtimi i ndërveprimit të sistemeve nuk është më i vështirë sa kohë administrohen nga AKSHI të dy sistemet.

*Për sa më lart, konstatimi qëndron dhe grupi i auditimit nuk e merr në konsideratë observacionin.*

**Pretendimi:** *Objeksione në lidhje me gjetjen nr.23.* Mos lejimi i mbylljes së procesverbalit të inspektimit përpara marrjes së rezultateteve duhet të jetë i detyrueshëm për të mos lejuar anashkalimin e hedhjes së rezultateve të analizave pavarësisht vendimit që do të merret në çdo rast.

**Qëndrimi i grupit të auditimit:**

Sqarojmë se, nëse nuk keni asnjë kundërshtim në lidhje me këtë, atëherë nga ana jonë do të rekomandohet mosdhënia e procesverbalit për aq kohë sa përcakton ligji për përgjigjen e mostrës, çfarë duhet të përkohë dhe me mbylljen e rekordit të inspektimit. Pra, në momentin që mbaron afati për përgjigjen e mostrës, duhet të mbyllet automatikisht rekordi në sistem dhe jo manualisht nga inspektori.

*Për sa më lart, konstatimi qëndron dhe grupi i auditimit nuk e merr në konsideratë observacionin.*

*Agjencia Kombëtare e Shoqërisë së Informacionit, ka , ka paraqitur observacion me shkresën nr.7255/3, datë 25.02.2022 protokolluar në KLSH me nr. 978/9 datë 01.03.2022, ku citohet*

**Pretendimi:** *Objeksione në lidhje me këtë raport: AKSHI shprehet se: ...Vihet re një lexim jo korrekt i akteveligjore që rregullon përgjegjësinë e IQ-së, AKU-s dhe vet AKSHI-t e cila ka sjellë një konfuzion në ngarkimin e përgjegjësisë dhe për rrjedhojë edhe në dhënien e rekomandimeve. ....duke qenë se veprimet e Organit publik auditues, sjellin vendime administrative, Organi publik auditues, duhet të ndjek një proces të rregullt administrativ.....nuk ka thirrur titullarin për ballafaqim..*

**Qëndrimi i grupit të auditimit:**

Grupi i auditimit sqaron se ka rekomanduar në nivel drejtues masa organizative për të cilat ka vënë edhe përgjegjësi e cila është në nivel drejtues për të tre subjektet e audituara, por asnjë masë administrative. Përgjegjësitë të cilat i keni kundërshtuar pothuajse në të gjitha rastet janë adresuar tek AKSHI në mungesë të një marrëveshje të nënshkruar me këto institucione dhe kjo përgjegjësi është bazuar në katalogun e shërbimeve që përcakton VKM nr.673, datë 22.11.2017 e ndryshuar, ku AKSHI ngarkohet të japi shërbimet sipas katalogut.

Masat që kërkohen të merren nga ju theksoj se janë organizative dhe për mirëfunksionimin e TIK në AKU, por meqë AKU e kryen aktivitetin inspektues bazuar në rregullat e përcaktuara nga IQ atëherë të tre institucionet kanë rolin dhe rëndësinë e tyre në këtë proces.

Ju në asnjë rast nuk keni treguar të dokumentuar se problemi, ose ajo që ne i referohemi si “gjetje” nuk qëndron, por observoni vetëm përgjegjësinë. Përgjegjësia është në nivel drejtuesish për të 3 institucionet dhe jo vetëm për ju, sepse në gjykimin tonë rregullimet e kërkuara nuk mund të kryhen pa bashkëpunim, të cilin nuk e inicion në asnjë rast stafi teknik.

Grupi ka qënë vazhdimisht në komunikim me specialistët e AKSHI-t në të dy institucionet për marrjen e dokumentacionit, madje raportet e mirëmbajtjes nuk na janë vënë në dispozicion, ndërsa janë zhvilluar dhe takime ashtu sikurse mund të jeni në dijeni me stafin tuaj si në ambjentet e AKU ashtu dhe të IQ.

Ju kundërshtoni përgjegjësinë megjithëse kjo përgjegjësi përcaktohet qartë në VKM nr. 673, datë 22.11.2017, saktësisht në katalogun e shërbimeve ku ofruet i shërbimit është AKSHI, përmendur në gjetjet rast pas rasti.

Së fundmi ju sqaroj se, tek ju janë përcjellë Aktkonstatimet e grupit të auditimit për të cilat ju nuk keni observuar brenda afatit të përcaktuar në Aktkonstatim.

Gjithashtu, me anë të shkresës përcjellëse për Projekt Raportin e dërguar nga KLSH me nr.978/3, datë 26.01.2022, i cili ka mbërritur tek AKSHI me nr.7255/1, datë 27.01.2022, jeni vënë në dijeni për takimin që i rezervohet subjektit të audituar, mbi gjetjet apo rekomandimet të cilat observohen në këtë fazë, cituar në paragrafin e fundit të kësaj shkrese.

Observacionet tuaja kanë mbërritur në KLSH në datën 01.03.2022, pra 2 ditë pas afatit me të cilin jeni njohur në shkresën përcjellëse.

## IV. GJETJET DHE REKOMANDIMET

### A. MASA ORGANIZATIVE:

**1. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi mbi aktet rregullative të brendshme që disponon AKU u konstatua se, Rregullorja e Brendshme nuk është e përditësuar në funksion të strukturës organizative pasi në të nuk janë paraqitur detyrat funksionale për Sektorin e Planifikimit Strategjik dhe Raportimit.

*(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.1 faqe 12-16 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)*

**1.2 Rekomandimi:** Titullari i AKU, të marrë masa për përditësimin e rregullores së brendshme institucionale në të cilën krahas ndryshimeve të detyrave operationale që mund të kenë ndryshuar të pasqyrohen dhe detyrat e sektorit të ri të Planifikimit Strategjik dhe Raportimit.

*Brenda 6 mujorit të parë të 2022 dhe në vijimësi*

**2. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi u konstatua se, AKU nuk ka ndërtuar dhe miratuar një strategji institucionale me elementë të strategjisë së teknologjisë së informacionit.

*(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.1 faqe 12-18 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)*

**2.1 Rekomandimi:** AKU të marrë në konsideratë elementë të strategjisë së teknologjisë së informacionit në hartimin dhe miratimin e strategjisë institucionale që do të zhvillojë në vitet në vijim, e cila në të gjithë hallkat e saj duhet që nëpërmjet teknologjisë të mbështesë arritjen e objektivave të institucionit. Për ofrimin e shërbimeve elektronike AKU të bashkëpunojë me AKSHI-n, si institucion përgjegjës për hartimin e strategjisë së agjendës digjitale dhe bashkërendimin e planit të veprimit për këto shërbime.

*Menjëherë*

**3. Gjetje nga auditimi:** Nuk është nënshkruar marrëveshje për shërbimet TIK që ofron AKSHI kundrejt Autoritetit Kombëtar të Ushqimit dhe IQ, ku të përcaktohen shërbimet e ofruara, mënyrat e raportimit, parametrat dhe niveli i ofrimit të shërbimit si p.sh. Orët/nivelet e suportit/përgjegjësitë/ kufizimet, etj.

*(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.2 faqe 18-24 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)*

**3.1 Rekomandimi:** AKSHI dhe AKU, të marrin masat e nevojshme për hartimin dhe miratimin e marrëveshjes dypalëshe me qëllim përcaktimin e të drejtave dhe detyrimeve për shërbimet TIK që ofron AKSHI ku të përcaktohet qartë se cilat janë shërbimet, ofrimi si dhe zbatimi i tyre.

*Menjëherë*

**3.2 Rekomandimi:** AKSHI dhe IQ, të marrin masat e nevojshme për hartimin dhe miratimin marrëveshjes dypalëshe me qëllim përcaktimin e të drejtave dhe detyrimeve për shërbimet TIK që ofron AKSHI ku të përcaktohet qartë se cilat janë shërbimet, ofrimi si dhe zbatimi i tyre.

*Menjëherë*

**4. Gjetje nga auditimi:** IQ nuk disponon raporte periodike të mirëmbajtjes së sistemit e-inspektimi edhe pse është administrator i portalit E-inspektimi sipas përcaktimeve të VKM nr. 696, datë 16.08.2013 “Për Përcaktimin e Procedurave të Ushtrimit të Kompetencave të Inspektoratit Qendror dhe të Rregullave për Përmbajtjen dhe Administrimin e Portalit Unik e-Inspektimi”.

*(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.2 faqe 18-24 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)*

**4.1 Rekomandimi:** AKSHI si ndjekës i kontratës së mirëmbajtjes për sistemin e-inspektimi të marrë masat për vënien në dijeni të institucionit përfitues të shërbimeve të mirëmbajtjes që në këtë rast është IQ me qëllim informimin e institucionit mbi problematikat e raportuara nga IQ.

*Menjëherë dhe në vijimësi*

**5. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi u konstatua se, Autoriteti Kombëtar i Ushqimit si dhe Inspektorati Qendror nuk disponojnë regjistër rrishtu me elemente të teknologjisë së informacionit. Për periudhën objekt auditimi, nuk rezultoi të jenë identifikuar, dokumentuar, analizuar dhe vlerësuar rrishtu lidhur me teknologjinë e informacionit që disponojnë institucionet.

*(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.3 faqe 24-31 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)*

**5.1 Rekomandimi:** AKU dhe IQ të marrin masa për hartimin e regjistrit të rrishtu për teknologjinë e informacionit në institucionet respektive, ku të jenë evidentuar ngjarje të mundshme të cilat mund të kenë efekt negativ në mbarëvajtjen e punës institucionale, me qëllim krijimin e një plani pune në rastet e shfaqjes së problematikave të ndryshme në fushën e teknologjisë së informacionit. Rrishtu e identifikuar që lidhen me funksionalitetin e sistemit “e-inspektimi” t’i adresohen IQ dhe AKSHI-t si administrator të këtij sistemi.

*Brenda vitit 2022 dhe në vijimësi*

**6. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi u konstatua se:

- IQ nuk ka hartuar dhe miratuar politika, procedura apo akte rregullative që garantojnë sigurinë e informacionit, procedura për back-up të të dhënave të sistemit e-inspektimi ku bën pjesë dhe AKU, rregullore për trajtimin e gabimeve që mund të ndodhin në infrastrukturën TIK, menaxhimin e incidenteve, vazhdimësinë e ofrimit të shërbimit të inspektimit online në rast ndërprerje.

- IQ nuk disponon rregullore për administrimin e përdoruesve të sistemit, ku të jenë përcaktuar hapat që do të ndiqen për krijimin, fshirjen, ndryshimin e roleve, të drejtave, fjalëkalimeve si dhe raportimin e tyre.

*(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.3 faqe 24-32 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)*

**6.1 Rekomandimi:** IQ të marrë masat e nevojshme për hartimin dhe vënien në dispozicion të procedurave apo akteve rregullative për administrimin e përdoruesve si dhe informimin e tyre për elementët e sigurisë së informacionit që ka miratuar institucioni që lidhen me inspektimet online, back-upin e të dhënave si dhe vazhdimësinë e ofrimit të shërbimit të inspektimit në rast ndërprerje.

IQ të adresojë tek AKSHI përgjegjësinë teknike për zbatimin në elementët e sigurisë së informacionit, back-upin e të dhënave si dhe vazhdimësinë e ofrimit të shërbimit të inspektimit në rast ndërprerje.

*Brenda 6 muajit të parë të vitit 2022*

**7.1 Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi mbi të dhënat e inspektorëve dhe verifikimi i tyre nga sistemi u konstatua se:

- Datëlindja, është e njëjtë për të gjithë 1/1/1970;
- Adresa NID, është e pasaktë dhe e njëjta ID për të gjithë user-at 1234567890;
- Gjuhë e huaj, është fushë boshe;
- I vlefshëm deri më, vendosur data 12/31/2999;
- Rajoni, jo në çdo user është plotësuar;
- Modified, në disa user-a nuk del edhe viti se kur është bërë modifikimi i fundit por vetëm data dhe muaji.

**7.2 Gjetje nga auditimi:** - Datë të mirëfilltë largimi të punonjësit nuk ka në sistem, si e tillë merret i mirëqenë modifikimi i fundit kur është bërë inactive;

- Nuk ka asnjë lloj informacioni për përdoruesit e fshirë;
- Mbjajnë statusin “aktiv” përdorues të cilët nuk kanë asnjë marrëdhënie aktive me AKU. Rastet e konstatuara janë inspektorë të cilët janë larguar për arsye të ndryshme si: mbushja e moshës për pension pleqërie, dorëheqja si dhe përdorues të tjerë;
- Ka raste kur i njwjt punonjws ka mw shumw se një përdorues;
- Në disa raste ka mospërputhje të pozicionit të punës dhe rolit të tij në sistem, p.sh.; punonjësi emëruar në pozicionin e Specialistit në Sektorin e Financës dhe Shërbimeve të Brendshme ka akses në sistem dhe roli që ky specialist ka në sistem është si Kryeinspektor Rajonal;
- Një përdorues është me emrin “Ligjor AKU” në DRAKU Tiranë me rol në sistem “Ligjor Inspektorati” dhe Inspektor AKU si përdorues aktiv në sistem me kredenciale të përgjithshme të cilët nuk janë përcaktuar se nga cili punonjës posedohen dhe përdoren;
- Nga njoftimi i fillimit të punës në hapjen apo mbylljen e user-it ka një afat më të gjatë në hapjen e tij në kundërshtim me VKM nr. 696, datë 16.08.2013 “Për Përcaktimin e Procedurave të Ushtrimit të Kompetencave të Inspektoratit Qendror dhe të Rregullave për Përmbytjen dhe Administrimin e Portalit Unik “e-Inspektimi””.

Nga auditimi u konstatua se, në disa raste të përzgjedhur rastësisht dhe verifikimi i tyre ka rezultuar se nga këto shembuj ka afate gati dhe për një periudhë 1 vit nga largimi i punonjësit deri në mbylljen e aksesit për të, apo edhe afati i gjatë nga momenti që është punësuar deri në hapjen e një përdoruesi në sistem;

- Ka user-a të cilët janë hapur përpara se të hynte AKU në sistemin e e-Inspektimit si p.sh., user-a të cilët janë krijuar në sistem në vitin 2015, 2016 dhe 2017 ndërkohë AKU është futur në sistem në vitin 2018, gjithashtu përdoruesit si inspektorë pavarësisht se është e punësuar në PIK të cilët nuk kanë ende akses në sistem.

*(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.3 faqe 24-34 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)*

**7.1 Rekomandimi:** AKU dhe IQ si përgjegjës për të dhënat e sistemit e-inspektimi të verifikojnë dhe të sistemojnë të dhënat mbi përdoruesit. IQ të adresojë tek AKSHI si administrator i sistemit dhe ndjekës i kontratës së mirëmbajtjes, të gjitha rastet që do të konsiderohen si anomali të sistemit me qëllim saktësimin dhe plotësimin e tyre nga ofruesi i shërbimit.

*Menjëherë*

**8. Gjetje nga auditimi:** Nga verifikimi i dhomës së serverëve në AKU, u konstatua se ambientet fizike nuk janë në përputhje me standardet e përcaktuara në “Rregulloren për ndërtimin e dhomës së serverave” (Versioni 1.0, datë 02.12.2008) miratuar nga AKSHI (Agjencia Kombëtare e Shoqërisë së Informacionit).

Disa nga problematikat e konstatuara, janë të renditura si më poshtë:

- Aksesit në ambientin e dhomës së serverave nuk është i kontrolluar me teknologji të tilla si: skanime, lexues karte, etj.;
- Pajisjet elektronike si serverat dhe pajisjet e rrjetit janë të ruajtura në këto hapësira, ku kanë akses specialistët e TI, nuk ka pajisje të sigurisë fizike të aksesit dhe sistem të kufizimit të personave të paautorizuar;
- Aksesit në ambientin e dhomës së serverave nuk është i kontrolluar me teknologji të tilla si: skanime, lexues karte, etj.;
- Instalimi elektrik i dhomave të serverave nuk është veçmas instalimit të përgjithshëm;
- Mungon sistemi i alarmit. Duhet të ketë të tillë në mënyrë që të sinjalizojnë problemet me rrymën elektrike, me ambientin fizik, sensor për rrjedhjen e ujit, sensor për parandalimin e dëmtimeve fizike të strukturës së dhomës.

*(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.3 faqe 24-34 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)*

**8.1 Rekomandimi:** AKSHI si institucioni administrues për teknologjinë e informacionit në AKU të marrë masa për identifikimin e të dhënave që ruhen jashtë sistemit elektronik, por që janë të rëndësishme për punonjësit dhe vetë AKU-n, pasi lidhen drejtpërdrejtë me detyrat e tyre funksionale apo raportuese, në mënyrë që të gjejë zgjidhjen ekonomikisht më të favorshme në ruajtjen e tyre.

*Menjëherë*

**9. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi dhe mbikëqyrja e faqes Web të Inspektoratit Qendror, nëpërmjet së cilës aksesohet dhe portali “e-inspektimi” u konstatua se, nuk përdoret një lidhje e sigurt (connection security) HTTP (Hyper Text Transfer Protocol) dhe HTTPS (Hyper Text Transfer Protocol Secure) (Not Secure Status). Mungesa e kësaj certifikate mbart riskun e cenimit të privatësisë, ndryshimit të informacionit dhe shkëmbimit të tij përmes këtij portali.

*(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.3 faqe 24-34 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)*

**9.1 Rekomandimi:** Inspektorati Qendror në bashkëpunim me AKSHI-n të marrin masa për sigurimin e faqes web të IQ, nëpërmjet të cilit të gjithë inspektoratet aksesojnë sistemin elektronik të inspektimit “e-inspektimi”.

*Menjëherë*

**10. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi u konstatua se, sipas përcaktimeve të VKM nr. 696, datë 16.08.2013 dhe VKM nr. 673 datë 22.11.2017, Inspektorati Qendror dhe AKSHI janë të dy institucione administrues të aplikacionit informatik “e-inspektimi”. Sipas pikës 2 paragrafi X i VKM nr. 696, datë 16.08.2013 “Për përcaktimin e procedurave të ushtrimit të kompetencave të Inspektoratit Qendror dhe të rregullave për përmbajtjen dhe administrimin e portalit unik “e-inspektimi” dhe pikës gj, paragrafi II në VKM nr. 673, datë 22.11.2017 “Për riorganizimin e Agjencisë Kombëtare të Shoqërisë së Informacionit, i ndryshuar”, në të cilat respektivisht citohet se:

- Inspektorati Qendror është përgjegjës për krijimin, administrimin dhe mirëmbajtjen e Portalit, i cili mbahet në format elektronik. Regjistrimi, përpunimi, përdorimi, publikimi dhe ruajtja e të dhënave e informacionit në të kryhen nëpërmjet një sistemi të informatizuar.
- AKSHI ngre, mirëmban dhe administron sisteme dhe aplikacione të teknologjisë së informacionit dhe komunikimit, infrastrukturën e qendëruar dhe infrastrukturën TIK, përfshirë edhe ato të klasifikuara si “sekret shtetëror”, për institucionet dhe organet e administratës shtetërore nën përgjegjësinë e Këshillit të Ministrave.

Konstatimi i referohet pikës 2, paragrafi X i VKM nr. 696, datë 16.08.2013 “Për përcaktimin e procedurave të ushtrimit të kompetencave të Inspektoratit Qendror dhe të rregullave për përmbajtjen dhe administrimin e portalit unik “e-inspektimi” dhe pika gj. paragrafi II në VKM nr.673, datë 22.11.2017 “Për riorganizimin e Agjencisë Kombëtare të Shoqërisë së Informacionit, i ndryshuar”.

*(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.4 faqe 34-60 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)*

**10.1 Rekomandimi:** IQ dhe AKSHI si administratore të sistemit “e-inspektimi” mbështetur në aktet ligjore respektive, të ndjekin hapat e nevojshëm ligjorë për interpretim dhe shfuqizim nëse do të jetë e nevojshme të një prej neneve që mbivendosin të drejtën administrative të këtij sistemi.

*Brenda 6 mujorit të parë të vitit 2022*

**11.1 Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi mbi të dhënat shtetërore të AKU dhe IQ u konstatua se, AKSHI edhe pse institucion administrues i sistemeve dhe aplikacioneve, njëkohësisht dhe Autoriteti Rregullator Koordinues, ka kërkuar nga IQ dhe AKU përmbushjen e një detyrimi ligjor lidhur me regjistrimin e të dhënave që gjenerojnë si të dhëna shtetërore.

Në nenin 7, pika 1 të VKM nr.945, datë 02.11.2012 “Për miratimin e rregullores “Administrimi i sistemit të bazave të të dhënave shtetërore””, citohet se “Institucioni, i cili kërkon të krijojë një bazë të dhënash shtetërore, bashkëpunon me ARK-në për përgatitjen e dokumentacionit të bazës së të dhënave”, tregon se nevojitet një bashkëpunim nga ana e AKSHI-t, jo thjesht delegim tek institucionet plotësimi i detyrimeve ligjore për bazat e të dhënave shtetërore. IQ dhe AKSHI nuk kanë në strukturën e tyre asnjë specialist të fushës së teknologjisë së informacionit, për administrimin e të dhënave të cilat janë aktualisht pa përgjegjësi. Administrimi i të dhënave është përgjegjësi e institucionit që i krijon ato.

**11.2 Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi u konstatua se, sistemi e-inspektimi është në funksion dhe ndërvepron me sistemin e QKB, në kundërshtim me:

- Nenin 8 të ligjit nr.10325, datë 23.9.2010, për “Bazat e të dhënave shtetërore”, ku citohet se “1. Ndërveprimi ndërmjet bazave të dhënave shtetërore bëhet vetëm me të dhënat parësore. 2. Ndalohet ndërveprimi i bazave të dhënave shtetërore me të dhënat dytësore”;
- Nenin 9 pika 5 e VKM nr. 945, datë 02.11.2012 “Për miratimin e rregullores “administrimi i sistemit të bazave të të dhënave shtetërore” ku citohet se “Një bazë të dhënash shtetërore, e cila nuk është e regjistruar në ARK, nuk vihet në përdorim dhe as ndërvepron me të tjera baza të dhënash shtetërore”.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.4 faqe 34-60 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

**11.1 Rekomandimi:** AKU dhe IQ të marrin masat e nevojshme për ndryshime në strukturën e tyre institucionale me qëllim shtimin e një ose më shumë pozicioneve që do të kryejnë detyrat e administrimit të të dhënave që secili prej institucioneve krijon dhe administron në mënyrë elektronike. Administrimi i të dhënave është një shërbim që nuk i ngarkohet dhe nuk e mbulon AKSHI me specialistët e tij në institucionet tuaja.

*Brenda 6 mujorit të parë të vitit 2022*

**11.2 Rekomandimi:** AKSHI si Autoriteti Rregullator Koordinues, me ndryshimin e strukturës dhe përcaktimin e punonjësve përgjegjës, për të dhënat elektronike që disponojnë apo krijojnë institucionet IQ dhe AKU, të bashkëpunojë për regjistrimin e bazës së të dhënave duke pasur në konsideratë identifikimin e të dhënave parësore, të dhënat dytësore dhe çdo element që është i nevojshëm me qëllim përfundimin e procesit të regjistrimit të të dhënave shtetërore të inspektimit.

*Brenda 6 mujorit të dytë të vitit 2022*

**11.3 Rekomandimi:** AKSHI të marrë masa të menjëhershme në identifikimin e përgjegjësive për ndërveprimin e ndërtuar dhe lejuar ndërmjet një baze të dhënash shtetërore sic është ajo e QKB me një bazë të dhënash jo shtetërore sic është ajo e inspektimit.

*Menjëherë*

**12. Gjetje nga auditimi:** Inspektorati Qendror dhe Inspektoratet Shtetërore ku bën pjesë dhe AKU, aktualisht janë në fazë ristrukturimi, kërkesa dërguar Kryeministrit me shkresën nr.561, datë 20.12.2021 nga Inspektorati Qendror. Me miratimin e këtij ristrukturimi, inspektoratet shtetërore do të jenë pjesë e Inspektoratit Qendror, përfshirë dhe AKU. Për këtë arsye për përmirësimin e sistemit AKU-net duhet të merren në konsideratë ndryshimet ligjore të propozuara të cilat ndikojnë në veprimtarinë e AKU.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.4 faqe 34-60 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

**12.1 Rekomandimi:** AKSHI dhe AKU të marrin në konsideratë ndryshimet ligjore të cilat do të ndikojnë tek AKU me miratimin e ri-organizimit të trupave inspektuese kërkuar nga Inspektorati Qendror, në mënyrë që përmirësimi i sistemit të jetë në përputhje me këto ndryshime duke siguruar në këtë mënyrë mirë administrimin e fondeve për këtë qëllim.

*Menjëherë*

**13. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi mbi workflow dhe manualët e përdorimit të aplikacionit “e-inspektimi”, u konstatua se materialet udhëzuese workflow, manuale dhe video prezantimi, janë hartuar sipas hapave inspektues bazuar në nenin 1 të ligjit nr. 10433, datë 16.06.2011 “Për inspektimin në Republikën e Shqipërisë”, ku përcaktohet njoftimi paraprak i subjekteve, ndërkohë që AKU nuk kryen inspektime me njoftim paraprak të subjekteve në inspektim. AKU nuk mund të jetë pjesë e unifikimit të hapave inspektues lidhur me njoftimin paraprak, për këtë arsye dhe në manualët e inspektimeve duhej të trajtohet ndryshe nga inspektimet e tjera, Ligji nr. 10433, datë 16.06.2011 “Për inspektimin në Republikën e Shqipërisë” nenin 32 “Njoftimi i inspektimit”, pika 2.a dhe 2.b.

*(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.4 faqe 34-60 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)*

**13.1 Rekomandimi:** IQ si institucioni përgjegjës për unifikimin e hapave të inspektimit në bashkëpunim me AKU të marrin masat e nevojshme për hartimin dhe miratimin e workflow, ndërsa AKSHI për hartimin e manualeve në përputhje me aktivitetin e AKU, sipas përcaktimeve që bën ligji për kryerjen e inspektimeve pa njoftim paraprak, ashtu sikurse ndodh në sistemin e-inspektimi.

*Brenda 6 mujorit të parë të vitit 2022*

**14. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi mbi përdorimin e sistemit elektronik e-inspektimi u konstatua se, AKU ka vijuar aktivitetin jashtë sistemit informatik e-inspektimi për modulet *Protokoll Arkiva, Burimet Njerëzore, Vendimet Administrative*, në kundërshtim me rregulloren e miratuar me urdhrin nr.432, datë 28.09.2016, “Për disa shtesa dhe ndryshime në urdhrin nr. 15, datë 07.05.2016 “Për miratimin e rregullave për përcaktimin e procedurave dhe mënyrave, për përdorimin e portalit unik të inspektimeve e-inspektimi”, në të cilin janë përcaktuar detyrimet për hedhjen e të dhënave në modulet *Protokoll Arkiva, Burimet Njerëzore dhe Vendimet Administrative*, referuar nenit 11 në rregulloren e miratuar me urdhrin nr.432, datë 28.09.2016, “Për disa shtesa dhe ndryshime në Urdhrin nr. 15, datë 07.05.2016 “Për miratimin e rregullave për përcaktimin e procedurave dhe mënyrave, për përdorimin e portalit unik të inspektimeve e-inspektimi”.

*(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.4 faqe 34-60 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)*

**14.1 Rekomandimi:** Inspektorati Qendror të marrë masa për trajnimin e punonjësve të AKU për modulet që rezultojnë të pa informatizuar: *Protokoll Arkiva, Burimet Njerëzore, Vendimet Administrative*; në mënyrë që informatizimi për të dhënat në këto module të sistemit e-inspektimi, të fillojë sa më parë.

*Brenda 6 mujorit të parë të vitit 2022*

**14.2 Rekomandimi:** AKU të marrë masa që me përfundimin e trajnimit të punonjësve që kryejnë detyra në: *Protokoll Arkiva, Burimet Njerëzore, Vendimet Administrative*; të fillojnë hedhjen e të dhënave në sistemin e-inspektimi.

*Brenda 6 mujorit të parë të vitit 2022*

**15. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi mbi outputin e sistemit e-inspektimi u konstatua se, buletinet statistikore të inspektimeve të AKU popullohen manualisht dhe ruhen jashtë sistemit informatikë e-inspektimi. Të dhënat që buletinet përmbajnë, gjenden të regjistruara në sistemin e-inspektimi, por gjenerimi i raportimeve nga sistemi e-inspektimi nuk është bërë në përputhje me kërkesat funksionale të AKU. Kjo formë jo vetëm është një punë e dyfishtë për inspektorët që duhet të bëjnë raportimet jashtë sistemit, por rrit mundësinë për raportime jo të sakta. Mënyra e gjenerimit të të dhënave në trajtë raportesh nga sistemi e-inspektimi nuk mundëson modelet e raportimit që i nevojiten aktivitetit të AKU-s.

Nga auditimi u konstatua se AKU deri në këto momente, nuk ka arritur të përfitojë nga funksionaliteti i sistemit “e-inspektimi” përcaktuar në nenin 8/vi në rregulloren e miratuar nga

Inspektorati Qendror me urdhrin nr.432, datë 28.09.2016 “Për përcaktimin e procedurave dhe mënyrave për përdorimin e portalit unik të “e-inspektimit”” ku citohet se një nga funksionalitetet është “Përgatitja e raporteve periodike dhe vjetore në lidhje me veprimtarinë e inspektimit”.

Konstatimi i referohet nenit 8/vi në rregulloren e miratuar nga Inspektorati Qendror me urdhrin nr.432, datë 28.09.2016 “Për përcaktimin e procedurave dhe mënyrave për përdorimin e portalit unik të “e-inspektimit”” ku citohet se një nga funksionalitete është “Përgatitja e raporteve periodike dhe vjetore në lidhje me veprimtarinë e inspektimit”.

*(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.4 faqe 34-60 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)*

**15.1 Rekomandimi:** Inspektorati Qendror në bashkëpunim me AKSHI-n, si institucione administrues të sistemit e-inspektimi, ku AKSHI është njëkohësisht dhe ndjekës i kontratës së mirëmbajtjes të marrin masat për automatizimin e buletineve statistikore në sistemin informatik të inspektimit me qëllim minimizimin e raportimeve manuale që kryejnë gjithë përdoruesit e Autoritetit Kombëtar të Ushqimit përfshirë dhe inspektorët.

***Brenda vitit 2022***

**16. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi mbi historikun dhe aksesin në të dhëna u konstatua se, në sistemin e-inspektimi, AKU përballet me një papërshtatshmëri funksionale dhe operacionale. Nisur sa më sipër, nga auditimi u konstatua se:

- Mungojnë të dhënat me rekordet historike të AKU për periudhën 2012-2018 të cilat nuk janë importuar në sistemin e e-inspektimi si rekorde historike të inspektimeve përgjatë periudhës 2018 – 2021; Drejtoria qendrore e AKU disa herë i është drejtuar IQ për problematikat që ndeshin në sistemin e-inspektimi të cilat pengojnë aktivitetin e institucionit. Me anë të shkresës nr.1197, datë 05.03.2020 drejtoria qendrore i është drejtuar IQ përveç të tjerave dhe për importimin e të dhënave historike të AKU-net në sistemin e-inspektimi;

- Të dhënat e inspektimeve të ruajtura në bazën e të dhënave të IQ-së për periudhën 2018 e në vazhdim nuk janë të disponueshme për gjithë punonjësit që zhvillojnë analiza apo monitorime të inspektimeve të AKU-së me qëllim vlerësimin e riskut apo vlerësimin e performancës së inspektorëve të vet; Kjo çështje është trajtuar në detaje tek “Siguria e të dhënave dhe përdoruesit e sistemit”;

- Inspektori nuk ka të drejtë të shohë rezultatin e inspektimit të mëparshëm të zhvilluar në subjektin ku ai ndodhet nëse nuk ka qenë vetë ai për inspektim, duke e bërë të pamundur kontrollin për zbatimin e detyrave të lëna nga inspektimi i mëparshëm;

*(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.4 faqe 34-60 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)*

**16.1 Rekomandimi:** IQ dhe AKSHI si institucione administrues të sistemit e-inspektimi ku AKSHI njëkohësisht dhe ndjekës i kontratës së mirëmbajtjes të marrë masat për përmbushje nga ana e OE detyrimit për importimin e të dhënave historike të AKU në sistemin e-inspektimi për të siguruar në këtë mënyrë vazhdimësinë historike dhe të gjurmueshme të të dhënave inspektuese që janë kryer ndër vite.

***Brenda vitit 2022***

**16.2 Rekomandimi:** IQ dhe AKSHI si institucione administrues të sistemit e-inspektimi ku AKSHI njëkohësisht dhe ndjekës i kontratës së mirëmbajtjes të kërkojnë përmbushjen nga OE, të drejtën për të parë në sistem rezultatin e inspektimit të mëparshëm të zhvilluar në subjektin nga çdo inspektor që është aktualisht për inspektim.

***Brenda vitit 2022***

**17. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi mbi gjurmën e auditimit (audit log) u konstatua se, për sistemin e-inspektimi mungon gjurma elektronike e auditimit (audit log) sipas përcaktimeve të

rregullores për menaxhimin e log-eve digjitale miratuar me urdhrin nr.109 datë 10.06.2016 të Drejtorit të Agjencisë Kombëtare për Sigurinë Kompjuterike (ALCIRT).

*(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.4 faqe 34-60 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)*

**17.1 Rekomandimi:** IQ me ndryshimet ne strukturën e saj, të fillojë sa më shpejt marrjen e masave për identifikimin e të dhënave që nevojiten të ruhen për garantimin e gjurmës elektronike sic parashikojnë udhëzimet dhe t'i delegojë këto kërkesa tek ndjekësit e kontratës që është AKSHI. Nëëprmet sigurimit të kësaj gjurme investigimi mbi të dhënat e ndryshuara apo të fshira do të jetë më i lehtë për institucionin i cili do të mbajë përgjegjësinë e administrimit të këtyre të dhënave.

*Brenda 6 muhorit të parë të vitit 2022*

**17.2 Rekomandimi:** AKSHI të marrë masat në lidhje me sigurimin nga ana teknike të ruajtjes së gjurmës elektronike e cila do të ketë për qëllim sigurimin e investigimit të detajuar të veprimeve që ndodhin në sistemin e-inspektimi nga përdoruesit e tij.

*Brenda vitit 2022*

**18. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi i të dhënave output që gjenerohen nëpërmjet sistemit e-inspektimi u konstatua se:

- Nuk është e mundur marrja në kohë reale e të dhënave për indikatorë të veçantë në rang qarku apo në rang kombëtarë;
- Gjenerimi i të dhënave statistikore eksportohet në excel për analiza dhe formatime të mëtejshme, pasi dalin rreshtat e përsëritur të të dhënave;
- Për inspektorët nuk mbahen të dhëna për: Periudhë prove, Ka dhënë provim, Rezultati i provimit, Data e dhënies së provimit, i certifikuar, Fillimi i certifikimit, Përfundimi i certifikimit, Performanca, Datë mbyllje apo ç 'aktivizim të përdoruesit;
- Nuk gjenerohen të dhëna në trajtë raportesh për inspektimin online në lidhje me Inspektimet që janë kryer apo në proces në çdo Operator Biznesi Ushqimor - OBU (historiku i inspektimeve), Inspektimet në të gjithë vendin, Inspektimet me data në të gjithë vendin;
- Nuk gjenerohen të dhëna në trajtë raportesh me fjalë kyçe si "Prodhim përpunim qumështi" apo "Drejtuesi Teknik", etj.;
- Nuk janë bërë të dhëna të detyrueshme "mandatory field", ku plotësimi i tyre të mos lejojë kalimin në një fazë tjetër.

*(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.4 faqe 34-60 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)*

**18.1 Rekomandimi:** AKSHI si institucion administrues i sistemit e-inspektimi dhe njëkohësisht ndjekës i kontratës së mirëmbajtjes, të marrë masat për ndërtimin e raporteve në sistemin e-inspektimi, me qëllim ofrimin e kushteve të raportimit që i nevojiten aktivitetit të AKU-s.

*Brenda 6 muhorit të parë të vitit 2022*

**18.2 Rekomandimi:** AKSHI si institucion administrues i sistemit e-inspektimi dhe njëkohësisht ndjekës i kontratës së mirëmbajtjes, në bashkëpunim me IQ dhe AKU të identifikojë të dhënat e detyrueshme të listë kontrollit, për vendosjen e tyre duke i parametrizuar ato të detyrueshme dhe në sistem.

*Brenda vitit 2022*

**19. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi dhe monitorimi në terren mbi përdorimin e sistemit informatik e-inspektimi nga inspektorët e AKU u konstatuan disa mangësi të cilat renditen si më poshtë:

- Punonjësit logohen në sistem me pajisjet tabletë duke u lidhur me internetin e celularit personal. Në të dy rastet e monitorimit nga audituesit u shfrytëzuan pajisje personale për

plotësimin e inspektimit online. Për ruajtjen e rekordeve përdoruesit që janë inspektorët shtypin “Save” herë pas here, ku për shkaqe të ndërprerjes së internetit apo difekteve në “Touch” të pajisjeve, ju duhet të përsëritin hedhjen e të dhënave sepse nuk janë ruajtur dhe duhet të riksuesojnë përsëri sistemin.

- Sistemi nuk të jep mundësinë e plotësimit të urdhrit apo vendimit mbi të cilin po bëhet plani i monitorimit, monitorime këto të cilat mund të zhvillohen në kohë të ndryshme, nga arsye të ndryshme dhe me kërkesa të pakufizuara;
- Opsioni “Nuk aplikohet” mungon në pothuajse të gjitha listë kontrollet si përpunimi i qumështit, tregtim peshku, thertore etj.;

*(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.4 faqe 34-60 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)*

**19.1 Rekomandimi:** AKU në bashkëpunim me IQ të marrin masat, për sigurimin e internetit dhe riparimin apo zëvendësimin e pajisjeve tablet të inspektorëve të AKU në mënyrë që inspektorët të kryejnë në mënyrë të sigurtë dhe pa ndërprerje detyrat inspektuese në terren.

*Brenda 6 mujorit të parë të vitit 2022*

**19.2 Rekomandimi:** IQ në bashkëpunim me AKSHI-n si institucione administrues të sistemit e-inspektimi, ku AKSHI është njëkohësisht dhe ndjekës i kontratës së mirëmbajtjes të marrin masat për evidentimin e të gjithë fushave në listat e kontrollit që nuk është vendosur opsioni “Nuk aplikohet”. Nëse kjo është kërkuar, por nuk është realizuar nga OE, atëherë të përlllogariten penalitete mbi vlerën e mirëmbajtjes, në përputhje me kohën që kur kjo kërkesë apo dakordësim është marrë nga OE.

*Brenda 6 mujorit të parë të vitit 2022*

**20. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi mbi përdorimin e sistemit informatik e-inspektimi dhe hyrjen e të dhënave gjatë inspektimeve nëpërmjet sistemit e-inspektimi u konstatuan disa mangësi, konkretisht:

- AKU nuk informohet në mënyrë periodike në asnjë formë nga QKB për subjektet e hapura kohët e fundit të cilët kanë veprimtari me objekt inspektimi nga AKU. E njëjta situatë është edhe për subjektet që kanë mbyllur veprimtarinë, të cilët AKU i ka planifikuar për inspektim si rezultat i mungesës së informacionit.
- Me zgjedhjen e llojit të inspektimit nuk është bërë e mundur nëpërmjet sistemit inspektorët të zgjidhen nga lista e sektorit që do të kryejë atë lloj inspektimi, duke marrë në konsideratë kualifikimin e tyre dhe sektorin në të cilin ndodhen, çfarë do të garantonte që për çdo inspektim janë zgjedhur inspektorët e lejuar për ta kryer.
- Në listat e kontrollit ka kërkesa të cilat kontrollohen dhe nga institucione të tjera inspektuese si p.sh: largimi i mbetjeve, ujërave të ndotura etj., të cilat vetë subjektet u shprehën se kontrollohen dhe nga inspektorati i mjedisit.
- Në sistemin e-inspektimi nuk rezulton të jetë implementuar procedura e asgjësimit së bashku me procesverbalin përkatës, por ky proces ndiqet jashtë sistemit edhe pse ai është i rëndësishëm po aq sa inspektimi.
- Në listat e kontrollit në sistem nuk është aplikuar në asnjë rast plotësim me zgjedhje nga një numër mundësish që mund të mirëmbahet lehtësisht në sistem, duke ndikuar sadopak në kohë që nevojitet për plotësimin e listë kontrollit në subjekt.
- Në listat e kontrollit ka përsëritje të fushave që do të thotë se do të ketë plotësime me informacion përsëritës, duke rritur në këtë mënyrë fiktivisht kohën e plotësimit si p.r.sh. drejtuesi teknik është një nga fushat të cilat plotësohet dy herë nga inspektori, por kjo nuk është e vetmja.
- Në krijimin e çështjeve gjatë përzgjedhjes së aktivitetit nuk janë të gjitha kategoritë e aktiviteteve, por nga AKU nuk janë kërkuar shtime të aktiviteteve të tjera të nevojshme.

- Lista e Qendrës së Depurimit të Midhjes nuk të lejon aksesimin e gjenerimit në sistem me firmën Digjitale, por punohet nëpërmjet versionit web të aplikacionit.

*(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.4 faqe 34-60 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)*

**20.1 Rekomandimi:** IQ me bashkëpunimin e AKU-s, pas përfundimit të regjistrimit të dhënave shtetërore, të hartojë dhe delegojë tek AKSHI kërkesën për ndërveprim me të dhënat e regjistrimit të biznesit në QKB, për shkëmbimin e informacionit mbi subjektet e hapura dhe të mbyllura në mënyrë periodike, me qëllim lehtësimin e planifikimit inspektues. Ky ndërveprim do të shërbejë jo vetëm AKU por gjithë inspektoriateve.

*Brenda 6 mujorit të parë të vitit 2022*

**20.2 Rekomandimi:** IQ në bashkëpunim me AKU-n të identifikojnë nevojat për përmirësim të sistemit e-inspektimi që kanë të bëjnë me procese të inspektimit, mbetur jashtë sistemit si procedura e asgjësimit prej fillimit deri në procesverbalin përkatës.

*Brenda vitit 2022*

**20.3 Rekomandimi:** Inspektorati Qendror të identifikojë të dhënat inspektuese që përsëriten nga inspektorate të tjerë dhe që janë njëkohësisht në listë kontrollet e AKU, me qëllim eliminimin e kontrollove të dyfishta në subjektet që inspektohen.

*Brenda vitit 2022*

**20.4 Rekomandimi:** AKSHI si institucion administrues i sistemit e-inspektimi dhe njëkohësisht ndjekës i kontratës së mirëmbajtjes, por dhe administrues i sistemit të QKB, me përfundimin e regjistrimit të bazave të të dhënave shtetërore, të marrë masa për realizimin e ndërveprimit ndërmjet sistemit e-inspektimi dhe sistemit të QKB, për shkëmbimin e informacionit mbi subjektet e hapura dhe të mbyllura në mënyrë periodike çfarë do të ndihmonte AKU-n në hartimin e planeve të inspektimit. Gjithashtu, të vlerësojë dhe gjejë zgjidhjet teknike për kërkesat që vijnë prej IQ dhe AKU të cilat i shërbejnë punës së tyre inspektuese.

*Brenda 6 mujorit të parë të vitit 2022*

**21. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi i hapave që ndjekin inspektorët në terren u konstatua se, rekordi i inspektimit mbyllet me gjenerimin e procesverbalit përfundimtar edhe në rastet kur në subjekt është marrë një mostër dhe përgjigja e saj kërkon një afat që është përcaktuar në aktet ligjore. Në rastet kur analiza mund të rezultojë me ngarkesë bakteriale apo mikrobiologjike, në sistem krijohet një autorizim i ri duke humbur kështu gjurmën me rekordin e inspektimit që ndodhet në sistem regjistruar nga inspektorët të cilët kanë kërkuar kryerjen e një analize laboratorike. Mbyllja e rekordeve kryhet në të gjitha rastet, nisur nga fakti se përgjigjet laboratorike nuk kthehen brenda afateve, dhe masat e marra në vazhdimësi të këtij inspektimi të kryer janë në kundërshtim me aktet ligjore, duke detyruar kështu krijimin e një tjetër inspektimi, por këtë herë bazuar në rezultatin e mostrës. Vonesa e përgjigjes së laboratorëve vë në rrezik konsumatorët, por njëkohësisht arritjen e objektivave të Autoritetit Kombëtar të Ushqimit.

*(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.4 faqe 34-60 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)*

**21.1 Rekomandimi:** AKU dhe IQ të marrin masa të menjëhershme në ndryshimin e hapave inspektues duke mos lejuar mbylljen e rekordeve inspektuese në sistem përpara afatit që përcakton ligji për marrjen e përgjigjes nga laboratorit për analizimin e mostrës.

Në rastet kur afati ligjor i dërgimit të përgjigjes nga laboratorit është tejkaluar, rekordi mund të mbyllet automatikisht nga sistemi, meqenëse çdo masë ndaj subjektit do të përbente një kundërvajtje ligjore nga ana e AKU-s.

*Brenda 6 mujorit të parë të vitit 2022*

**22. Gjetje nga auditimi:** : Gjatë auditimit, nëpërmjet testimeve të sistemit, u konstatua se:

- Në opsionin “About me” shfaqet error që tregon se nuk kemi asnjë mundësi të kryejmë veprime si ndryshimi i fjalëkalimit në kundërshtim me rregulloren që përcakton se ky veprim mund të kryhet nga përdoruesi sipas nenit 10, pika 3 ku citohet se “Portali ofron për çdo përdorues mundësinë e ndryshimit në çdo moment kohe të fjalëkalimit dhe garanton ruajtjen e fshehtësisë së tij”;

- Opsioni “Dil”, nuk është komandë e zbatueshme nga ana e sistemit pasi përdoruesi mbetet i loguar në sistem edhe pas thirrjes së këtij opsioni duke lejuar nëpërmjet sistemit të ndodhin gabime njerëzore, por dhe gabime të qëllimshme pasi dikush tjetër mund të veprojë në emër të përdoruesit që mendon se ka dalë jashtë sistemit. Kjo problematikë rezultoi e pa identifikuar, e pa raportuar dhe e pazgjidhur, megjithëse sistemi është ndërtuar që në vitin 2011.

*(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.4 faqe 34-60 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)*

**22.1 Rekomandimi:** AKSHI dhe IQ si institucione administrues të sistemit e-inspektimi të kryejë testime në sistem për të verifikuar të gjitha problematikat që shfaqen në sistemin e-inspektimi ku në të bëjnë pjesë dhe opsionet e vetë administrimit të përdoruesit dhe ti adresojë problematikat të cilat vijnë si rezultat i mangësive në sistem tek AKSHI si ndjekës i kontratës së mirëmbajtjes.

*Menjëherë*

---

*Për sa më sipër paraqitet ky Raport Përfundimtar Auditimi*

Raporti i Përfundimtar i Auditimit, do të përcillet në të tre subjektet objekt auditimi: Agjencinë Kombëtare e Ushqimit (AKU), Inspektoratin Qendror (IQ) dhe Agjencinë Kombëtare e Shoqërisë së Informacionit (AKSHI).

## **KONTROLI I LARTË I SHTETIT**